100 VJET PAVARESI

Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 1 (69). JANAR 2012. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

AURORA GROUP
PROJEKTIM - ZBATIM
koha kalon, cilësia mbetet
Autostrada Tirane - Durres, Km.9
Tel: +355 48 30 2046
Tel: +355 48 30 2040
www.auroragroup.com.al
e-mail: auroragroup@auroragroup.com.al

STUDIM HISTORIK

Historiografia shqiptare mbi Skënderbeun

Nga: **FLAMUR HADRI** - FAQE 2,3,4

OPINION

A do të shkojë Gjergji në Sinë hipur mbi kalë?

Nga: **ABDURAHIM ASHIKU** - FAQE 5

BOTIM I RI

"Tradita gojore si etnotekst" i Shaban Sinanit

Nga: **NAIM ZOTO** - FAQE 19

KRITIKË LETRARE

Modeli stilistik dhe ligjërimor i Naim Berishës

Nga: **HAJRI MANDRI** - FAQE 21

Pallati i Kulturës mbyll dyert

Peshkopia, i vetmi qytet në vend, me Pallat Sporti e Pallat Kulture, por pa sport dhe pa kulturë



Mbyllet Pallati i Kulturës i Peshkopisë. Njëzet e tetë punonjësit e saj prej katër muajsh nuk janë paguar. Pallati i Kulturës financohet nga pushteti lokal dhe, rrjedhimisht, gjithë financimet e saj, përjashtuar veprimtaritë kulturore me projekte, financohen nga Bashkia. Kjo e fundit, për këtë vit, e ka gjetur më të lehtë ta mbyllë Pallatin e Kulturës sesa të kërkojë rrugë dhe mundësi financimi.

Burime nga pushteti lokal bëjnë me dije për gazetën se kjo periudhë "mosfunksionimi" do të vazhdojë deri në fund të muajit prill. Më pas pritet që të ribëhet një organizim i Pallatit të Kulturës, duke pasur parasysh se këtë vit, në kuadër të 100 vjetorit të Pavarësisë, do të organizohen shumë veprimtari.

Në Pallatin e Kulturës funksionojnë trupa e profesionistëve të teatrit dhe estradës, biblioteka, muzeu, të cilat deri në fund të pranverës do të jenë jashtë funksionit.

Lidhur me këtë, drejtori i Pallatit të Kulturës, Veli Vraniçi, i tha korrespondentit të gazetës "Rruga e Arbërit" se "aktualisht mjediset e pallatit janë të shfrytëzueshme për trupën e aktorëve dhe orkestrën, të cilët bëjnë prova. Në kuadër të 100-vjetorit të Pavarësisë, - thotë Vraniçi, janë planifikuar shumë veprimtari, ndaj shumë shpejt mendoj se Pallati i Kulturës do t'i rikthehet normalitetit".

Pallati i Kulturës së Peshkopisë, ashtu si dhe Pallati i Sportit, kanë një histori të gjatë ndërtimi. Për Pallatin e Kulturës punimet kanë nisur 26 vite më parë, më 1986, por pas një kalvari të gjatë të ndërtimit, ai u inagurua në dhjetor të vitit 2001. Prej atëherë Pallati ka qenë një qendër e veprimtarive kulturore e artistike, me premisën e shndërrimit të saj në një qendër kulturore rajonale. Por, si duket, vështirësitë financiare që po kalon pushteti lokal e kanë detyruar të mbyllë dyert e Pallatit të Kulturës. U mbetet institucioneve qendrore të linjës, kryesisht Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, që të ndihmojnë me fonde për rihapjen sa më shpejt të kësaj qendre kulturore. Ndryshe Peshkopia do të jetë i vetmi qytet me Pallat Sporti e Pallat Kulture, por pa sport dhe pa kulturë.

B.KAROSHI

VLERËSIM

ABDI BALETA, JURIST E DIPLOMAT

Të ndërtohet sa më shpejt "Rruga e Arbërit"

Ardhmja e Matit mendoj se do të jetë e lidhur me zhvillimin e një metropoli të madh që do të krijohet nga Tirana, Fushë-Kruja, Durrësi, Kavaja, Elbasani e ndoshta më gjërë. Në kuadër të shtimit të marrëdhënieve Perëndim-Lindje do të gjallërohen përsëri shumë shkëmbimet sipas rrugëve të vjetra "Apia", "Egnatia", "Rruga e Arbëri", e më tej me "Rrugën e Mëndafshit" në Azi. Vlera e Matit vetëm do të rritet. Toka, pronat, shërbimet, bukuritë natyrore në Mat do të marrin vlera të reja. Është në të mirë të Matit të ndërtohet sa më shpejt "Rruga e Arbërit", sepse kështu lugina e bukur do të përfshihet më shpejt në zhvillimin e përbashkët të zonës, e cila do të jetë metropoli i madh shqiptar në Ballkan dhe i transversales gjigande Durrës-Stamboll. Unë e ëndërroj Matin si krahinë rezidenciale e së ardhmes.

Marrë nga gazeta Mati, Nr, 1 (79), Janar 2012.

SUPLEMENT ARSIM

Shkolla shqipe në Grykën e Vogël

Nga: **ZABIT LLESHI** - FAQE 9

Historik i shkurtër i zhvillimit të arsimit në Bulqizë

Nga: **BASHKIM LAMI** - FAQE 10,11

Respekt i përjetshëm për mësuesin e popullit

Nga: **NIKOLL KOLA** - FAQE 14,15

cyan magenta yellow black 1

Rruga e Arbërit nr. 69

Një studim mbi figurën e Skënderbeut. Cfarë thotë historiografia shkencore shqiptare mbi Heroin Kombëtar, origjinën, rininë dhe luftën e tij kundër Perandorisë Osmane? Me rastin e 544-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut dhe 100 vjetorit të shpalljes së pavarësisë, gazeta do të botojë edhe në vazhdim materiale origjinale dhe studime shkencore mbi Skënderbeun, në frymëzimin e lëvizjes kombëtare deri në shpalljen e Pavarësisë.

studim

Historiografia shqiptare

Nga: **FLAMUR HADRI** (**Prishtinë**) *

Siç dihet, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, u vu në krye të luftës së madhe shqiptare më 1443, kur ai ishte afro 38 vjeç. Që nga ky vit e derisa vdiq, më 1468, jeta e heroit është e shkrirë aq tepër me luftën heroike të popullit shqiptar sa biografia e tij personale është pjesë përbërëse e historisë së ndeshjes njëçerekshekullore. Për këtë arsye historianët janë interesuar për biografinë e Skënderbeut, sepse çdo njoftim që ekziston ose tërthorazi edhe historinë e luftës çlirimtare që ai udhëhoqi. Por historia botërore për Skënderbeun ka shkuar edhe më tej. Si për çdo figurë të madhe historike, ashtu edhe për Gjergj Kastriotin-Skënderbeun, ajo është interesuar të ketë sa më tepër njohuri edhe për jetën personale dhe shoqërore të heroit para se ai të vihej në krye të luftës legjendare, me qëllim që nëpërmjet tyre të ndriçojë sadopak formimin e tij moral politik dhe ushtarak, të cilat e përgatitën atë që të shquhej në mënyrë të mahnitshme gjatë epopesë së tij të shkëlqyer në shek. XV.

Për qindra vjet me radhë, burimi kryesor që pati në dorë historiografia botërore për të njohur origjinën, familjen, rininë dhe veprimtarinë e Skënderbeut deri në vitin 1443, ka qenë vepra e Marin Barletit. Të dhënat e saj, edhe pse të cekëta për këtë periudhë fillestare të jetës së heroit, kanë qenë më të pasura dhe më të plota se çikërrimat që përmbanin burimet e tjera letrare që njiheshin nga historiografia për Skënderbeun deri në gjysmën e dytë të shek. XIX. Madje, edhe kur ndonjëri prej këtyre burimeve përmbante njohuri që nuk pajtoheshin në ndonjë pikë me veprën e M. Barletit, historianët e ndryshëm vazhduan ta pranonin tregimin e humanistit shkodran, sepse e konsideronin atë më të besueshëm se sa njoftimet që përmbanin burimet e tjera letrare.

Njoftimet biografike që jep M. Barleti mbi Skënderbeun deri më 1443, pak a shumë dihen. Sipas tij, Kastriotët qenë një familje fisnike nga krahina e Ematit (Aemathia), emër me të cilin studiuesit e ndryshëm nënkuptonin krahinën e Matit. Sipas tij, i ati i Skënderbeut, Gjon Kastrioti ishte një princ i pavarur dhe qëndronte në radhët e prinërve më të shquar që sundonin në Shqipëri në gjysmën e parë të shek. XV. Megjithëse mjaft i fuqishëm, Gjoni u mund nga ushtria osmane dhe u detyrua t'i japë peng sulltan Muratit II, katër djemtë e tij – reposhin, Stanishin Kostandinin dhe më të voglin, Gjergjin, i cili në atë kohë ishte fëmijë 9 vjeç. Të katër djemtë u dërguan në Edrenë, atëherë kryeqyteti i Perandorisë Osmane, ku u kthyen në fenë myslimane dhe u rritën në shkollën ushtarake të pallatit të sulltanit. Barleti thotë se pas pak kohësh, sulltani i helmoi tre vëllezërit më të mëdhenj, kurse Gjergjin e kurseu sepse i kishte hyrë në zemër si një djalë i talentuar. Gjergj Kastrioti, i cili mori emrin Skënder Beg, pasi mbaroi shkëlqyeshëm shkollën e pallatit, u fut në radhët e ushtrisë osmane dhe në sajë të meritave të veçanta që tregoi në beteja, u bë sanxhakbej dhe një nga gjeneralët më të dëgjuar të kalorësisë osmane. Kur Gjon Kastrioti vdiq, sulltan Murati II, i cili i kishte premtuar se do ta kthente në atdhe djalin që mbante peng për të zënë vendin e të atit, nuk e mbajti fjalën, por e aneksoi edhe principatën e Kastriotëve. Skënderbeu, tregon Barleti, i pezmatuar nga vrasja e pabesë e vëllezërve dhe nga mohimi i principatës atërore, vendosi që sapo t'i jepej rasti i parë të arratisej nga ushtria osmane dhe t'i shpallte kryengritje sulltanit. Ndërkohë atij i erdhën në Edrene disa herë delegacione të fshehta nga Shqipëria, të cilët e ftonin të kthehej sa më parë në atdhe ku e prisnin bashkëatdhetarët e vet të gatshëm për të rrëmbyer armët kundër zgjedhës osmane. Por Skënderbeu, vazhdon të tregojë M. Barleti, i cili nuk e gjykonte akoma të përshtatshëm momentin, i përcillte këto delegacione pa u dhënë asnjë premtim dhe pa ua zbuluar planin që kishte në mendjen e vet. Rasti erdhi më 1443, kur filloi lufta turko-hungareze. Me urdhër të sulltanit, Skënderbeu u nis së bashku me ushtrinë osmane në frontin e Nishit. Po aty, ai jo vetëm që nuk luftoi kundër ushtrisë hungareze, por veproi në mënyrë të atillë që i dha mundësi Janosh Huniadit ta sulmonte me sukses ushtrinë osmane. Gjatë rrëmujës që u krijua Skënderbeu e detyroi me anën e shpatës, kancelarin e sulltanit që t'i lëshonte një ferman perandorak, me anën e të cilit ai emërohet qeveritar i Krujës. Pasi shtiu në dorë fermanin e rremë dhe pasi vrau kancelarin turk, Skënderbeu i shoqëruar nga 300 kalorës shqiptarë, vrapo për në Shqipëri dhe arriti në Dibër ku u prit me entuziazëm nga popullsia vendase; pastaj me fermanin e rremë mori në dorëzim kalanë e Krujës dhe ngriti flamurin e kryengritjes së përgjithshme çlirimtare [1].

Aférsisht në këtë mënyrë e përshkruan këtë pjesë të jetës së Skënderbeut edhe historiani tjetër shqiptar, Dhimitër Frangu, bashkëkohës i Skënderbeut dhe i Barletit [2].

Tregimi i M. Barletit për pjesën e parë të jetës së heroit sundoi në vija të përgjithshme në hsitoriografinë për Skënderbeun shqiptar dhe botëror deri në fund të Luftës së Dytë Botërore. Megjithatë, pati historianë të cilët nuk u treguan shumë entuziastë për mënyrën romantike me të cilën i përshkruan ngjarjet humanisti shkodran. Qysh në shekullin e kaluar V. Markushevi [3], K. Jireçeku [4], P. Pisani [5] vunë re se tregimi i M. Barletit dukej i pabesueshëm dhe nuk pajtohej me disa njoftime dokumentare që ndërkohë kishin filluar të dilnin në dritë. U shfaqën dyshime edhe nga historianë të tjerë, por puna nuk u çua më tutje. Ai që e shoshiti me sy të rreptë kritik gjithë këtë pjesë të tregimit të humanistit shkodran dhe propozoi një variant të ri mbi jetën e heroit deri në vitin 1443, ishte historiani shqiptar Fan S. Noli.

Në disertacionin e vet të vitit 1947, F. Noli i kushtoi këtij problemi një kapitull të veçantë të titulluar "Fillime legjendare" [6]. Penda, që ai përdori në këtë kapitull ndaj tregimit të Barletit është shumë e ashpër. Ai nuk pranoi asgjë nga tregimi i Barletit. Sikurse ka vënë në dukje Kristo Frashëri, Fan Noli pati në këtë pikë tri lloj argumentesh: logjikën historike, kontradiktat e Barletit dhe njoftimet dokumentare [7].

Është e pamundur të besohet, thotë F. Noli, që një djalë i vogël 9-vjeçar, që u dërgua në një shkollë ushtarake pranë një pallati perandorak, që ndoqi atë shkollë për gati pesëmbëdhjetë vjet me radhë, që e mbaroi atë shkollë, që shërbeu për shumë kohë si komandant i shquar në radhët e ushtrisë osmane dhe që qëndroi për 29 vjet me radhë larg atdheut, prindërve, bashkëatdhetarëve, u kthye në mënyrë të papritur në Shqipëri si një nga çlirimtarët më të mrekullueshëm dhe si një nga organizatorët më të talentuar të luftës popullore që ka njohur mesjeta [8].

Veç kësaj, Fan Noli vuri në dukje se M. Barleti bie në kundërshtim me vetveten, të paktën në dy çështje. Sipas humanistit shkodran, dorëzimi i Gjergj Kastriotit, peng duhet të ketë ndodhur në vitin 1414, sepse atëherë ai ishte 9 vjeç. Por në këtë vit, siç kanë vënë re edhe mjaft historianë të mëparshëm, në fronin e Perandorisë Osmane mbretëronte jo sulltan Murati II, por sulltan Mehmeti I. Po kështu, nga njëra anë, Barleti thotë se Skënderbeu u kthye në Shqipëri më 1443, pasi qëndroi larg atdheut 29 vjet me radhë, nga ana tjetër, në dy raste të tjera të veprës së tij le të kuptohet se heroi u kthye në atdheun e vet qysh më 1438 [9].

Por ato që i japin dorë Fan Nolit ta sulmojë frontalisht M. Barletin, janë disa njoftime dokumentare, shumica e të cilave njiheshin edhe para Luftës së Dytë Botërore. Sipas tyre del se vëllezërit e Skënderbeut nuk u helmuan nga sulltani, mbasi njëri prej tyre, Stanishi, ishte akoma gjallë më 1445, kurse tjetri, Reposhi, ka vdekur qetësisht në një manastir të krishterë më 1431. Pastaj ai sjell dëshminë e një bashkëkohësi italian të Skënderbeut. G. Pontano, i cili pohon se heroi vajti peng te sulltani kur ishte djalë i rritur [10]. Për të gjetur vitin se kur vajti peng, F. Noli shfrytëzon dy aktet e zbuluara në manastirin e Hilandarit qysh në vitin 1848 [11], nga të cilët njëri tregon se Gjon Kastrioti me të tre djemtë e tij, Reposhin, Kostandinin dhe Gjergjin blenë më 1426 një pirg nga manastiri i përmendur që ndodhet në Malin e Shenjtë, kurse tjetri përmend faktin se Gjon Kastrioti bashke me të katër djemtë e tij, Stanishin, Reposhin, Kostandinin dhe Gjergjin i dhuruan po atë vit dy fshatra, Radostushën dhe Trebishtin, po këtij manastiri. Kjo vërteton, thotë F. Noli, se deri më 1426, pra deri sa u bë 21 vjeç, Skënderbeu ndodhej pranë të atit, në Shqipëri, përndryshe emri i tij nuk do të mund të figuronte në dy aktet e Hilandarit.[12] Sipas pikëpamjes së F. Nolit, Skënderbeu duhet të jetë dorëzuar peng në vitin 1430, sepse atëherë Gjon Kastrioti u mund prej sulltan Muratit II. Ai gjen në këtë mes mbështetje te historiani frëng i shek. XVII, H. Spondanus, i cili duke trajtuar ngjarjet e Shqipërisë së kësaj periudhe, ka pohuar se Gjergj Kastrioti u dorëzua peng më 1431, pra kur ai ishte rreth 26 vjeç [13]. Madje, F. Noli ngul këmbë se edhe pas kësaj date, Skënderbeu nuk ka qëndruar vazhdimisht larg Shqipërisë. Ai largohej nga shtëpia e vet vetëm për të marrë pjesë në fushatat ushtarake që ndërmerrte sulltani kundër shteteteve të tjera. Posa këto fushata merrnin fund, Skënderbeu kthehej në Shqipëri, pranë familjes dhe bashkëatdhetarëve të vet [14].

Prandaj, përfundon F. Noli, heroi nuk ka pasur nevojë të ikte fshehurazi nga ambienti turk pasi ai ndodhej në Shqipëri. Për të provuar praninë e tij në Shqipëri dhe përgatitjet e tij për kthesën e vitit 1443, F. Noli përmend dy dokumente që shpallin Skënderbeun dhe Stanishin qytetarë nderi të Venedikut më 1438 dhe të Raguzës më 1439 [15].

Historiografia shqiptare nuk u pajtua plotësisht me trajtesën e Fan Nolit. Ajo vuri në dukje se trajtesa e tij, në lidhje me këtë çështje ka dy përpjekje: njëra për të rrëzuar tregimin tradicional të Barletit dhe tjetra për ta zëvendësuar këtë tregim me variantin e përpunuar nga Noli. Rrëzimi i të parit nuk vërteton modeomos saktësinë e të dytit. Prandaj historianët shqiptarë të ditëve tona i morën në shqyrtim me objektivitet shkencor të dyja këto aspekte të problemit për të provuar më parë se çfarë të vërtete ka në tregimin e Barletit dhe sa i qëndron kritikës varianti i ri i Nolit.

Shoshitjen e parë kritike të këtyre dy aspekteve e ndërmori Aleks Buda, me recensionin e vet shkencor për disertacionin e F. Nolit, që u botua më 1951 [16]. "Nuk ka dyshim – shkruan ai – se versioni që na jep Barleti me ..... një varg kontradiktash kronologjike, të cilat i shërbejnë Nolit për ta deklaruar atë të papranueshëm" [17]. Dhe më tej ai pranon se pranë këtyre kontradiktave të jashtme, tregimi i Barletit paraqet edhe kontradikta të brendshme. Dorëzimi peng i Skënderbeut në moshë tepër të njomë, edukimi i tij në shkollën e pashallarëve të sulltanit, karriera e tij e madhe në radhët e ushtrisë së sulltanit, qëndrimi i tij tepër i gjatë larg atdheut i duken edhe A. Budës të papajtueshme me kthimin e tij të papritur në Shqipëri si një nga luftëtarët më të mëdhenj të lirisë [18]. Por këto kontradikta, të cilat, thotë A. Buda, pa dyshim ekzistojnë, a mjaftojnë për ta rrëzuar krejtësisht tregimin tradicional të Barletit?

Sipas A. Budës, gabimi i F. Nolit është se ai nuk merr parasysh të dhënat e disa dokumenteve, përbuz pa arsye të forta të dhënat e disa autorëve ose nxjerr nga ato konkluzione që nuk janë të bindshme. Kështu, për shembull, Noli nuk merr në konsideratë dokumentin venedikas që flet se më 1410 Gjon Kastrioti u detyrua të dorëzonte peng te osmanët një nga djemtë e tij dhe pa të drejtë mendon se prania e emrit të Skënderbeut në të dy dokumentet Hilandarit nënkupton medoemos praninë e tij në Shqipëri. Veç kësaj Noli e konsideron pa të drejtë si një "përrallë" njoftimin që jep Gjon Kastrioti se një djalë i vet shërbente më 1428 në radhët e ushtrisë osmane dhe se e injoron më kot

Posta e Rruga Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 1 (69). 1 - 31 Janar 2012

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Njoftojmë zotërinjtë Ali Hoxha dhe Hajri Mandri, se shkrimet e tyre jane planifikuar për numrat e ardhshëm.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**
JU LUTEMI, QË SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAILIT, TË KENË PATJETËR ZANOREN "Ë".
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



DREJTOR:
Rakip Suli

KËSHILLI BOTUES:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Kontribuan për këtë numër:

Flamur HADRI
Abdurahim ASHIKU
Rexhep TORTE
Marin MEMA
Dionis XHAFA
Zabit LLESHI
Bashkim LAMI
Ilmi DERVISHI
Sakip CAMI
Nikoll KOLA
Esmeralda BICA
Naim ZOTO
Selman MZIU
Hajredin TOCA
Sazan GOLIKU
Eralda SKARRA
Xhelal LUCA
Hajri MANDRI
Mevlud BUCI

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

historik

mbi Skënderbeun

faktin se në dokumentin me të cilin Republika e Raguzës u njoh të drejtën e qytetarisë dy djemve të Gjon Kastriotit më 1439, emri i Gjergjit është fshirë me një vizë [19].

Aleks Buda sjell pastaj një varg dëshmish të pavarura njëra nga tjetra, siç janë ato të F. Filelfos, G. Pontanos, R. Volaterranos, L. Hallkokondilit, Kostandin Mihailoviçit, Ashik pasha-Zades, Dursun Begut, Saad-ed-Dinit dhe Sollak Zades, të cilët pohojnë se Skënderbeu vajti peng në oborrin e sulltanit qysh kur ishte fëmijë dhe qëndroi larg atdheut për një kohë të gjatë [20]. Duke u mbështetur në po këto burime të pavarura, të cilat, me përjashtim të Dursun Begut, pajtohen midis tyre, A. Buda pranon mundësinë që Skënderbeu të jetë kthyer në Shqipëri me lejen e sulltanit pak kohë para luftës hungarezo-osmane dhe që këtej të ketë shkuar në betejën e Nishit, prej nga ai u arratis për të filluar kryengritjen çlirimtare të vitit 1443. "Fakti që burimet perëndimore – shkruan ai – heshtin për kthimin e parë në Shqipëri si vasal i sulltanit dhe përmendin vetëm kthimin e dytë nga Nishi si kryengritës, mund të shpjegohet sepse të dy ngjarjet kanë qenë afër njëra-tjetrës, saqë në kujtimin e biografëve u bënë një". Sidoqoftë, përfundon A. Buda, "një vjet më vonë ose më përpara, ky mbetet gjithmonë një kthim nga oborri i sulltanit kur Skënderbeu pat kaluar rininë e tij, gjë që Noli e mohon plotësisht" [21].

Tre vjet pas kritikës së A. Budës, historiani turk N. Inalçik botoi defterin mufasal të sanxhakut të Shqipërisë/sancak-i Arvanid/, hartuar nga administrata osmane në vitet 1431-1432, ku figurojnë tri shënime që tregojnë se në vitin 1438 Skënderbeu ndodhej në Shqipëri dhe shërbente në sistemin feudal-ushtarak të kazasë së Krujës [22]. Ky fakt i ri së bashku me indikacionet e njohura më parë, u shërbeu autorëve të "Historisë së Shqipërisë" vëllimi I, që u botua nga Universiteti i Tiranës më 1959, ta trajtojnë periudhën e parë të jetës së Skënderbeut në një dritë të re. Në kapitullin VII të këtij vëllimi, të hartuar nga Kr. Frashëri, pranohet njoftimi i M. Barletit dhe i burimeve të tjera për vajtjen njoftimi i M. Barletit dhe i burimeve të tjera për vajtjen peng të Skënderbeut në oborrin e sulltanit në radhët e iç-ogllanëve, veçse jo në moshën 9, por 18 vjeçare, në vitin 1423, kur Murati II pushtoi moshën 9, por 18 vjeçare, në vitin 1423, kur Murati II pushtoi pjesën më të madhe të Shqipërisë [23]. (Veç kësaj tregimi i M. Barletit u korrigjua edhe për sa i përket kohës që Skënderbeu qëndroi larg atdheut. "Megjithëse peng në Adrianopojë – thuhet në këtë kapitull – Gjergji nuk i humbi lidhejt me atdheun e vet. Kështu mund të ketë ndodhur rreth vitit 1426 kur emri i tij përmendet në dy aktet e gjetura në manastirin e Hilandarit. Si peng ai qe i detyruar të merrte pjesë në fushatat luftarake të turqve, ku duekt se tregoi zotësi dhe sulltani i dha atij titullin bej" [24].

Më tutje thuhet: "Dokumentet e reja, të zbuluara kohët e fundit, dëshmojnë se më 1438, Skënderbeu ndodhej në Shqipëri me detyrën e qeveritarit (subashit) të vilajetit të Krujës... Në Krujë ai pati mundësi të përgatitej për kryengritjen e armatosur, në pritje të situatës më të favorshme". Por "më 1440 Skënderbeu u largua nga Kruja dhe shkoi si duket në Dibër, ku u emërua sanxhakbej. Edhe këtu ai i vazhdoi përgatitjet e tij për t'u shkëputur nga zgjedha e sulltanit, duke pritur rastin e volitshëm. Ky rast, thuhet aty, erdhi më 1443, kur filloi lufta hungarezo-turke, Skënderbeu u nis në Nish, ku thyerja e ushtrisë osmane nga Huniadi i dha atij rast të vinte në zbatim planin e vet" [25].

Më vonë këtë tezë Kristo Frashëri e argumentoi më gjerësisht në disa punimet të veçanta. Në një artikull të botuar më 1967 ai analizon imtësisht përmbajtjen e dy akteve të zbuluara me kohë në manastirin e Hilandarit. Duke

Kastriotët ishin një familje shqiptare nga Dibra e Poshtme. Emrin e tyre familjar ata e morën nga fshati Kastriot i krahinës së sotme të Çidhnës, i cili ndodhet pranë lumit Drin. Deri në mes të shek. XIV duket se ata nuk kanë patur ndonjë pozitë shoqërore të privilegjuar. Gjyshi i Skënderbeut ishte Pal Kastrioti, i cili gjatë gjysmës së dytë të shek. XIV ishte një feudal i vogël – zot i Sinës dhe i Gardhit të Poshtëm, dy fshatra këto që ndodhen në malësinë i Çidhnës, në pjesën veriperëndimore të rrethit të Dibrës. Biri i tij, Gjon Kastrioti, e forcoi pozitën feudale që trashëgoi nga i ati. Ai e shtriu sundimin e vet në krahinën e Dibrës, pastaj në atë të Matit dh emë në fund, para vitit 1407, në viset bregdetare të Mises, midis Lezhës dhe Krujës. Gjatë kësaj periudhe duket se familja e Gjonit banonte herë në Sinë, herë në Kastriot. Pikërisht në lagjen Shëgjerth të fshatit Sinë lindi më 1405 Gjergj Kastrioti, i cili sipas traditës popullore u rrit në lagjen Çelias të fshatit Kastriot.

shfrytëzuar me këtë rast edhe disa dokumente të tjera të kësaj periudhe, autori ndriçon pozitën e Gjon Kastriotit dhe të Skënderbeut gjatë viteve 20 të shek. XV. Sipas tij, nga të dy aktet e Hilandarit, të cilat janë dy instrumente të një marrëveshje të lidhur më 1426 midis Gjon Kastriotit dhe manastirit ortodoks, del se në kohën e nënshkrimit të tyre Gjoni ishte një zot feudal shumë i fuqishëm në Shqipëri dhe se në vitin 1426 Gjergj Kastrioti – Skënderbeu nuk ndodhej më në oborrin e sulltanit, por në atdheun e vet, se jo Skënderbeu, por Stanishi, emri i të cilit mungon në njërin nga këto dy akte, duhet të jetë ai "biri i Gjon Kastiotit", i cili, sipas një dokumenti venedikas, ndodhej në vitin 1428 në radhët e ushtrisë soamen, se, më në fund, Gjergj Kastrioti, duke qenë pranë familjes, ka qenë pranë ngjarjeve të mëdha politike e ushtarake që ndodhën në Shqipëri, një nga protagonistët kryesorë të të cilave ka qenë i ati, Gjon Kastrioti. Pra, konkludon autori, "jo oborri turk, por atdheu, bashkëatdhetarët dhe prindërit kanë shërbyer si vatra edukimi dhe të formimit ideologjik e politik të heroit tonë kombëtar" [26].

Në një punim tjetër më të gjerë të botuar po atë vit (1967), Kristo Frashëri ndriçon pjesën shumë të errët të jetës së Skënderbeut gjatë viteve 30 të shek. XV dhe në pragun e kryengritjes çlirimtare të vitit 1443. Krahas burimeve të ndryshme kancelareske e kronikave, lindore e perëndimore, një vend me kancelareske e kronikale, lindore e perëndimore, një vend të rëndësishëm në këtë studim zë analiza që ai i bën letrës së një funksionari osman të këtyre viteve të sapozbuluara në arkivat e Stambollit i ashtuquajturi dokument nr. 6665 dhe veprës së kronistit osman, Idriz Bitlisit, gjithashtu i pashfrytëzuar deri atëherë nga historiografia botërore për Skënderbeun [27]. Nëpërmjet analizës së këtyre burimeve, K. Frashëri nxjerr konkluzionin se Gjon Kastrioti, pas dështimit të kryengritjes që ndërmori më 1430, e ruajti sundimin e vet vetëm në krahinën e Mesies; se ai qëndroi sundimtar i Misies ose deri më 1... Kur .... shpërthyen nën udhëheqjen e tij në një kryengritje të pasuksesshme, ose derisa vdiq më 1437; se me vdekjen e tij, qeveritarët osmanë vunë dorë në krahinën e Misies dhe e shpallën atë zotërim feudal-ushtarak, duke dërguar aty një feudal zaim osman; se në këtë kohë Gjergj Kastrioti me emrin Skënder, por pa titullin "bej" gjendej në Shqipëri dhe ishte një spahi në zonën e Dibrës dhe se, më në fund, përpiqej, duke pasur edhe përkrahjen e banorëve misianë, që të zinte vendin e të atit, si sundimtar i Misies [28].

Duke shfrytëzuar të dhënat që japin tre historianë të vjetër osmanë, Saad-ed-Dini Sollak-Zade, Munexhim Bashi, të cilët nga ana e tyre janë mbështetur te analistët osmanë të shek. XV, K. Frashëri pohon se pasi shfaqet më 1438 si subash i Krujës, emri i Skënderbeut zhduket për disa vjet nga burimet historike. Megjithatë, sipas tij, duhet të jetë emëruar rreth vitit 1440 sanxhakbej në krye të sanxhakut të Dibrës, betejën e Nishit, prej nga u arratis për të filluar kryengritjen çlirimtare. Pra, "kthesa e madhe që ndodhi në Shqipëri në vitin 1443 – përfundon Kristo Frashëri – nuk e nxori në mënyrë të befasishme Skënderbeun në skenën historike. Me këtë rreshtim të ngjarjeve, del qartë premisi i domosdoshëm që shpjegon suksesin e kryengritjes çlirimtare të vitit 1443 – kontakti paraprak i udhëheqjes me popullin, Skënderbeu u përgatit për disa vjet për kthesën historike të vitit 1443. Forcoi lidhjet me popullsinë e vendit të vet, por nuk la pas dore edhe lidhjet me botën e jashtme. Njohu forcën dhe pulsin e bashkatdhetarëve, por edhe masa e njohu talentin dhe urtësinë e tij para se t'i përvisheshin epopesë legjendare njëçerekshekullore" [29].

Pikëpamjen e K. Frashërit se në vitet 1435-1437 Skënderbeu ka qenë timari në zonën e Dibrës dhe në vitet 1437-1438 subash në Krujë, e kundërshtoi K. Biçoku. Sipas tij Skënderbeu nuk kishte timar në krahinën e Dibrës, por në perëndim, në vilajetin e Dhimitër Jonimës. Kur Skënderbeu ishte në postin e subashit të Krujës, rrjedhimisht kishte edhe timarin përkatës që lidhej me këtë post, por në përputhje me rregullat mbi shpërndarjen e feudeve, timari i tij i mëparshëm që përbëhej nga nëntë fshatra, i kaloi në zotërim një spahiu tjetër vendës. Sipas tij, nuk ka mbështetje pohimi se Skënderbeu nuk ishte subash i Krujës vetëm sepse nuk gjejmë shënime në regjistrat përkatës. Po të pranojmë këtë arsyetim, thotë K. Biçoku, do të arrijmë te përfundimi i gabuar se në Krujë gjatë viteve 1431-1434 nuk kishte subashë të tjerë përveç Ali beut të Zaganos beut. Por ky konkluzion nuk mund të pranohet, vazhdon ai, mbasi në shënimet e timareve të tjera gjejmë emrat e një sërë subashëve të tjerë para Zaganos beut. Më 1431-1432, në postin e subashit të Krujës ishte Hizër beu, mbi të cilin u regjistrua timari përkatës. Mirëpo, në nëntor të vitit 1438 në

(Vijon në faqen 4)



Shtatorja e Skënderbeut në Peshkopi, vepër e skulptorit Sadik Spahija. Kjo shtatore e financuar nga z. Zaim Korsi, është përuruar në qershor 2010

Historiografia shqiptare mbi Skënderbeun

(Vijon nga faqja 3)

krye të atij timari ishte shënuar se, "iu dha të lartpërmendurit Hizër beut". Ky shënim tregon se në postin e subashit të Krujës ishte dikush tjetër, përndryshe Hizër beu nuk do të emërohej për së dyti. Shënimet e tjera që janë bërë mbi timaret e vilajetit të Krujës tregojnë qartë se para riemërimit, në nëntor të vitit 1438, të Hizër beut, në postin e subashit të atij vilajeti ndodhej Skënderbeu, për arsye se kishte lëshuar çertifikatë të llojit biti dhe mektub, që hynin në kompetencat e subashëve" [30].

Historiografia e re shqiptare e gjeti të zgjidhur problemin e origjinës etnike të Kastriotëve dhe të Skënderbeut. Tezat absurde të pak historianëve të huaj të shek. XIX, të cilët pretenduan që heroi kombëtar i shqiptarëve ishte me kombësi sllave ose greke, qenë rrëzuar përfundimisht nga historiografia për Skënderbeun e paraluftës. Në asgjësimin përfundimtar të këtyre tezave fantaziste, patën dhënë një kontribut të veçantë historianët shqiptarë të periudhës midis dy luftëtarëve botërore, F. Noli [31] dhe A. Gegaj [32], të cilët argumentuan me materiale të reja shqiptarësinë e Skënderbeut të pohuar vazhdimisht nga M. Barleti. Midis këtyre këtyre materialeve, vlen të përmendet vërtetimi i shqiptarësisë së Skënderbeut që ka bërë vetë Skënderbeu të pohuar vazhdimisht nga M. Barleti. Midis këtyre materialeve, vlen të përmendet vërtetimi i shqiptarësisë së Skënderbeut që ka bërë vetë Skënderbeu në letrën që ai i drejtonte princit të Tarentit, Johan de Ursinit më 30 tetor 1460 [33]. N fakt, pas Luftës së Dytë Botërore, asnjë historian i huaj nuk e vuri më në dyshim origjinën shqiptare të heroit kombëtar të shek. XV.

Përkundrazi, historiografia e re shqiptare e zgjeroi më tepër problematikën e historisë personale të Skënderbeut. Ajo nuk u kënaq vetëm me rezultatin e arritur rreth shqiptarësisë së heroit, por kërkoi të zgjidhte edhe origjinën krahinore të Kastriotëve, madje edhe vendin ku lindi Skënderbeu.

Qysh në fillim u duk se të dyja këto çështje të lidhura ngushtë midis tyre, paraqisnin vështirësi për një zgjidhje të kënaqshme, pasi të dhënat burimore që ekzistonin për origjinën krahinore të Kastriotëve, linin shteg për interpretime të ndryshme, kurse për problemin e dytë, për vendlindjen e Skënderbeut, nuk ekzistonin fare të dhëna dokumentare.

Në fakt, kontradiktat për origjinën krahinore të Kastriotëve fillonin qysh me pohimet e biografëve të vjetër shqiptarë të heroit. Nga njëra anë qëndronte M. Barleti, i cili, sikurse u tha, na njofton se "Kastriotët buronin nga një familje fisnike e Ematit (ex Aemathia)" [34], të cilët historianët e identifikonin me krahinën e Matit: nga ana tjetër rreshtohej Gjon Muzaka, sipas të cilit gjyshi i Skënderbeut, Pal Kastrioti, zotëronte dy fshatra që ndodhen në rrethin e Dibrës – Sinën dhe Gardhin e Poshtëm [35]. Këtyre dy pohimeve u shtohej edhe një njoftim i tretë që del nga kronika raguziane e P. Lukarit, i cili shënon se Kastriotët ishin nga "fshati Kastrat jo larg lumit Drin në krahinën e Hasit në Shqipëri" [36], krahinë kjo që ndodhet në rrethin e sotshëm të Kukësit.

Përballë këtyre njoftimeve divergjente, qëndrimi që mbajtën historianët shqiptarë nuk është i njëjtë. Në "Historinë e Skënderbeut" të botuar më 1921, Fan Noli pranoi njoftimin e dhënë nga M. Barleti se Kastriotët ishin nga krahina e Matit [37]. Historiani tjetër shqiptar i paraluftës, A. Gegaj, e mori parasysh pohimin e kronikës së P. Lukarit, por i bëri këtij pohimi një zbërthim arbitrar, duke thënë se Kastriotët ishin nga krahina e Hasit, kurse mbiemrin e tyre ata e morën nga pronat që kishin në fshatin Kastri të Mirditës, zgjidhje kjo që nuk ka asnjë mbështetje dokumentare [38]. Duke u kthyer përsëri në këtë çështje, F. Noli solli në disertacionin e vitit 1947 një indikacion të ri që gjendet në një koleksion dokumentesh mesjetare të Bosnjës, të botuara nga E. Fermexhin, i cili thotë se "Kastriotët ishin nga fshati Kastriot në krahinën e Has të Epirit" [39]. Kështu F. Noli hoqi dorë nga pikëpamja e vitit 1921, pa u shprehur në mënyrë të prerë nëse pajtohej ose jo plotësisht me indikacionin e Fermexhinit, i cili dukej sikur po përputhej me atë të Lukarit.



A. Buda u pajtua plotësisht me indikacionet e P. Lukarit dhe E. Fermexhinit, sepse pohimet e tyre pavarësisht nga format e ndryshme që japin për fshatin, njëri Kastrat, tjetri Kastriot, ato përputhen me njoftimin që jep shkrimtari shqiptar i shek. XVII, Frang Bardhi, i cili përmend gjithashtu si vend origjine të Kastriotëve, fshatin Kastrat në Has [40]. Në fakt, thotë A. Buda, një lagje e Krumës në Has, mban edhe sot emrin Kastrat, gjë që vërteton indikacionet e Lukarit dhe të Fermerxhinit. Sipas tij, arsyeja përse dokumenti i Fermexhinit emri i fshatit është shkruar Kastriot dhe jo Kastrat duhet shpjeguar me ndikimin që ka ushtruar te shkruesi i dokumentit emri i dëgjuar i familjes. Pra, sipas A. Budës, Kastriotët rridhnin nga fshati Kastrat i Hasit dhe arsye përse emri i familjes që vjen nga Kastrati ka marrë formën kastrioti duhet kërkuar në ndikimin bizantin që ka vepruar mbi emrat e shumë krerëve feudalë shqiptarë në mesjetë [41].

Origjinën e Kastriotëve nga krahina e Hasit e pranuan edhe autorët e "Historisë së Shqipërisë" (1959) [42].

Çështja e origjinës krahinore të Kastriotëve u bë më 1974 objekt i një sundimi të veçantë nga K. Frashëri, i cili me këtë rast trajtoi për të parën herë në historinë për Skënderbeun edhe çështjen e vendit ku lindi Skënderbeu. Në artikullin e vet me titull "Nga ishin Kastriotët? Ku lindi Skënderbeu?", ai shtroi për diskutim me ballafaqim të gjitha indikacionet që ndshen në lidhje me këto çështje në burimet arkivore dhe letrare, të cilave u shtoi edhe të dhënat toponimike që mblodhi në terren. Nga analiza që u bën këtyre të dhënave, K. Frashëri nxjerr konkluzionin se me emrin Has kronika raguziane e Lukarit dhe koleksioni boshnjak e Fermexhinit nuk kanë pasur parasysh krahinën e sotme të Kukësit, mbasi krahinë deri në fund të shek. XVI quhej Pashtrik, por një nga krahinat e rrethit të Dibrës, qendra e së cilës është Çidhna e masakruar barbarisht nga sulltan Mehmeti II më 1466 në gjirin e së cilës ndodhen fshatrat Kastriot, Sinë dhe Gardhi i Poshtëm, që lidhen historikisht me familjen e Skënderbeut. Nuk është e rastit, thotë autori, që bashkëkohësi i heroit, R. Volaterrano e quan të atin e Skënderbeut Gjon Dibra ose Gjon Dibrani. Pastaj, K. Frashëri vë në dukje se nga defteri turk i përpiluar më 1467 del se në fshatin Sinë, që një shekull më parë ishte zotërim feudal i Pal Kastriotit, banonte një familje me të njëjtin mbiemër – familja e Dhimitër Kastriotit. "Fakti që në Sinë të Dibrës, dy orë larg fshatit Kastriot, i cili ndodhet po ashtu siç shënon kronika e Lukarit, pranë lumit Drin, tre ose katër breza pas Pal Kastriotit, ekziston akoma një familje me të njëjtin mbiemër, siç është ajo e Dhimitër Kastriotit, kjo nuk është e rastit. Kjo tregon se Kastriotët ishin vendosur prej kohësh në fshatin Sinë" [43].

Por edhe pse ishin nga fshati Sinë, shkruan K. Frashëri, Kastriotët pronat e tyre i kishin poshtë në fushë. Pikërisht në mes të asaj fushe, nja dy orë larg Sinës, ndodhet fshati Kastriot, pranë lumit Drin. Kështu ai pajtohet, për nga emri me kronikën e Fermexhinit dhe për nga pozicioni me kronikën e Lukarit. Pikërisht në një pikë të caktuar të këtij fshati, ndodhen një varg toponimesh të lidhura me emrin e të atit të Skënderbeut, siç janë Kulla e Gjonit, Kopshti i Gjonit, Ograja e Gjonit. Të gjitha këto të dhëna përfundon K. Frashëri, mbështesin traditën popullore dibrane, sipas së cilës Skënderbeu lindi në Shëngjergj (lagje e Sinës) dhe u rrit në Çelias (lagje e Kastriotit) [44].

Origjinën dibrane të familjes Kastrioti e kundërshtoi K. Biçoku. Në një artikull polemik me punimin e K. Frashërit, të botuar atë vit (1974), ai qëndron në tezën e mëparshme të origjinës së tyre nga krahina e Hasit të Kukësit [45]. Por argumentet e tij nuk u dukën bindëse, pasi dy autorë të tjerë shqiptarë, H. Ndreu [46] dhe A. Hoxha [47] e përforcuan tezën dibrane të origjinës së kastriotëve duke sjellë argumente të tjera mjaft interesante.

***

Pas këtyre hulumtimeve dokumentare dhe diskutimeve shkencore, mund të thuhet si përfundim se historiografia shqiptare e ditëve tona e ka përmbysur versionin që sundonte në historiografinë e mëparshme për Skënderbeun, për jetën dhe veprimtarinë e heroit deri në pragun e kryengritjes çlirimtare të vitit 1443. Sipas saj Kastriotët ishin një familje shqiptare nga Dibra e Poshtme. Emrin e tyre familjar ata e morën nga fshati Kastriot i krahinës së sotme të Çidhnës, i cili ndodhet pranë lumit Drin. Deri në mes të shek. XIV duket se ata nuk kanë patur ndonjë pozitë shoqërore të privilegjuar. Njoftimi që jep J. Hammeri se gjyshi i Skënderbeut quhej Gjergj Kastrioti, nuk është i saktë. Po ashtu nuk është i saktë as njoftimi tjetër i tij se gjyshi i heroit ka marrë pjesë në betejën antiosmane të Kosovës (1389) dhe se ka qenë pjesëtar i kështillit të luftës së koalicionit ballkanik që kryesohej nga prijësi Lazar. Si duket historiani gjerman është mbështetur te kronistët osmanë të shek. XV, por duhet ta ketë lexuar gabim njoftimin e tyre pasi ata e kanë fjalën për Gjergj Balshën II. Gjyshi i Skënderbeut ishte Pal Kastrioti, i cili gjatë gjysmës së dytë të shek. XIV ishte një feudal i vogël – zot i Sinës dhe i Gardhit të Poshtëm, dy fshatra këto që ndodhen në malësinë i Çidhnës, në pjesën veriperëndimore të rrethit të Dibrës. Biri i tij, Gjon Kastrioti, e forcoi pozitën feudale që trashëgoi nga i ati. Ai e shtriu sundimin e vet në krahinën e Dibrës, pastaj në atë të Matit dh emë në fund, para vitit 1407, në viset bregdetare të Mises, midis Lezhës dhe Krujës. Gjatë kësaj periudhe duket se familja e Gjonit banonte herë në Sinë, herë në Kastriot. Pikërisht në lagjen Shëgjerth të fshatit Sinë lindi më 1405 Gjergj Kastrioti, i cili sipas traditës popullore u rrit në lagjen Çelias të fshatit Kastriot.

Historiografia e sotme shqiptare e ka pranuar njoftimin që jep M. Barleti se Skënderbeu u dorëzua peng te sulltan Muradi II, por nuk shtë pajtuar me të për sa i përket moshës kur ai vajti në Edrenë. Sipas saj, dorëzimi peng i Skënderbeut ka ndodhur më 1423, kur ai ishte 18 vjeç, mbasi atë vit ndodhën ato ngjarje që përshkruan edhe M. Barleti, kur përcakton kohën e dorëzimit të tij peng. Pasi mbaroi shkollën e içoglanëve në moshën 21 vjeçare, ai duhet të jetë kthyer përkohësisht në Shqipëri, pranë familjes (1426). Por më vonë, duke qenë i inkuadruar, si bir vasali që ishte, në radhët e ushtrisë osmane, ai mori pjesë në fushatat ushtarake të Perandorisë Osmane. Në mes të viteve '30 ai shfaqet si spahi timari në rrethin e Dibrës dh emë 1438 si subash i vilajetit të krujës. Për hir të aftësive të tij ushtarake ai u bë sanxhakbej dhe, rreth vitit 1440, u vu në krye të sanxhakut të Dibrës. Ndërkohë, Skënderbeu gatoi projektin për të organizuar një kryengritje çlirimtare antiosmane. Duket se për këtë projekt, që do t'i sillte atdheut të vet lirinë, ai filloi të punonte të paktën qysh nga viti 1438, mbasi qysh nga ky vit e shohim të krijojë lidhje të fshehta me disa shtete të afërtra (me Venedikun, Raguzën, Napolin, Hungareinë) për t'i pasur si aleatë në luftën kundër pushtuesve osmanë. Në vjeshtën e vitit 1443, kur filloi lufta e re hungaro-osmane, me urdhër të sulltanit, Skënderbeu u nis për në frontin e Nishit. Nisja e tij duhet të jetë bërë nga Dibra, ndryshe nuk kuptohet prania e 300 e ca shqiptarëve në repartin që isthe nën komandën e tij. Vazhdimi i ngjarjeve është i njohur. Sapo Janosh Huniadi filloi sulmin kundër ushtrisë osmane, Skënderbeu me repartin e vet e braktisi frontin dhe u nis me nxitim në drejtim të Shqipërisë, ku dha sinjalin e kryengritjes së përgjithshme çlirimtare. Gatishmëria që ai gjeti në masat popullore, tregon se Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, ky hero i rrallë i luftës çlirimtare, kishte krijuar prej kohësh lidhje të ngushta me to.

REFERENCAT

*) Marrë nga "Gjurmime albanologjike" seria e shkencave historike, XII-1982, Prishtinë, 1983, dhe më pas në "Studime historike", nr. 1, 1984, f. 117-128.

1) M. Barleti, Historia e Skënderbeut, Tiranë, 1967, f. 52-78.

2) D. Franco, Commentario delle cose de 'Turchi e del Signor Giorgio Schanderbeg, Principe di Epyro, Venedik, 1545, f. 2-5.

3) V. Makusev, Istoriceskija Razyskanija o Slavjanah v Albanii v Srednie Veka, Warzawa, 1871, f. 82-85.

4) C. Jirecek, Geschichte der Bulgaren, Praga, 1876, f. 368.

5) P. Pisani, La Légende de Scanderbeg, Paris 1891, f. 191.

6. F. S. Noli, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Prishtinë, 1968, f. 64-83.

7) K. Frashëri, Gjergj Kastrioti Skënderbeu në pragun e kryengritjes çlirimtare t vitit 1443, në: "Studime historike", 91967), nr. 4, f. 209-210.

8) F. S. Noli, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Prishtinë, 1968, f. 78-79.

9) Po aty, f. 82.

10) J. J. Pontanus De Bello Napolitano, etj. vëll. II, Napoli, 1519, f. 279 (sipas F. S. Noli, po aty, f. 81-82).

11) V. Grigorovic Ocerk Ucennego Putesestvija po Europejskaj Turcii, Kazan, 1848 (sipas F. S. Nolit, po aty, f. 79-80).

12) F. S. Noli, vep. E përmendur., f. 79-80.

13) H. Spondanus, Annales Ecclesiastici ab Anno MCXCVII ad Finem MDCXI V. vëll. II, Ticino 1680, f. 165 (sipas F. S. Noli, po aty, f. 81).

14) F. S. Noli, vep. E përmendur, f. 81.

15) Po aty, f. 82.

16) A. Buda, Fytyra e Skënderbeut në dritën e të dhënave të reja, në "Buletinin e Institutit të Shkencave", Tiranë 3-4 (1951), f. 139-163.

17) Po aty, f. 147.

18) Po aty.

19) Po aty, f. 157-158.

20). Po aty, f. 157-162.

21) Po aty, f. 163.

22) H. Inalcik, 835 Hicri, suret-i defter-i isancak-i Arvanid, Ankara, 1954, timaret, nr. 314, 324, 335.

23) Historia e Shqipërisë, vëll. II, Tiranë, 1959, f. 269.

24) Po aty, f. 269-270.

25) Po aty, f. 271-272.

26) K. Frashëri, Gjergj Kastrioti Skënderbeu në pragun e kryengritjes çlirimtare të vitit 1443, në: "Studime historike". Tiranë, 4 (1967), f. 209-221)/

27) K. Frashëri, Aktet e Hilandarit, në "Mësuesi", Tiranë, 28 korrik 1967 dhe 4 gusht 1967.

28) K. Frashëri, art. i përm., f. 212-218.

29) Po aty, f. 221.

30) K. Biçoku, Mbi disa çështje lidhur me veprimtarinë e Gjergj Kastriotit Skënderbeut para vitit 1443, në "studime historike", 2, (1970), f. 152-153.

31) F. S. Noli, Historia e Skënderbeut, Boston, 1921, f. 46-56.

32) A. Gegaj, L'Albanie et l'invasion turque au 15e siécle, Paris 1937, f. 31-36.

33) Po aty, f. 33

34) M. Barleti, vep. e përm., f. 53.

35) Ch. Hopf, Chroniques Gréco-romanes, etj. Berlin, 1871, f. 301.

36) P. Luccari, Annali di Rausa, venezia, 1605, f. 86.

37) F. S. Noli, Historia e Skënderbeut, Boston, 1921, f. 20.

38) A. Gegaj, vep. e përm., f. 34.

39) F. Noli, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Prishtinë, 1968, f. 65.

40) A. Buda, po aty, f. 142.

41) Po aty.

42) Historia e Shqipërisë, vëll. I, Tiranë 1959, f. 250.

43) K. Frashëri, Nga na ishin Kastriotët? KU lindi Skënderbeu? Në "Mësuesi", Tiranë, 1974, nr. 35 dhe 36.

44) K. Frashëri, po aty, nr. 36.

45) K. Biçoku, rreth çështjes "Nga ishin Kastriotët", në "Mësuesi", Tiranë, nr. 49 dhe 50, 1974.

46) H. Ndreu, Toponimia në ndihmë të historisë së Kastriotëve, në "Mësuesi", Tiranë, nr. 15, 1975.

47) A. Hoxha, Mbi lokalizimin e fushës së betejës së Torviollit, në "Studime historike, 3", 1979, f. 241-242).

opinion



A do të shkojë Gjergji i Gjon Dibranit në Sinë hipur mbi kalë?



Nga: **ABDURAHIM ASHIKU**

Me sa duket Gjergji i Gjon Dibranit nuk do të më ndahet tërë jetën ani se atë e kam njohur dhe studiuar si njeri i thjeshtë, si amator. Dhe, si i tillë kam shkruar dhe do të shkruaj duke u kërkuar ndjesë historianëve, me dije gjerë e gjatë për Të, për ndonjë gabim.

Për Gjergjin e Gjon Kastriotit-Skënderbeun duhet shkruar shumë e më shumë, duhet shkruar derisa atë ta hipin mbi kalin e tij të bardhë dhe ta kthejnë në shtëpi, në vendlindje, në Sinë të Dibrës, në Kastriot e në tërë luginën e Drinit të Zi ku shkeli me opingat e fëmijërisë dhe luftoi i pamposhtur me shpatën e trimërisë.

Nuk e kam parë monumentin e Gjergj Kastriotit- Skënderbeut në Peshkopi, përveçse nëpërmjet fotografive të Bujar Karoshit të "Rrugës së Arbërit".

Nuk e kam parë as në sheshin e Dibrës së Madhe, përveçse nëpërmjet një fotografie në internet.

Nuk e kam parë as botës mbarë ku ai ende fluturon mbi kalin e legjendës. Do të doja ta shihja dhe ta fotografoja e të fotografohesha në krah të Tij në Athinë ku punoj e jetoj tash 16 vjet. Për këtë bëra një shkrim: "A do të vijë Gjergj Gjon Kastrioti-Skënderbeu me një shesh në Athinë" të cilin e hodha në internet.

Një dibran, Murat Koltraka që më ka bërë dhe më bën ta kem zili për fotografitë kanalit të Çidhnës, kanioneve hon të thella të Setës, Sinës e luginës së Drinit të Zi, një njeri që punon me "bel e kazmë", gjithnjë thellë e më thellë në kërkim të vlerave historike të zonës së Çidhnës e Sinës, si edhe herë të tjera, nuk mu nda me mendimet e tij.

"Përshëndetje i nderuari Abdurahim. Me gëzoni shumë me kujtesën që na sillni për heroin tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti - Skënderbeu. Mbështes plotësisht idenë tuaj, se së pari ka shume rëndësi për kombin shqiptar vepra e madhërishme historike e Skënderbeut, që lartëson shumë identitetin e kombit tonë, origjina shqiptare e tij, të tjerat, edhe pse jo të parëndësishme në raport me të parat, janë të dorës së dytë. Eshtë i natyrshëm dhe i pranueshëm rivaliteti ndërmjet krahinave për shkak te krenarisë së krahinës, kur nga gjiri i saj del një personalitet i këtyre përmasave. Janë të pranueshëm debatet, mendimet e kundërta, kur nuk përdoret ''prashajka'',që përmendeni ju, por të qenurit kofliktual, deri dhe për ditën e çlirimit, flet keq për historianët tanë, të qenurit dinjitoz të tyre në shërbime të shkencës së historisë, që është ''livadhi''i tyre. Tek ne përdoret ajo fjala popullore, qe ju e dini:''Foli dada nëpër buzë, se kjo punë u bë tërkuzë''. Mospërcaktimi ende i origjinës krahinore të Kastriotëve dhe i vendlindjes së Skënderbeut (zyrtarisht), që krijojnë një boshllëk të pajustifikueshëm në historinë tonë kombëtare është një turp për historiografinë tonë. Në asnjë krahinë tjetër nuk ka bazë e mbështetje burimore të besueshme, siç ka në Dibër për Kastriotet e Skënderbeun, as s'ka logjikë historike që ta hedhë poshtë këtë tezë të argumentuar shkencërisht nga prof. dr. Kristo Frasheri, që është i vetmi, që veç të tjerave, ka shkelë me këmbë çdo pëllëmbë të territoreve të Çidhnës që lidhen me Kastriotet. Studiuesi italian Rafael Volaterano, para Barletit, i pa ndikuar nga të tjerë, i paanshëm, (më 1506) në veprën ''Komentaret'' Gjon Kastriotin e emëron Gjon Dibra dhe Gjon Dibrani . Po ta njihte të një krahine tjetër, s'do t'i vinte këtë mbiemër. Fisniku Gjon Muzaka, bashkëkohës dhe bashkëluftëtar, mik i familjes se Skënderbeut, (kushëri i parë i Donika Kastriotit, të shoqes së Skënderbeut) në ''Memorada'' thekson se Pal Kastrioti, gjyshi i Skënderbeut, nuk kishte në zotërim më tepër se dy fshatra, Sinën dhe Gardhin e Poshtëm.

> Veprimtarive në Dibër, krahas atyre që lidhen me Shpalljen e Pavarësisë, me shkrimet dhe ngritjen e përmendoreve për dy figurat e mëdha dibrane; Vehbi Dibrën dhe Dom Nikollë Kaçorrin, dhe figura të tjera, për mua duhet të lidhen në radhë të parë me Gjergj Kastriotin, me vënien e tij në krye të Odës Historike Dibrane. Skënderbeu e meriton të ngrihet mbi monumente të përmasave të mëdha ballkanike e evropiane për veprën e madhe të tij me shpatë e me mendje në mbrojtje të qytetërimit të kohës, por përpara se të ngrihet atje, duhet të ngrihet në vendlindje të tij.

Mbështes idenë tuaj, se nuk ka as më të voglin dyshim, se këtu ne Sinen e Çidhnës së Dibrës ka zanafillën Principata e Kastrioteve dhe jo diku tjetër. Bazë fillestare mbështetëse kanë qenë malësoret trima te kësaj ane, që Kastriotet zotëruan Dibrën në fillim dhe pastaj u zgjeruan drejt lindjes, më pas drejt perëndimit deri në bregdet. Edhe ata që mbështeten tek Barleti për të kundërshtuar tezën dibrane, gabojnë. Jam i një mendimi me ju rreth pretendimeve për tezën e Matit. Nuk e kanë studiuar Barletin, vetëm e kanë lexuar. Barleti e thekson me forcë njohjen që kishte Skënderbeu me dibranët sepse kishte lindur dhe ishte rritur me ta. Një pritje kaq e përzemërt që i bëhet Skënderbeut nga dibranët dhe zgjedhja e Dibrës si mbështetje për realizimin e planit të tij, flet vetë. Me 11 nëntor 1443 është zhvilluar Kuvendi i Dibrës me prijës të shquar dibranë nën drejtimin e Skënderbeut, ku heroi ynë ua besoi dhe u paraqiti planin e tij. Me dibranë u nis për marrjen e Krujës. Barleti thekson se pas marrjes së Krujës nisi Hamza Kastriotin për në Dibër për t'u njoftuar lajmin e fitores dibranëve dhe përcolli porosi për mbrojtjen e kufijve në rast sulmi të turqve.

Barleti thotë ;''Viset e Çidhnës, janë viset e Skënderbeut''. Është Barleti ai, që shkruan se Skënderbeu ,veç këshillit të mbrojtjes së Besëlidhjes, kishte dhe këshillin me të tij dibranë, një tregues i shkallës më të lartë të besueshmërisë dhe mençurisë tek mbështetësit e tij dibranë, më tepër se tek të tjerët. Është Barleti, ai që në veçanti ve në dukje kontributin dibran në zgjerimin dhe mbrojtjen e principatës së Kastrioteve. Janë po ata burime të besueshme që na sjell prof .dr. Kristo Frasheri se në Dibër nuk kemi një shfaqje sporadike të ndonjë Kastrioti, por fillohet me Palin (rreth viteve1350) dhe mbyllet me Jozef Kastriotin me 1602, si përfaqësues i Çidhnës në kuvendin ndërkrahinor të Dukagjinit. Sorollatja e studiuesve nëpër krahinat e veriut të Shqipërisë, duke anashkaluar Kastriotin, vendbanim i lashtë, nën zotërimin e Kastriotëve që në shek XIII (sipas fjalorit Enciklopedik Shqiptare,është një çudi e radhës si shumë të tjera."

Unë, në respekt të mesazhit që më përcolli iu përgjigja:

Përshëndetje Murat Koltraka!

Është koha, është i vetmi shans historik, 100 vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë, që Dibra ta bëjë "qytetar nderi" të saj, bir të saj, ta marrë dhe ta vendosë në vendlindje, në Sinë. Ti bëjë një monument që të shihet nëpërmjet satelitit nga e gjithë bota, të ngrejë monumente e obeliskë madhështorë në të gjithë vendet ku ai ka zhvilluar betejat e tij fitimtare.

Do të jetë krim historik në qoftë se ky shans, ky rast, nuk shfrytëzohet në të gjitha përmasat e mundshme.

Gjergj Kastrioti duhet të kthehet në shtëpinë e tij biologjike, në Sinë të Dibrës. Asnjë vend tjetër nuk e qetëson shpirtin e tij të madh.

Me respekt

Abdurahim Ashiku

Athinë,18 janar 2012

Po në atë faqe të gazetës "Kritika" një lexues me pseudonimin "Patrioti" shkrimit tim "Toponimia në ndihmë të Kastriotëve", kumtim i mbajtur në Athinë me rastin e 600 vjetorit të Lindjes të Skënderbeut i shton radhët...

"Z. Ashiku. Gjergj Kastrioti Skënderbeu nuk është vetëm bir i Dibrës ku ai lindi, por me përmasat e një heroi Kombëtar e ndërkombëtar ai e ka vendin në të gjithë Shqipërinë sepse është krenaria e kombit tonë. Ai ka përmasa edhe ndërkombëtare sepse është mbrojtësi i krishterimit e qytetërimit evropian. Papa i Vatikanit i dha titullin "Atlet i Krishtit". Prandaj monumenti i tij është ngritur në disa vende të Evropës. Jam dakord le të ngrihet një monument edhe në Dibër, por më i madhi duhet të jetë në qendër të Shqipërisë sepse është hero Kombëtar për gjithë kombin shqiptar."

Disa ditë më parë në adresë të "Plus Gazeta Athina" me të cilën bashkëpunoj, në disa gazeta në Shqipëri dhe në internet përcolla shkrimin " A do të vijë Gjergj Gjon Kastrioti-Skënderbeu me një shesh në Athinë?" ku u bëra thirrje shtetit dhe pushtetit në Shqipëri, tubimeve të ndryshme në emigracion që të shtrohen në një tryezë bisedimi që Gjergj Kastrioti – Skënderbeu të dalë nga muzeu grek në hyrje të të cilit, në mure janë vendosur portretet e heronjve të Revolucionit e ku portreti i parë dhe më i madh është ai i Gjergj Kastriotit, dhe, i gdhendur në bronc, të vihet në një shesh me emrin e tij.

Para disa vitesh, kur u dha lajmi për ngritjen e një përmendoreje të Skënderbeut në Peshkopi shpreha dëshirën që ajo të vendosej në Sinë, më saktë në Sukë të Arrasit. Sot, në përvjetorin e 100-të të Pavarësisë së Shqipërisë, duke marr shkas që veprimtaritë filluan me një kuvend në Kuvendin Popullor pikërisht më 17 janar, në përvjetorin e fluturimit në përjetësi të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, deklaroj se ky vit përbën shansin e madh historik që Gjergj Gjon Kastrioti-Skënderbeu të hipi mbi kalë dhe të udhëtojë e qëndrojë në Vendlindje.

Veprimtarive në Dibër, krahas atyre që lidhen me Shpalljen e Pavarësisë, me shkrimet dhe ngritjen e përmendoreve për dy figurat e mëdha dibrane; Vehbi Dibrën dhe Dom Nikollë Kaçorrin, dhe figura të tjera, për mua duhet të lidhen në radhë të parë me Gjergj Kastriotin, me vënien e tij në krye të Odës Historike Dibrane.

Skënderbeu e meriton të ngrihet mbi monumente të përmasave të mëdha ballkanike e evropiane për veprën e madhe të tij me shpatë e me mendje në mbrojtje të qytetërimit të kohës, por përpara se të ngrihet atje, duhet të ngrihet në vendlindje të tij.

E cili hero apo njeri i madh i kombeve të qytetëruara nuk ka një monument, ngritur para se kudo, në vendlindjen e tij?

Athinë 25 janar 2012

Rruga e Arbërit nr. 69

opinion



Të arsyetosh vendlindjemaninë

Nga: **DIONIS XHAFA**

Një trevë që e dashuron lirinë edhe nën sakrifica sublime, me njerëz që ngjallin interes për punën, respektin ta kthejnë me respekt, nderin me nder dhe hakun me hak. Një trevë që është bërë balli i qëndresës kombëtare, që mbart peshën e një toke të "rrahur" ndër beteja e luftra, mbart vlera, doke, norma e tradita qartësisht të dallueshme, që vetëm "verbëria" e qëllimtë mundet ta hedh poshtë.

Po flas pikërisht për Dibrën, përqasjen e saj në realitet dhe e parë nën objektivin apo syrin e jashtëm, atë ç'ka "ekspertët" e vëzhgimit, studimit dhe trajtimit të imazheve e vlerave përceptojnë në një rrokje shikimi.

Po e shtroj çështjen më rrafshët. Në trajtimin tim të mëposhtëm do përpiqem të jem sa më racional, në mënyrë që të përcjell argument logjik e jo ndjesor. Duke mbajtur kokën time lidhur nën fije arsyeje, po sjell në mendje…

" Ç'është kjo hartë me dy Dibra?! " Ky varg është shkëputur nga vëllimi me poezi "Kanuni Poetik '', një vëllim me mbi 2.000 vargje me karakter përgjithësisht popullor e patriotik. Thjeshtësia dhe bukuria e këtij vargu të flet më tepër përtej tij, të flet për dhembje, për sakrificë e rebelizëm për padrejtësi .Sapo në veshin tonë tingëllon emri "Dibër e Madhe" krijohet një asosacion i çuditshëm. Vetë termi "E madhe" të flet për madhështinë e një qyteti të veshur me petk lavdie historike. Kjo për një fakt tepër të thjeshtë: Në Dibër të Madhe është mbajtur Kuvendi i Parë i shqiptarëve në vitin 1443. Kështu flet historiani Ruzhdi Lala për një reportazh të televizionit Top Channel.1)

Dibra e Madhe dhe Dibra e Vogël kanë patur fatin e keq të jenë të ndara me tela-klonin e gjembuar të kufijve shtetërorë, të asaj ndarje me një MUR të madh mes vetes.2)

Megjithatë Dibra si krahinë ka rëndësi të madhe për Shqipërinë dhe shqiptarët. Një shprehje e vjetër, që prej shumë e shumë vitesh ka qenë e gjallë, thoshte: "Si të vendoste Dibra, ashtu bëhej."

Për të mos qenë në argumentim emocional, por sa më tepër racional, vetë kryeministri i Turqisë, Ferid Pasha (kryeministër gjatë periudhës prill-tetor 1920) ka thënë: " "Në dy Dibra është zemra e Shqipërisë, Porta e Vërtetë e Shqipërisë atje është, kurdoherë". Eqerem Bej Vlora, një shkrimtar dhe politikan shqiptar i diplomuar në Perëndim ka shkruar në një vepër të tij: "Dibranët janë fisi më luftarak i shqiptarëve". Padyshim është e famshme shprehja e studiuesit britanik, Rinigald Hibertt për "Odën dibrane": "Kam mbaruar Universitetin e Oksfordit, por mbarova edhe një Universitet të dytë, atë të Dibrës".

Me këto shprehje më tepër sesa të ngrija vlerat e krahinës së Dibrës, doja të ulesha me këmbë në tokë e të rikthehesha në titull. A i meritojnë realisht dibranët këto fjalë nga më të zgjedhurat në adresë të tyre? Ndarja, "muri i Berlinit" i Shqipërisë, a ka ndikuar në përçarjen reale në dy "botë" të dibranëve? Të dyja qytetet më të rëndësishme të krahinës, Peshkopia nga njëra anë dhe Dibra e Madhe nga ana tjetër, një gazetare në një shkrim të sajin "Dibra, qyteti i fundit", i konsideron qytete të fundit, prej nga nuk ke ku shkon më tutje. Kujtohet fakti se kufiri në vend të zbutjes, savjen e forcohet. Ngrihet një pikëpyetje e madhe që dhemb. Një shekull ndarje, mos ndoshta krijoi dy identitete të ndryshme? Një shekull ndarje, mos dobësoi kulturën dhe traditën e një krahine? 3)

Dibranët, mos ndoshta krenohen më shumë me lavdinë e dikurshme, e cila është e vetmja gjë që u ka mbetur?

Çdokush mund të thotë se shprehjet që lartpërmenda kanë brenda tij edhe faktorin që ka filluar të ashtëquhet "vendlindjemani" ose dashuria e pamatë për vendlindjen, e për rrjedhojë nuk nisemi nga fakte reale, por nga ndjenja e fortë e dashurisë ndaj qytetit të lindjes.

Këtë vërejtje i tërhoqa vetes, por përnjëherësh tërhoqa dhe supet…

Isha fiks unë dhe thuajse shtatëdhjetë gazetarë të ardhshëm përpara Ben Andonit, një reportazhshkrues, reportazhet e të cilit mbahen ndër më të arrirat në vendin tonë. Pasi foli gjerë e gjatë në lidhje me eksperiencat e tij, që nga jugu në veri, që nga lindja në perëndim të Shqipërisë, ceku dy herë edhe Dibrën. Pyetjes së një studenteje, Alda Shehi, se cili ishte vendi në Shqipëri i pashkelur nga këmbët e Andonit, ai tha: Mali i Korabit. Çdo gjë ngjante në rregull, e këtu filloi të fliste më gjerë mbi Dibrën, shoqëruar me një qetësi thuajse absolute, një zë që buçiste dhe ca re të zeza të dendura mbi

Ben Andoni kishte idenë se krahina e Dibrës ishte krahinë e strukur nën hijen e heronjve të së kaluarës, e mbytur nga mentaliteti dhe mbi të gjitha e copëtuar, pa drejtim. Teksa e dëgjoja me vëmendje, mendova i kthjelluar: Mos ndoshta ka të drejtë? Për momentin më erdhën aq shumë mendime në kokë, por m'u bllokua mendimi. Nuk isha "i zoti" të reagoja përnjëherësh, më pushtoi si një valë e nxehtë e nuk më la mundësi të flisja.

Teksa ecja rrugës, filloj e reflektoj mbi atë ç'ka tha z.Andoni. Gjithandej ku kisha shkuar për Dibrën vetëm fjalë të mira kisha dëgjuar. Ishte hera e parë që dëgjoja nga dikush fjalë të tilla.

"Dashuria ndaj vendit të lindjes është dashuria e vetme që pranohet pa kushte" – thotë një shprehje. E, megjithatë përpos dëshirës, po mundohesha të logjikoja dhe bluajta me mend këto fjalë që m'u ngulën si thikë në zemër.

Është e vërtetë qëkur flet për Dibrën ke folur për historinë e Shqipërisë dhe kjo s'ka pikën e dyshimit. Duhet thjesht të përmendësh që 19 nga 24 betejat e famshme të Skënderbeut janë zhvilluar në tokën dibrane apo "Nëntë Malet", që nuk iu nënshtruan sundimit turk. 4)

Megjithatë nuk po ndalem në këtë pikë, pasi për gazetarin Andoni ishte pika që lavdëroi më së tepërmi.

Doja të fokusohesha te e tashmja, e sotmja. Meqenëse e fokusova vëmendjen në sferën ku unë kaloj pjesën më të madhe të kohës, në fakultetin tim, atë të Histori-Filologjisë, do citoja profesorin e mirënjohur, ndër filozofët e vetëm shqiptar Artan Fuga që thotë: "Miti ose historia e dikurshme është forca që e lidh njeriun me jetën, ai është vetë ekzistenca reale e njeriut." 5)

Pra, edhe nëse ajo që tregon Ben Andoni se dibranët e sotëm nuk janë ata të dikurshmit të jetë e vërtetë, përsëri është historia, gjurmët e saj që nuk mund të humbasin krejtësisht personalitetin dhe karakterin e krijuar ndër breza.

Po sot ç'ndodh me dibranët realisht?Ndodh diametrialisht e kundërta e asaj që citoi Ben Andoni."Akuza" e parë e tij ishte se dibranët janë përtacë. E si mundet kjo, kur në Dibër të Madhe më shumë se ndërton pushteti lokal rrugë, këto të fundit i ndërtojnë vetë banorët. Përveçse anës punëtore të dibranëve, këtu del në pah edhe altruizmi i tyre, jetesa në frymë solidariteti dhe tolerance.

Dibranët janë qytetarë të vyer, punëdashës të kulturuar dhe respektues të shtetit dhe ligjeve.6)

Dibranët e sotëm kurrsesi nuk e ngatërrojnë historinë me utopinë. Vlerat e tyre ata i masin me "erën" e kohës. Lavdinë e historisë dibranët e mbajnë në zemër, identifikohen me të, por nuk ecin me mendësinë e saj. Vlerat e së shkuarës "flenë" në zemrën e një dibrani, por kjo nuk do të thotë domosdoshmërish se këmbët e çojnë atë në të shkuarën, përkundrazi. Gjithashtu është shumë e vërtetë se Dibra nuk ka patur një "drejtim" bazë, por kjo gjë i është imponuar nga sistemet, që shpesh e kanë lënë pas dore, por jo nga njerëzit.

Dibra është një krahinë e Malësisë dhe si e tillë ka nxjerrë nga gjiri i saj burra për besë e trima për pushkë. Malsorët i kanë dhënë zë kombit shqiptar nëpër shekuj, i kanë dhënë heronj, dëshmorë, komandantë e ushtarë trima. Djemtë e Malësisë kanë vënë jetën e tyre në altarin e kombit. Në morinë e madhe të armatës të luftëtarëve të lirisë, të djepit të mençurisë, nuk ka sesi të mungojë, madje e para nga shoqet, Dibra!7)

Literatura:

1. TCH, Dibra e Madhe me shtatë minaret.
2. Arian Kadiu, Dibra e Madhe dhe një vështrim mbi Dibrën e Vogël
3. Gazeta Shekulli, Dibra qyteti i fundit.
4. Historiku i Dibrës
5. Artan Fuga, Peshku pa ujë.
6. Qeveria të mos diskriminojë Dibrën.
7. Të mësojmë historinë e malësisë, Bashkimi Kombëtar.

Shkruajnë lexuesit

Unë që po ju shkruaj jam Selim Pira, ushtarak 40 vjet, por edhe ish-partizan i LANÇ-it, me shkollë të lartë civile e ushtarake, një dibran nga Dardha e Nantë Maleve, tani 87 vjeç, natyra më ka falë shëndetin, mendjen dhe fizikun.

Në bibliotekën time personale kam mbi 3000 libra. Kam një arkiv të vogël me shkrimet, kujtimet e jetës, por edhe shtypin që kam ndjekur vazhdimisht, kryesisht literaturën historike e patriotike.

Une e lexoj vazhdimisht gazetën Rruga e Arbërit, pikërisht se i përcjell këto vlera nga brezi në brez, me shumë korrektesë dhe seriozitet.

Dua të vazhdoj abonimin në gazetën tuaj "Rruga e Arbrit", pasi ajo përfaqëson me dinjitet Dibrën në përgjithësi dhe mëson histori, kulturë dhe vlera patriotike.

Gazeta "Rruga e Arbërit", me redaksinë dhe bashkëpunëtorët e saj, shkruajnë me objektivitet si Xhafer Martini, Abdurahim Ashiku, Rexhep Torte, Shpëtim Cami, Zabit e Bashkim Lleshi, Adem Bunguri e shumë të tjerë.

Tematika shkencore të botuara në këtë gazetë më kanë ndihmuar që edhe unë, megjithëse i moshuar, të kujtoj të kaluarën me të mirat dhe të këqijat e saj.

Unë në jetë kam dashur vetëm të vërtetën, dhe te gazeta juaj e gjej gjithmonë këtë.

Duke ju uruar Gëzuar Vitin e Ri, gjej rastin tju uroj për suksese në punën tuaj fisnike dhe çdo familje dibrane paste vetëm gëzime.

SELIM PIRA

Për opinione dhe komente mund të na shkruani në adresën: "rrugaearberit@gmail.com". Tel. 00355 4 22 33 283.
OPINIONET DHE KOMENTET E BOTUARA NUK SHPREHIN DOMOSDOSHMËRISHT QËNDRIMIN E REDAKSISË



Prishet busti i Heroit të Popullit Nazmi Rushiti

Në një natë të ftohtë dhjetori e pa hënë, në vigjilje të festës tradicionale të vitit të ri, në mes të qytetit të Peshkopisë, në terrin e natës së ftohtë u hodh për tokë busti i "Heroit të Popullit" Nazmi Rushiti. Ishin orët më të gëzuara të qytetit ku çdo familje dhe pse mes varfërisë së tejskajshme kishin shtruar tavolinat e po ngrinin gotat me njëri-tjetrin, kur busti bie për tokë pa shumë zhurmë e bujë, pa lëndë plasëse që të dëgjohej në qytet. Tamam si ato hajdutët që dalin natën për të vjedhur, larg syrit të të tjerëve e shembën bustin e heroit në tokë. Askush nuk i pa, askush nuk ishte dëshmitar i kësaj ngjarje të dhimbshme e të turpshme. Banorët e qytetit të Peshkopisë në mëngjes kur hapën portat e filluan vizitat tek njëri-tjetri, panë këtë shëmti që kishte ndodhur në qendër të qytetit, në atë lulishte të vjetër ku shpesh pensionistët mblidheshin të gjithë tok së bashku. Vonë kur ngjarja mori dhenë e qyteti gumëzhinte nga kjo ngjarje e pahijshme shkuan për të parë në vend nga afër dhe ekspertët e policisë, të cilët konfirmuan se busti i heroit Nazmi Rushiti nuk ishte rrëzuar me lëndë plasëse por mund të jetë bërë me mjete të forta apo vegla pune të ndryshme. Dyshohet se prishja e këtij busti është bërë me qëllim hapjen e lulishtes për arsye ndërtimi dhe për të evituar reagimet e mëvonshme të banorëve të qytetit. Pra, edhe bashkia e qytetit duhet te ketë dijeni për këtë që ndodhi. Atëherë kur qenka planifikuar për lulishte me të drejtë shtrohet pyetja. Çfarë dëmi i bënte busti i heroit Nazmi Rushiti kësaj lulishteje në qendër të qytetit? Çfarë borxhi i kishte këtij qyteti heroi, i cili fali dhe jetën e tij të re për çlirimin e vendit nga pushtuesit fashist? Përse nuk u hoq në mes të ditës me diell që një veprim të tillë ta shikonte i gjithë qyteti? Dhe pyetja e fundit: Në qytet ka dhe buste të tjerë: Po tani kush e ka radhën?

Kjo ngjarje nuk duhej të kishte ndodhur në Peshkopi por ja që ndodhi, fundja vetëm hienat dalin natën, por ajo që shqetëson të gjithë është se as pushteti lokal, as forcat politike të të dy krahëve në Peshkopi, madje as dhjetëra organizata e shoqata dibrane nuk kanë reaguar. Siç duket janë bërë pjesë e këtij gjesti të shëmtuar.

/Shaqir Skarra

Kjo ngjarje e shëmtuar u bë edhe më e shëmtuar, pasi asnjë nga institucionet apo organizatat e shoqatat joqeveritare nuk kanë reaguar, duke dëshmuar kështu një "përgjumje" të gjithë shoqërisë.









Martaneshi, një ishull i varfër mes malesh

Nga: **MARIN MEMA**

Diku mes malesh, pas shpines së Bulqizës, zgjaton realiteti i dhimbshëm i një ishulli të harruar që prej s'dihet se kur. Qyteti i Krastës, kryeqëndra e Martaneshit, përpiqet të mbijetojë mes kromit e varfërise që ecin së bashku me zymtësine që shoqëron jetën e banorëve të saj. Pa rruge, me një shpresë të harruar për të ardhmen, të izoluar si të ishin të burgosur, ata duken shumë larg të fshehur e braktisur nga pjesa tjetër e botës.

Me asfaltin e hërshëm pothuajse të zhdukur e të zhgërryer, rruga drejt Krastës përngjan si një kurth vdekjeprures qe s'perfundon kurrkund. Debora dhe ngricat e bejne shpeshte frikshem udhetimin drejt kreshtave qe zgjaten e shtyhen deri tej ne horizont. Jane vetem 13 kilometra qe e ndajne nga Bulqiza, por qe duken veshtire te arritshme e te pafundme.

Krasta e hirte ofron nje pamje thuajse te mbire e te mbetur larg nga nje histori e shkuar. Pallatet e kerrusur, diku te çare e te shqyer nga koha te japin pershtypjen se gjithcka ka ngrire si ne nje foto te zverdhet, te fshehur brenda dosjesh te vjeteruara.

Mes papunesise se larte, tokave djerre per shkak te shtresave te gurta, minierat mbeten i vetmi burim te ardhurash per banoret e ketushem. E veshtire te mendosh e te shikosh nje realitet te shkeputur nga Bulqiza, edhe ketu pas galerive te kromit fshihen njerez te fuqishem qe ne Kraste hidhen vetem kalimthi, sa per te treguar rrugeve forcen e pushtetin të tyre.

E teksa e gjithe zona e Martaneshit perpelitet ne kete situate te veshtire, nga nentoka e saj dalin çdo vit jo me pak se 200 mije tone krom qe tregetohen nga te pakten 50 subjekte te licensuara. 40 milione dollare, nje shifer marramendese prej se ciles komuna Kraste merr vetem disa taksa fare te vogla, më shumë qesharake. Ndersa rreth 600 minatoret mjaftohen me kacidhet qe u rezervohen nga pronaret fitimplote e xhepngjeshur.

Ne minierat e Martaneshit kane vdekur jo pak minatore, por statistikat zyrtare mungojne apo me mire fshihen e blihen mes interesash. Edhe ketu te denuar nuk ka, faji ashtu si ne Bulqizen fqinje merret nga viktimat, pas pagesave qe kryhen për familjet nga boset e kromit.

Nese ato nuk pranojne, parate hidhen më pas tek drejtesia. Tek drejtësia, gjithcka vjen edhe me e mbytur, e kalon pa shumë zhurme. Teksa minatoret duhet te kthehen e rikthehen ne te njejtat galeri mesjetare ku jeta humbet çdo vlere te saj.

Ata jane cdo dite aty, me se shumti te pambrojtur ne tunelet e kthyer shpesh ne gracka vdekjeprurese. Per minatoret eshte nje beteje per mbijetese, ndersa per pronaret apo hijet e shtetareve pas tyre nje burim dhjamosjeje i ngritur mbi jetet e ketyre njerezve.

Jashte galerive te erreta, Martaneshi bashkejton me varferine te ulur kembekryq ne sofrat e banoreve te paqem e miqesore. 6 mije leke ne muaj ndihme sociale, vetem kaq jane te ardhurat mujore te 6 antareve te familjes Luka. Babai invalid nuk mund te punojë e nuk mund te sigurojë më shumë se kaq te ardhura për familjen e tij

"Vetëm me ndihmën sociale jetojmë. Një herë në muaj marrim ato para, që nuk na mjaftojnë as për të ngrënë. Ushqehemi me shumë vështirësi", shprehet gruaja e kësaj familje që jeton mes skamjes.

Kushtet e vështira kane detyruar femijet te mbeten pa shkolle, duke i dhene udhe analfabetizmit te tyre te plotë.

"Më vjen shumë keq, por këta dy fëmijë që kam nuk i kam dhënë dot shkollë. Dy vajzat e tjera që i kam martuar gjithashtu kaën qenë pa shkollë", rrëfen Zonja Luka.

Ne Martaneshin qe duket i drobitur, mes milionave te pafundem qe nxjerr nga nentoka e tij dhe pamundesise se banoreve per te perballuar jetesen, historite njerezore te mpleksura me dhimbjen e skamjen pasojne njeratjetren.

"Gruaja sa filloi punen theu kemben. Ia zuri blloku komplet, ishte duke i rene ne koke, por fatmirësisht u shmang dhe i zuri vetëm këmbën. Kam ndejturnje muaj me qep e me kripe per t'ia rregulluar kemben në shpi. Futemi 2 mijë metra thellësi, krejt të rrethuar me gurë, në ato galeri dhe çdo ditë nuk e dimë nëse do të arrijmë të dalim gjallë", shprehet një prej minatorëve.

Në Martanesh, ditët thjesht shtyhen, ndersa njerezit halle shume duket se kane humbur sensin e kohes e cila jo per nostalgji, diku ka ngrire mes simboleve të largeta te nje kohe te vjeter e persetejmi të mpakur e rrudhur.

E teksa e gjithe zona e Martaneshit perpelitet ne kete situate te veshtire, nga nentoka e saj dalin çdo vit jo me pak se 200 mije tone krom qe tregetohen nga te pakten 50 subjekte te licensuara. 40 milione dollare, nje shifer marramendese prej se ciles komuna Kraste merr vetem disa taksa fare te vogla, më shumë qesharake. Ndersa rreth 600 minatoret mjaftohen me kacidhet qe u rezervohen nga pronaret fitimplote e xhepngjeshur.

Vete minatoret nuk pranojne te flasin, ne te kundert rrezikojne vendin e punes. Ata kane pranuar fatin qe u eshte imponuar e mes te cilit duhet te punojne cdo dite si ne nje fije te holle mes jetes e vdekjes.

Jeta e Martaneshi, Martaneshi e jeta, nje ishulli gjendur mes malesh, ku gjithçka mbytet pa shpirt ngadale.

*** "Shqipëria tjetër" - Top – Channel, 23.01.2012.** *Titulli është i redaksisë.*









Kujtim Çerpja: Spektakël në 100 - vjetorin e shpalljes së Pavarësisë





"Valët e Drinit"

"Valët e Drinit" ka qëllimi është të rrisë dhe të mbështesë aktivitete kulturore-artistike, veçanërisht për këngën, vallen, humorin dhe të folklorit popullor të trevës së Dibrës dhe atij kombëtar. Të përkrah talentet e reja por duke aktivizuar dhe artistët më të vjetër, për të transmetuar te brezat e ardhshëm, traditën dhe vlerat kulturore të Dibrës e më gjerë.

Kujtim Çerpja, kryetari i shoqatës kulturore-artistike "Valët e Drinit" tregon për vete dhe shoqatën. Kujtim Çerpja lindi në Zalldardhë më 1961, pas mbarimit të shkollës 8-vjeçare në vendlindje, të mesmen në Krujë dhe të lartën në Institutin Bujqësor në degën zooveterineri. Ka mbaruar dhe juridikun dhe në vitin 2011 dhe masterin. Aktualisht punon në Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë në Tiranë. Njohës i anglishtes. Hobi i tij leximi dhe kënga.

Si lindi ideja për të themeluar shoqatën "Valët e Drinit"

Ishte një dëshirë e imja për raportet e mia me artin dhe kulturën e në veçanti për muzikën e gjitha trevave e në veçanti për muzikën dhe folklorin dibran. Meqë gjeta përkrahje dhe mbështetje dhe nga artistë të tjerë e themeluan shoqatën.

Diçka për lexuesit e "Rruga e Arbërit" për emërtimin "Valët e Drinit"

Në aktin e themelimit të kësaj shoqate që daton më 02.04.2003 nga Komisioni nismëtar që ishin dhe Xhelil Imeri, Hajri Mandri, Qerim Sula, Shaban Mziu etj., pati dhe mendime dhe propozime të tjera, por në mënyrë unanime u emërua "Valët e Drinit". Ka diçka, Drini jo vetëm gjeografikisht përshkruan Dibrën, brenda dhe jashtë kufijve shtetëror, por dhe trashëgiminë kulturore e historike e kemi të përbashkët.

Kur ka filluar nga veprimtaria shoqata që ju drejtoni?

Ishte Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë, me vendimin nr. 636, me gjyqtare z. Blerina Muço që firmosi vendimin për regjistrin si person juridik Shoqata Kulturore e Artistike" "Valët e Drinit" e që mban datën 18.04.2003.

Cili është qëllimi në veprimtarinë e kësaj shoqate?

Të rris e të mbështes aktivitete kulturore-artistike, veçanërisht për këngën, vallen, humorin dhe të folklorit popullor të trevës së Dibrës dhe atij kombëtar. Të përkrah talentet e reja por duke aktivizuar dhe artistët më të vjetër, për të transmetuar te brezat e ardhshëm, traditën dhe vlerat kulturore të Dibrës e më gjerë.

Si u prit shoqata në përgjithësi?

Menjëherë pas regjistrimit, grupi nismëtar, organizoi një takim në Peshkopi. Pati mjaft interes për t'u njohur me programin dhe statutin. Pjesëmarrja ishte e madhe, jo vetëm nga dashamirës të artit e kulturës, por gjetëm përkrahjen e mbështetjen dhe të z. Veli Vraniçi, Llesh Nikolla, Lirie Rasha, Avni Ndreu e të tjerë emra të shquar në art e kulturë.

Disa nga aktivitetet e kësaj shoqate?

Do përmendja fundvitin 2011, promovimin e librit "Dinjitet përballë intrigës" në Teatrin e Operas dhe e Baletit ku përveç referateve dhe diskutimeve kënduan dhe Liri Rasha e Qazim Sula. Pjesëmarrjen në takimin e rapsodëve në Lezhë. Në vitin 2010 në takimin mes grupeve dhe shoqatave artistike, shoqata kulturore e artistike "Valët e Drinit" u paraqit në konkurs, mori një çmim inkurajues e si solist këngëtari Sherif Dervishi mori çmim të parë.

Si lexues, i rregullt i librit, ç'mendim keni për librat e botuar për Zalldardhën?

Vërtet janë botuar shumë libra historikë, letrarë e monografi për Zalldardhën e dërnjanët, por secili ka vlerat e veta, por unë do veçoja botimet e Haziz Ndreut, "Dardha në nëntë malet", "Dinjitet përballë intrigës" vendi i artistëve "Zalldardha" si dhe monografi për muzikantin Muharrem Xhediku e të tjerë që kanë vërtet vlera historike e kulturore.

Mendoni se janë shkruar shumë libra për Zalldardhën?

Jo. Mendoj se duhet shkruar më shumë për Dibrën dhe për Dardhën. Në librin e z. Baram Xhafa "Dibra në luftërat e viteve 1920-1921" vetëm se i parmend luftëtarët e Reçe Dardhës me kapiten Ramadan Islami (Çerpja) Halim Shehu, Ismail Demiri i cili dha jetën me bajrak në dorë, apo Dan Sula e Dan Kaca e tjerë në luftën kundër serbëve në Orosh të Mirditës më 1921. Vërtet Dardha ka shumë artistë por ka dhe shumë dëshmorë të punës si Agim Hoxha, Vesel Poleshi, Xhelal Hysa, Arif Gjoka e të tjerë që dhanë jetën në ndërtimin e veprave të rëndësishme për të cilët po shkruhet një libër, nën kujdesin e shoqatës kulturore-artistike "Valët e Drinit".

Në rininë tuaj ju njiheni si instrumentist por dhe si këngëtar, diçka për lexuesit e gazetës "Rruga e Arbërit".

Jam aktivizuar në grupet artistike në Zalldardhë, në Krujë dhe gjatë studimeve në Universitet dhe në Tiranë. Në tre festivale të këngës së përpunuar në qytetin e Krujës në vitet 1979, 1980 dhe 1981 kam marrë tre çmime të dyta si këngëtar e dy nga këto këngë kanë qenë duet me kantautorin David Tukiçi. Edhe në festivalet e rinisë, studentore në vitin 1983 kam marrë çmim të parë në këngën "Lulkuqet e Gjakovës" një kompozim i Arqile Pikatit. Kënga pati shumë duartrokitje, bënte fjalë për një solidarizim në studentët e Prishtinës për ngjarjet e vitit 1981, por që më vonë u kritikua nga kritika partiake e kohës.

Planet tuaja në të ardhmen?

Krahas aktiviteve të tjera, si shoqatë kulturore-artistike "Valët e Drinit". Kemi një projekt për një spektakël me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë "Historia e një kombi, identiteti i një kombi, lashtësia e një kombi nuk është një produkt i një kronikani apo analisti, por është vetë jeta e brezave...". Shkruhet në "Struktura Programore e spektaklit", ku do evidentohet kontributi madhor historik i Dom Nikoll Kaçorri, Iljaz Pash Dibra, Elez Isufi etj., në momente të tjerë si kënga, vallja, kostumografia e humori. Kemi marrë kontaktet e para me specialistë si dhe me muzikantin Agim Krajka, por ju bëjmë thirrje biznesmenëve dibranë të vlerësojmë këtë eveniment, se pa kontributin e tyre financiar do e kemi të vështirë.

Ju faleminderit

Bisedoi: ILMI DERVISHI

AURORA GROUP SH.P.K

PROJEKTIM - ZBATIM

koha kalon, cilësia mbetet



Autostrada Tiranë - Durrës, Km.9

Tel: +355 48 30 2046

Tel: +355 48 30 2040

www.auroragroup.com.al

e-mail: auroragroup@auroragroup.com.al

Shkolla shqipe në Grykën e Vogël

Me rastin e 100-vjetorit të shkollës shqipe në Bllacë

Nga: **ZABIT LLESHI**



Kolektivi i klasës së 7-të. Zogje, 1962

(Vijon nga numri i kaluar)

Pas shpalljes së pavarësisë, shkollës shqipe në Grykën e Vogël ju desh të kalonte vështirësi të mëdha. Invazioni serbe pas pushtimit të Dibrës mori masa represive. Ai solli humbje të mëdha në njerëz, shkatërrimin e pasurive në masë dhe bashkë me vlerat kulturore në matriale. Pushtuesit serb ju vunë punës me zell në pjesët e pushtuara të viseve shqiptare për të hapur shkollat serbe. Ata synonin të kryenin serbizimin dhe asimilimin e popullsisë veçanërisht të brezave të rinj me mjetet e dhunës.

Në Dibër hapet një gjimnaz serb vetëem për fëmijët e këtij qarku... Në qytetin e Dibrës dhe në rrethet më të mëdha të këtij qarku të hapen që këtë verë shkollat fillore serbe. Të sillen këtu nga Serbia mësuesit më të mirë, të cilëve tu jepet një shtes solide në pagë. Të bëhen përpjekje të veçanta dhe këmbëngulse qëe në këto shkolla si dhe në gjimnaz të hyjnë fëmijë të shqiptarëve.1)

I tërë kompleksi i masave me karakter politik ushtarak, administrative, kulturor, arsimor e fetar shprehet në fjalët e politikanit Jovanovic nëe Janar 1913: Se tani pas shkeljes sëe tokave Shqipëetare na prêt një punë e lodhshme. Ne, deklaronte ai, duhet të zhvillojmë dhe qytetërojmë territoret që kemi pushtuar.2)

Sundimtarët serbomëdhenj dhe qarqet drejtuese të vendeve të tjera fqinje të verbuara nga pasionet shoviniste nuk arritën asnjëhërë të kuptonin se populli shqiptar, ashtu siç ju qëndroi rrebesheve dhe valëeve të fuqishme goditëse të asimilimit, që sollën me vete pushtuesit e shumtë gjatë historisë mijëravjeçare do t'i qëndronte akoma më mirë tani qe kishte shtetin e vet, akoma më të egër të okupatorve të rinjë serbë .3)

Patriotët e Grykës së Vogël tash duhej të luftonin në disa fronte për mbrojtje, rimëkëmbjen e ekonomisë dhe mbajtjen e gjallë të shkëndijave për shkollën shqipe. Ndërgjegjja Kombëtare për shkollën rritej, por edhe kërkesat e këmbëngulja e mësueseve edhe pse të pakët rriteshin për ditë e më tepër. Kështu ndërsa më 1909 në lëvizjen e plugut (gropa e Ujkut) Mërsim Dema kërkon nga Aqif Pashë (Elbasani) flamuj e Abetare; më 1912 shtypi i kohës njoftonte se: "Na bëjnë me dije se Mërsim Dema ka mbledhë 2000 shqiptar dhe I thotë qeverisë ja hapni Metepe shqip se ndryshe, Drini i vjetër merr ngjyrë tjetër"4 .

Luftërat ballkanike dhe ajo Botërore krijuan vështirësi të reja për shkollën e mësimin shqip, megjithatë më 1916 u rihap shkolla shqipe ne Bllacë. Seit Tasha në shtëpinë e bashkëfshatarit të tij Tahir Tasha vendosi katër banka dhe filloi mësimin shqip 5.

Pushtuesit e rinj austro-hungarez në vitet 1916 morën përsipër të hapin disa Shkolla shqipe në Dibër për të "përkëdhelur" popullsinë vendase. Ishte kjo arsyeja e rihapjes së shkollës Shqipe, në Janar 1918, në lagjen Mizinë (Homesh). Shkolla fillimisht frekuentohej vetëm nga djemtë më vonë erdhën edhe vajza pothuajse nga gjithë Gryka e Vogël. Homeshi u bë edhe qendra e Komunës së këtyre fshatrave . 6

-Me interesimin e sheh Latifit në Gjoricë u hap shkolla më 1925 me mësues Haxhi Ademi, ndërsa më 1926 me iniciativën e Pëllumb dhe Osman Lleshi çeli dyert shkolla e Zogje me mësues Abdulla Bashtarin.

-Nga Zerqani Ramiz Alliu punoi disa vjetë 4 (Në Zogjej). Janë me vlera kontributet e tij në konsolidimin e shkollave , në luftën kundër analfabetizmit, në thithjen e sa më shumë nxënësve për të ndjekur shkollat etj.

Normalistët që dolën mësues nga Gryka e Vogël si Abaz Xhafa (1934) Izet Tasha, (1934) Hamit Manjani (1942)dhe Ali lleshi (1942)u bënë pararoja e armatës së mësueseve të shkollave shqipe në Gjoricë, Homesh, Kovashicë, Mazhicë etj.

Gjatë viteve 30-40 vazhduan shkollimin për oficerë dhe punuan në ushtrinë Mbretërore Hysni Dema, Isuf Dema, Jashar Zeneli, Ahmet Cami, Hamdi Dema, Rifat Manjani, Qamil M.Lleshi, Sinan Cami, Iljas Makja etj. Në Shkolla e "Harri Fullcit", studioi Demir Leka e Ramiz Manjani, shkollën teknike në Kavajë Bilal Manjani.

Në vitet e luftës nacionalçlirimtare (1941-1944)shkolla në disa raste u ndërpre në Zogje, Gjoricë, e Kovashicë. Disa mësues si Kadri Kashari (nga Elbasani), Abas Xhafa, Hidër Manjani dolën partizan. Fasli Cami ra dëshmor I luftës më 7 Prill 1941.

-Në Zogje mësimi bëhej në shtëpinë e Dulejman Kajës derisa Aqif Leshi me 1929 me ndihmën e popullsisë fshatare të Bllacës e Stushanit ndërtuan shkollën e re pranë xhamisë. Është për t'u vlerësuar se Rustem Lleshi në Zogje e Shaqir Tomja në Kovashicë nën maskën e mësimit të fesë u krijuan mundësi të rinjve të mësonin gjuhën shqipe.

-Më 1931në Homesh u ndërtua një lokal I ri shkollor me 6 dhoma mësimi duke bërë të munduar hapjen e Internatit të parë në Dibër. Falë interesimit të Shaqir e Dinë Demës u hap edhe Konvikti :"Këtu ka ndjekur mësimet Nexhmidi Zajimi (Piktor i popullit), bashkë me disa që mbahen mend për rezultate të shkëlqyera në mësime si Adem Halili (Trebisht) Rexhep Lleshi, Tahir Makja (Gjoricë), Skënder Cani (Sofracan) etj.7)

Në këtë shkollë mësoi edhe Hysni Dema, i cili i vazhdoi studimet në Akademinë ushtarake, Vjenë.

-Me 11 Shkurt 1938 hapet e para shkollë në Kovashicë me mësues Hider Manjani (I ardhur nga Normalja e Elbasanit). Për hapjen e kësaj shkolle janë të njohura përpjekjet e Shaqir Tomës, Raman Lekës, Shahin Toçit, Shahin Metës e Riza Xhafës.

-Në Grykën e Vogël kanë punuar mësues, patriotë nga Dibra e Madhe si Haki Sharofi, Abdulla Bashtari, Qemal Drita (Turkeshi), Abdurrahim Ostreni, Aqif e Nazmie Pasholli;(Homesh), Shaqir Shaba, Sabri Sakiqi (Zogje), nga Elbasani, Shkodra etj.

Në vitet e para mbas çlirimit, në zbatim të reformës arsimore të vitit 1946, u hapen shkollat fillore në të gjitha fshatrat. Normalistëve nga Gryka e Voglë, i'u bashkuan Femi Kodra (Dibra e Madhe), që hapi të parën shkollë pas çlirimit në Viçisht (1944), Haki Sharofi (1945) Bllacë, në Shupenzë (1946)dhe Okshatinë (1946) me mësuesit respektiv Femi Lohja nga Shkodra dhe Zenepe Hatipi nga Dibra e Madhe, në Bocev Engjellushe Hoxha, dhe Qerenec Zenepe Gjata nga Elbasani, Gjuras Lufti Sharku nga Dibra e Madhe, Topojan Bajram Turja (1947) ndërsa në Mazhicë Ali Lleshi.

Nevojat per mësuesit u plotësuan me anë të kurseve dhe shkollave me afat të shkurtër. Kështu Din Sinani, Shahin Uka, Aqif Krosi, Femi Xhiveshi, Zenel Cela, Bardhul Zeneli, Liman Dani, Hamit Sinani, Rexhep Lika, Osman Leka, Fiqiri Manjani etj. Punuan si mësues duke kontribuar në konsolidimin e shkollave shqipe në Grykën e Vogël. Krahas tyre edhe Shyrete Sharku, Femije Cami, Reme Tasha ishin vajzat e para mësuese në Gjoric, Vicisht e Bllacë.

Ngjarje e rëndësishme për shkollën në Dibër ishte hapja e shkollës pedagogjike më 1948 në Peshkopi fati si nxënës të parë të kësaj shkolle e patën Skënder Sharku, Shemsi Manjani, Remzi Dema, Riza Manjani, Shefqet Uka, Osman Turja dhe Mendu Dema. Në vitet 1950-1970 arsimi në Grykën e Vogël mori zhvillime të vrullshme. Në Shupenzë (1951)u hap shkolla 7-vjeçare me konvikt, më 1959 në Zogje, 1968 ne Viçisht, 1969 në Gjuras, 1970 në Topojan e Lubalesh.

Arsimi i mesëm qe filloi me hapjen e shkollës së mesme Shupenzë më 1971, në Zogje 1978 dhe Viçisht 1986 shkollat 8-vjeçare dhe të mesme të Grykës së Vogël do të furnizonin shumë shkolla të mesme dhe të larta në shkallë republike, ku dolën mjaft kuadro drejtues që punojnë në shumë sektor të ekonomisë, në industri, bujqësi, transport, ushtri, arsim e kulturë. Tefta Cami drejtoi për gati 10-vjet si ministre e Arsimit dhe kulturës, ajo u zgjodh edhe deputete së bashku me Bukurie Lleshin (Kaja) nga radhët e mësuesve. Shumë të tjerë si Hamit Manjani, Elez Xheka, Ramis Leka, Hiqmet Tasha, Osman Patria, Nazmi Xheleshi Muharem Kola, Nazif Sulku, Femi Lika Rabie Alimani etj, kanë drejtuar prej disa vitesh shkollat duke krijuar një përvojë të lavdërueshme ne edukimin e brezit të ri.

Pa frikë, mund të themi se eksperienca e mësuesve të Grykës së Vogël është pjesë e përvojës pozitive kombëtare. Mësuesit Bajram Turja, Sali Fejzo, Flutura Dema, Bardhyle Leka, Myrvete Lusha, Avni, Medi, Latif e Mendu Dema, Xhelal Manjani, Vjollca B. Cani, Sul Xhepa, Avni Mera, Bashkim Lila, Pëllumb Kurti, Hamdi Dumani etj. Mund t'i radhitësh si ndër më të dalluarit në Dibër, por edhe në shkallë vendi. Fasli e Mois Cami kanë marrë titullin "Mësues të merituar".

Shemsi Manjani dhe Mois Cami, Hamdie Beqiri kanë drejtuar arsimin në rrethin e Dibrës e Bulqizës, si inspektor në këtë sektor kanë punuar edhe Hider Manjani, Osman Turja, Ahmet Tomja, Baftjar Shahini, Haki Duka, ndërsa Miranda Kurti në rrethin e Bulqizës.

Sot në të 17 fshatrat e Grykës së Vogël militojnë shumë mësues të rinj me arsim pedagogjik të mesëm dhe të lart që ecin në gjurmët e mësuesve të vjetër dhe me përvojë, disa prej tyre gëzonin ditët e pensionit. Është e pamundur të përmenden në këtë shkrim të shkurtër i bindur se puna dhe lufta e tyre do të jetë objekti i studimeve në fushën e arsimit duke shlyer kështu një detyrë patriotike për brezat qe do të vijnë.

Referenca

1.Nga raporti I Nacanllikut te Dibreës Spopovic me 2/15 prill 1913
2.Gjurmime arbanalogjike Prishtin 1978 faq.176
3.Thoma Morzaku politika serbe ndaj shqiperis ne luften ballkanike faq.228
4.Gazeta Shkupi 23 prill 1912
5.Muharem Alimani historiku I fshatit Bllace dorshkrim
6.Mendu Dema historiku I fshatit Homesh
7.Mendu Dema historiku I fshatit Homesh

B A S H K Ë P U N O E D H E T I
< r r u g a e a r b e r i t @ g m a i l . c o m >

Rruga e Arbërit nr. 69

Me rastin e 80 vjetorit të hapjes së shkollës së parë në Vajkal

arsim

Historik i shkurtër i zhvillimit të arsimit në Bulqizë



Nga: **BASHKIM LAMI**

Përpjekjet për shkollimin në Bulqizë janë të hershme. Vajkali e fshatrat e Luginës Bulqizës, nga pozicioni i vendosjes gjeografike, kanë qenë historikisht rrugëkalim nga lindja në perëndim të popullsisë shqipëtare dhe të tregëtarëve e ushtrive, rrjedhimisht për shumë vite kanë lëvizur edhe kulturat. Vendasit kanë ditur të përfitojnë nga këto lëvizje, anët më të mira të kulturës së të jetuarit, të punuarit, të veshjes, të zakoneve e të traditave me sensin e zhvillimit e të pranimit të së resë, duke ruajtur e trashëguar me kujdes tradicionalen, që ekziston edhe sot në të gjitha fushat e jetës. Fatkeqësisht të dhënat përpara viteve 1800 janë të pa plota. Përmendet në histori rruga e kthimit të Skënderbeut në Krujë, në vitin 1443, nëpër Vajkal, si rruga më e shkurtër për kalorës e këmbësor, beteja e Skënderbeut në Torvioll në verën e 1444, që ishte shumë afër Vajkalit, betejat e Vajkalit në vitin 1465, që janë tashmë të njohura në histori. Bulqiza përmendet në defterin turk të vitit 1467 si fshat me Zerklanin (Zerqanin) e të gjithë fshatrat e tjera të Dibrës së Epër, me qendër qytetin e Dibrës. Nuk është e rastësishme, që Vajkali përmendet në veprën e Gavrill Darës, "Kënga e sprasme e Balës", për heroin Nik Peta, që bie heroikisht në Betejën e Vajkalit, bashkë me Pal Golemin.

Mbeten të vyera përpjekjet për shkollimin e fëmijëve, si themeli i mbijetesës së kombit, kur mbretëronte varfëria e tejskajshme kudo dhe kërcënohej jeta në çdo çast. Baba Fejzë Canga (Bulqiza) njihet si i pari bulqizak i shkolluar, në fillim nga një hoxhë në Mat, më pas nga dibrani Nelë Kolari, hoxhë në Zogjaj. Ai e vazhdoj shkollimin në Stamboll për teologji, ku dhe u njoh me shumë patriot bektashianë dhe në vitin 1827 kthehet në vendlindjen e tij në Vajkal. Aty ai gjeti të ndezur dëshirën për dije dhe filloi t'ju mësonte shkrimin e gjuhës shqipe të rinjve, duke përdorur shkronjat arabe. Baba Fejza dritën e diturisë e quante si dritën e zotit. Kjo traditë më pas, u vazhdua edhe nga luftëtarët e Bulqizës, nën represionin e turqve. Me daljen e abetareve nga patriotët shqipëtar në Stamboll, në Sofje e Bukuresht, në fund të shekullit XIX Mehmet Duriçi si udhëheqës i Bulqizës, dërgoi djalin e tij Sadikun, në Stamboll, për të sjellë disa abetare, që u duheshin njerëzisë, për të mësuar gjuhën e nënës. Mehmeti organizoi bashkë me Hysen Veliun nga Mati në kullën "Duriçe", fëmijët e fshatit të lexojnë të shkruajnë gjuhën shqipe duke përdorur këto abetare. Mësimi i të shkruarit u bë zakon në çdo odë, krahas me bisedat për çështjet kombëtare. Kur mungonte abetarja në oda, kërkohej me këmbëngulje nga miqtë, pasi mësimi i shkronjave e fjalëve, bëhej me dëshirë të madhe me thëngjill, në copa dërrase e rrasa guri. Këto përpjekje bëheshin në çdo fshat, pasi shkolla e mësues nuk kishte. Pas viteve 1890 për shumë burra patriot, abetarja u bë pjesë e sendeve personale, kur nisej për të shkuar mysafir. Për t'a ruajtur nga shiu abetaren, e mbështillnin me mushama bezeje të lyer me dyll blete. Fëmijët në këto vite e kthyen në veprimin më të dëshiruar, të shkruarit e fjalëve në dheun e rrafshuar me dorë, ose në dëborë. Ato u luteshin kalimtarëve, për t'ju mësuar ndonjë shkronjë e fjalë të re. Gëzimi më i madh ishte, për çdo fëmijë, kur mësonte të shkruaj emrin e tij e të shokëve, si dhe fjalët më të dashura të gjuhës shqipe. Kjo ishte një lëvizje mbarëpopullore, që mbushte jetën e përditëshme, duke ndezur dëshirën për dije, në kushte të vështira, që e pengonin shkollimin, me të gjithë forcën e tyre. Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë gëzoj çdo bulqizak dhe ngjalli shpresën për zhvillim, por vite më pas pushtimet serbe dhe gjëndja e rëndë ekonomike e jetesës, ishin barra e rëndë e kohës, që lanë shumë prapa shkollimin, pasi nuk u ndërtuan shkolla dhe nuk kishte mësues. Disa fëmijë bulqizakë si, *Hysni Voci, Elmas Tançi, Zenel Shehu, Shahin Lami, Muharrem Tançi,* arritën të shkollohen në Zerqan, ku ishte hapur shkolla nga Sheh Sula, qysh në vitin 1893, ose në Tiranë. Në vitin 1925 u vendos nga qeveria e kohës të hapej shkolla fillore verore në Vajkal, por nuk kishte mësues dhe disa nxënës vazhduan shkollën në Zerqan. Në vitin 1927 Nënprefektura e Zerqanit kishte 49 fshatra me 19261 banorë, ku funksiononin 9 shkolla fillore me 420 nxënës. Deri në këtë kohë kishin kryer shkollë fillore 117 veta nga kjo krahinë. Populsia ishte 3% e shkolluar (sipas Teki Selenicës në "Shqipëria më 1927"). Sipas shkresës 3101 datë 31 dhjetor 1931 të Prefekturës së Dibrës, u kërkua në ministrinë e arsimit të plotësohej me mësues Shkolla e Vajkalit, por mësuesi erdhi vetëm në prill të vitit 1932, kur në të gjithë Dibrën funksiononin 32 shkolla e tre internate. Kryeplaku i Vajkalit, Sulë Duriçi,që kujdesej për hapjen e shkollës bashkë me mësuesit e parë Osman Topçiu që erdhi nga Kruja, e vendosën shkollën, në shtëpinë e Veli Rutës, ndërsa mësuesi u strehua nga Hazis Alla (sipas tregimit të Selim Allës e Xhaferr Gjokës). Në vitin 1935 mësues ishte Hamdi Faja nga Kavaja e më pas Abdyl Keçi nga Tirana, që mbylli vitin shkollor. Mësohej këndim, gjuhë, aritmetikë, histori, gjeografi, dituri natyre, bukurshkrim, këngë e gjimnastikë. Mësimin fetar e bënte Muharrem Hoxha nga Valikardha. Nxënësit e parë qenë *Myslim Shehu, Ismail Gjoka, Hajdar Shehu,Miftar Hasa, Kamber Duriçi, Selim Alla, Kasem Duriçi,*



SKICA E SHKOLLËS FILLORE NË VAJKAL E NDËRTUAR NË VITIN 1946

Hamit Gjoka, Sali Koçi, Mustafa Duriçi, Aqif Duriçi, Ibrahim Çupi, Gjyl Çupi, Xhaferr Gjoka, Sali Kola, Mexhit Bala, Jahe Hoxha, Xhaferr Sadiku, Ramiz Lamani, Ismail Çupi, etj, të cilët pohonin për mungesat e mëdha që kishin për libra e fletore, ndërsa për mjete didaktike as që bëhej fjalë. Ish nxënësit kujtojnë festimin në oborrin e shkollës të martesës mbretit Zog i I-rë, kur mësuesi Abdyl Keçi foli përpara fshatarëve dhe nxënësve në këtë festë. Shkolla funksionoi me shumë vështirësi me 20-24 nxënës me mosha të ndryshme, deri në vitin 1939. Gjatë luftës dytë botërore 1940-1945 shkolla e Vajkalit nuk funksionoj pasi nuk kishte mësues.

Lufta kishte kthyer në zero çështjen e shkollimit të fëmijëve, por ndjenja kombëtare dhe dëshira për dije ishte e gjallë dhe populli i Bulqizës e filloi punën e rindërtimit me shkollën e re. Në verën e vitit 1945, në Vajkal Shahin Lami ishte ngarkuar të organizonte rindërtimin e shtëpive të djegura të fshatit, të urave e mullinjve, ku u planifikua edhe ndërtimi i shkollës fillore të re me dy klasa. Mbetet e paharruar puna e fshatarëve të Vajkalit që plotësuan në kohë të gjitha detyrat që caktoi komisioni. Gjatë kësaj kohe funksionoi në fshat, kursi kundër analfabetizmit, i drejtuar nga Elmaz Tançi, me dy ditë në javë në dy grupe, tek shtëpia e Abedin Tyçit. Në këtë kurs pati pjesmarrje të lartë të grave e vajzave të fshatit, që arritën të mësojnë shkrim e këndim, pak histori e gjeografi, si dhe tabelën e shumëzimit e katër veprimet aritmetike me numra. Fillimi i kursit pati shumë vështirësi, prej mentalitetit, por vazhdoi me shumë sukses për të gjithë pjesmarrësit. Suksesi i këtij kursi, u pasqyrua në vazhdimin e shkollës fillore nga të gjithë fëmijët e fshatit. Në vitin 1946 në të gjithë dibrën funksiononin 26 shkolla fillore me 1730 nxënës e 50 mësues. Në Zerqan në vitin 1946 u hap shkolla unike dhe një vit më pas u hapën shkollat fillore verore në Dushaj, Koçaj e Fushë Bulqizë. Më 24 mars 1946 në Vajkal, filloi mësimi në shkollën e re fillore me 24 nxënës, me mësuesin Hysen Balla, që kishte mësuar në shkollën tregëtare të Tiranës. Nxënësit e parë ishin Rakip Hasa, Skënder Shehu, Lutfi Dauti, Lahim Koçi, Xhemal Hasa, Hysni Balla, Fiqiri Kurti, Riza Gjoka, Allaman Duriçi, Riza Duriçi, Vehbi Keta, Shukri Keta, Muiz Cami, Sulë Zeneli, Shefqet Koçi, Rabie Koçi, Hazbie Shehu, Zahide Keta, Fiqe Hasa, Jete Lami, Sibe Ruta, Mexhit Duriçi, Haki Hysa, Rakip Voci, Mustafa Shehu, Tahir Dauti, Muharrem Gjoka, Medi Dauti, Farie Tançi, Muiz Tançi, Bedrie Tançi, Ismail Hida, Mergim Tançi, Muharrem Q.Çupi, etj. Disa vajkalorë shkollën unike e vazhduan në Zerqan deri në vitin 1955, si Shefqet Tançi, Lutfi Dauti, Vehbi Keta, Sulë Shehu, Mustafa Shehu, Islam Dauti, Mergim Tançi, Muiz Tançi,etj të cilët u bënë specialistë në fusha të ndryshme. Pas vitit 1946 në shkollën e Vajkalit punuan si mësues, *Hysen Balla, Bajram Minjolli, Riza Gurra, Hasan Palushi, Lirie Palushi,Elez Jovani, Shahin Uka, Kadri Dumani, Ibrahim Dërvishi, Qemal Gjura, Xhemal Sejdi, Dule Topi, Gani Marku, Myfit Imerri, etj* puna e të cilëve kujtohet me mirënjohje nga banorët e Vajkalit. Në shkollën e Vajkalit kanë vazhduar mësimin edhe fëmijët e qytetit të ri të Bulqizës, deri në vitin 1955. Në vitin 1958 nxënësit e Vajkalit vazhduan mësimin në shkollën e qytetit Bulqizë, për dy vite, sa u bë riparimi i dëmtimeve. Më pas punuan në shkollën e Vajkalit mësuesit vendas, *Hasan Duriçi, Shefqet Tançi, Fiqiri Duriçi, Zelie Rama, Lavdie Duriçi, Vjollca Keta, Manushaqe Keta, Shadie Tançi.* Krahas me vendasit erdhën edhe mësues të tjerë dibranë që mbetën të paharruar nga fëmijët e Vajkalit, si *Rakip Alliu, Bujar Novaku, Kujtim Gjeleshi, Vasfie Gjeleshi, Shukri Xheleka, Ali Lila, Drita Puca, Faik Cami, Iljaz Skara, Tefta Daci, Avni Islami, Naim Turja, Fiqerete Cami, Vasfie Likalla, Vjollca Daci, Kimete Strazimiri, Fatbardha Lami, Dafina Asllani, Zylfie Plloçi, Ilda Dervishi, Elmira Isaku, etj,* Mësues të talentuar në vite krijuan modelin e përparuar dhe e futën shkollën në rrjedhën e arritjeve, duke përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe bazën didaktike të ndërtuar me përkushtimin e vetë mësuesve e prindëve arsimdashës. Në këtë shkollë e nisën rrugën e jetës mjaft fëmijë vajkalas, që mbaruan shkolla të larta e specializime, e u bënë, mësues, mjekë, inxhinierë, teknikë e specialist të shumë fushave, duke punuan bashkë me kuadro të tjerë nga gjithë Shqipëria, në të gjithë sektorët e jetës e të punës, në Bulqizën e re.

Rritja e qytetit të Bulqizës dhe e prodhimit të kromit, nuk mund të mendohej pa kushte të shkollimit të fëmijëve, që do të bëheshin aktorë të rëndësishëm të zhvillimit industrial e shoqëror. Në vitin 1953 në qytetin e Bulqizës, ku ishin vendosur familjet e para, u hap shkolla 7-vjeçare e mbrëmjes, për punëtorët e minjerës e policët e burgut, me mësues Jeshar Kamberi, Fiqiri Myrtezai. Mësimi bëhej në barakat e minjerës në kushte tepër të vështira. Fëmijët e familjeve të para, që erdhën në qytet, e vazhdonin shkollën fillore në Vajkal. Në vitin 1955 u hap shkolla 7-vjeçare e ditës ku vijonin mësimin, fëmijët e Vajkalit e të Qytetit Bulqizës në shkollën e re, me 7 klasa të sapondërtuar. Drejtorë të parë të shkollës kanë qenë Luan Xheneti, Ramiz Gjoka, e mësues *Fiqiri Myrtezai, Nazmi Plaku, Enver Hysa, Lutfi Hanku, Dilaver Hasa, Melaim Peza, Zenel Disha, Baudin Strazimiri, Prida Qili, Besnik Bedolli, Skënder Sharku, Frida Spiro, Myfit Dërvishi, Shaqir Karahasani, Xhetan Strazimiri, Sabri Alliu, Xhelal Manjani, Pëllumb Qosja, Fiqiri Novaku, Shemsi Ceka, etj.* Nxënësit e viteve të para ishin, *Shefqet Duriçi, Ismail Hida, Skender Keta, Hajdar Duriçi, Vjollca Rusi, Mihal Kocaqi, Zenel Duriçi, Sotir Vreto, Esat Keta,Ali Sula, Sulë Sula, Përparim Rama, Isuf Keta, Barie Cani, Lirie Jakupi, Gani Gjoka, Zenel Toluli, Zelie Keta,*



PAMJE E SHKOLLËS MESME NË BULQIZË

përvjetor





Hazis M. Keta, Kliton Rusi, Fasli Partalli, Islam Lamani, Asllan Lami, Bajram Kola, Fiqiri Duriçi, Naim Duriçi, Nebi Duriçi, Vehap Shehu, Enver Selmani, Flutra Daci, Seit Jakupi, Haxhi Llani, Faik Duriçi, Lulëzim Daci, Zelie Tançi, Hike Llani, Bashkim Lami, Besnik Belishova, Lavdie Pejzaku, Isuf Llorja, Bajram Dauti, Hajredin Gjoka, Bajram Keta, Muharrem Ruta, Hamza Duriçi, etj.

Në vitin 1957 u ndërtua çerdhja e re dhe kopështi ku edukatore punuan, *Bedrie Kola, Shyqyrie Beta, Eleni Kola, Sofie Dërvishi, Shyrete Sharku, Aishe Losha, Hike Duriçi, Lavdie Gjura,* etj. Në vitin 1964 u ndërtua shkollë e re, me 10 dhoma mësimi poshtë rrugës së qytetit, duke plotësuar nevojat e nxënësve për ambjente mësimi. U ndërtuan rreth shkollës edhe disa terrene sportive, volejbolli, basketbolli e gjimnastike, të cilat shfrytëzoheshin edhe nga rinia e qytetit.

Në vitin 1967 u hap shkolla e mesme e mbrëmjes si gjimnaz, me drejtor Myfit Dervishin, për të plotësuar me kuadro të kualifikuar të gjithë sektorët e punëve në Bulqizë. Mësimi bëhej në ambjentet e shkollës 7-vjeçare. Në vitin 1968 me kërkesën e vetë nxënësve, u kthye në shkollë e mesme profesionale pa shkëputje nga puna, me degët për teknikë minire, gjeologjie e elektromekanike. ***Ishte koha kur për arsimin kërkohej masivizimi, duke vlerësuar ngritjen e nivelit të dijeve, duke përdorur metoda të reja pedagogjike për një mësim krijues, në kushtet e presionit të lartë politik, kur mësuesit ishin të pasigurtë, për të thënë e bërë atë që mendonin.*** Në përballje me koncepte të vjetra u rregjistruan në shkollën e mbrëmjes plot gra e vajza, që u bënë teknike e inxhiniere në detyra të ndryshme në të gjitha ndërmarrjet. Mësimin për lëndët e përgjithëshme e bënin mësuesit: *Myfit Dervishin Ramiz Gjoka, Sabri Alliu, Skënder Sharku, Selman Alla, Bashkim Lami, Jonuz Muça, Petrit Turja, Hasan Lami, Hamit Dervishi, Sejfulla Shehu,* ndërsa mësimin e lëndëve profesionale e bënin inxhinierët: *Jorgo Kola, Agim Dobi, Koço Gusho, Gani Gurra, Artan Ceka, Todi Sema, Bashkim Lleshi, Rustan Loka, Hamza Gurra, Lazër Jaku, Burhan Lohja, Niko Lula, Fatjon Tugu, Hasan Bekteshi, Hasan Ulqinaku, Bujar Pata, Përparim Hoxha, Gjergji Xeka, Gafurr Muka, Fatmir Beqiri, Asllan Pata, Osman Miha, Zija Ndrukaj, Hamdi Haka, Hajdar Kacani, Mustafa Sadiku, etj.*

Drejtues e mësues të shkollave të Bulqizës me forma efikase pedagogjike, gjenin intrumenta e forma të larmishme, për të edukuar qytetarë vizionar, duke bërë që nga bangot e shkollës, të nisin udhën e mëtejshme të dijeve në profesione të ndryshme, me plot siguri, breza të tërë nxënësish, që më pas u bënë kuadro të zotë e teknikë të aftë, në shërbim të Bulqizës.

Në vitin 1971 bashkë me shkollën e mbrëmjes filloi edhe shkolla e mesme profesionale e ditës me degën për teknikë miniere, por më pas u shtuan edhe degë të tjera; gjimnaz, bujqësore, gjeollogji e çpim pusesh. Nxënësit ishin nga qyteti e fshatrat e Bulqizës, nga Zerqani, Shupenza e Plani i Bardhë. Teknikët që mbaruan në këto vite, plotësuan nevojat për drejtim të kualifikuar, në proçeset e punës në minierë e gjeollogji, që ishin ndërmarrje të mëdha të prodhimit e kërkimit të kromit në Bulqizë. Nxënësit me rezultate të mira vazhduan degët e shkollave të larta në Universitetin e Tiranës, si *Naim Karai, Hysen Hoxha, Kapllan Alia, Kujtim Gjoka, Gëzim Dauti, Vehbi Musta, Afrim Okshtuni, Agim Vargu, Gani Çupi, Hajdar Kacani, Petrit Hupi, Zaim Keta,Fadil Cani, Petrit Duva, Veli Losha, Bajram Bruçi, Bardhul Cani,etj,* që u bënë specialist të lartë, që plotësuan nevojat e dhanë kontribut të rëndësishëm professional, në ndërmarrjet e Bulqizës. Inxhinierët e tjerë më të rinj *Afrim Dërvishi, Astrit Xhafa, Fehmi Tançi, Hidër Turja, Eduart Keta, Artur Alia, Baftjar Bici, Arjan Lami, Mufit Lamani, Përparim Gjura, Islam Nika, Ylli Spahiu, Leonard Kazanxhiu, Edmond Xhafa,etj,* morën angazhime e detyra të rëndësishme dhe bashkë me specialistët e dalë nga shkollat e Bulqizës, plotësuan me dinjitet e profesionalizëm drejtimin e punëve në minierë, gjeologji, fabrikë e ofiçina , duke përmbushur misionin e kësaj shkolle, të lidhur me prodhimin e kromit dhe me vetë Bulqizën, që po rritej çdo ditë.

Ish nxënësit e teknikumit të Bulqizës drejtuan me përgjegjësi sektorë e brigada, duke arritur rezultate të larta, si *Hamdi Leti, Hajdar Pasha, Mustafa Lami, Agim Kaçani, Ali Shehu, Selim Gjoka, Gani Keta, Selim Kaloshi, Surja Uka, Kujtim Xh Gjoka, Bashkim Dedja, Shpëtim Farruku,* e plot të tjerë, që e treguan veten të talentuar duke i dhënë emër edhe shkollës që i pregatiti. Nxënës të gjimnazit të Bulqizës u bënë kuadro të lartë në profesionet, juristë, ekonomistë, mësues, mjekë, etj, *Shyqyrie Selita, Nekie Sula, Zemrie Dauti, Xhemile Bala, Edlira Luku, Valbona Kamberi, Manushaqe Hoxha, Majlinda Duriçi, Ilir Duriçi, Roland Keta, Altin Keta, Hajrie Lamani, Mimoza Kola, Terezina Bilaçi,* etj, që plotësuan e gjallëruan jetën dhe punën në këtë qytet.

Në vitin 1973 u ndërtua shkollë e re trekatëshe me 15 klasa mësimi e 4 kabinete, ku do të mësonin 1200 nxënës. Në vitin 1977 shkolla e mesme u bë drejtori më vete dhe drejtor u caktua, inxhinieri i minieres, Osman Miha, që e drejtoi këtë shkollë deri në vitin 1990. Në vitin 1975-1976 u hap shkolla e mesme e përgjithëshme pa shkëputje nga puna. Në vitin 1976-1977 u hap dega bujqësore, u krijua baza proshuese eksperimentale me 5 dynym tokë si dhe baza prodhuese e shkollës profesionale me paisje ofiçine e zdrukthtarie. Në vitin 1979 shkollës profesionale iu shtua, dega e çpimit me shkëputje nga puna. Shkolla pati arritje drejt masivizimit dhe u plotësua me hapjen e gjimnazit, ku kryesisht e vazhdonin vajzat e qytetit dhe të zonës. Ndoshta do të vij përsëri një ditë që shkolla profesionale që u mbyll në vitin 1994, të rihapet përsëri për të vazhduar misionin e saj lidhur me kushtet e reja që ka sjellë demokracia, ekonomia e tregut dhe gjithë zhvillimi i jetës në Bulqizën e "Arit të murrmë".

Nuk ka punë më fisnike e mbresëlënëse për vendin tënd, sesa puna dhe misioni i mësuesve, në mësimin e edukimin e nxënësve, për t'i pregatitur me njohuri të gjithanëshme për të ardhmen e tyre e të vendit. Mësuesit e klasës së parë, veçanërisht mbeten të skalitur në kujtesën e fëmijëve. Shkonjat e para fëmijëve të Bulqizës u a mësuan me shumë dashuri mësuesit me përvojë pedagogjike, *si Shefqet Tançi, Shyrete Sharku, Fiqerete Strazimiri, Zisa Muça, Kize Kadiu, Mehdi Gjeleshi, Fiqiri Duriçi, Tefta Daci, Drita Puca, Peme Elmazi, Shpresa Meta, Myzejen Muça, Faik e Sadete Cami, Zelie Rama, Hike Duriçi, Liri Nano, Jorgjie Mëhilli, Bukurie Shehu, Suzana Gurra, Shpresa Cukalla, Sanie Gjapi, Sulltane Lami, Antoneta Vatnika, Davë Lleshi, Tefta Sula, Gjyle Karahasani, Lubjana Dançe, Davë Llusku, Durime Lleshi, Nadire Murrja, Xhevrije Bruçi, Ramije Alia, Ilda Alushi, Edlira Çupi, Valbona Kamberri, Manushaqe Keta, Gëzim e Marie Xhidra, etj.*

Shkolla u bë qendër e gjallërimit të jetës në këtë qytet me veprimtari artistike, kulturore e sportive në festa e kampionate. Ish xënës të shkollave të Bulqizës si *Azem Teta, Selim M Alliu, Fllanza Çupi, Hide Jangulli, Roland Lami, Dëfrim Mandri, Leonard Lala, Nard Gjoka, Ylli Lami, etj,* u bënë muzikantë e aktorë dhe përfaqësuan shkollën e qytetin, në festivale zonale e kombëtare.

Gjallërimin e aktiviteteve sportive të qytetit, u bë gjithmonë nën drejtimin e mësuesve të fizkulturës, *Zabit Kaci, Sabri Abdiu, Mukades Muça, Enver Mera, Nafije Lleshi, Natasha Laçej, Mustafa Trepça, Rami Hoxha, Ilir e Kozeta Disha, Gëzim Mata, Jeshar Shehu, etj.* Nxënësit, mësuesit e të rinjtë pushtuan me marrshime të gjitha majat e maleve përreth. U organizuan kampionate për futboll, ski, shah, lojra popullore, duke arritur rezultate të mira. Ekipin e futbollit "18 Shkurti" e plotësuan nxënësit *Njazi Koçi, Ilir Disha, Ilmi Cani, etj.*

Vajza të kësaj shkolle u bënë inxhiniere, si *Lloreni Kola, Rolanda Dërvishi, Albana Alla, Natasha Velia,etj.* Të tjera vajza mbaruan shkollën e lartë në degë të tjera, si *Nafije Lleshi (fizkulturë), Hazbie Jella, Nazife Lamani, Mbaresa Strazimiri (farmaci), Majlinda Shehu (mjekësi), Donika Cani e Xhemile Gjoka (ekonomi), Aishe Balla, Lumturie Balla, Fllanza Lamani, Albana Balla (mësuesi) e shumë të tjerë.*

Në të gjithë historinë e arsimit në Bulqizë, themeli i punës me nivel të lartë metodik e profesional në shkolla u ruajt nga mësuesit dibranë, si *Ramiz Gjoka, Jashar Kamberri,*

(Vijon në faqen 15)





Dibra në defterët osmanë



Këto ditë doli në qarkullim libri: "Dibra në defterët osmanë 1467,1583" një libër i cili për kah numri i madh i përdoruesve të mundshëm, mund të konsiderohet si një libër i veçantë për lexuesit e shumtë dibranë që deri më sot u ka munguar. Prej shumë e shumë kohësh, në rrethet shkencore e historike ka dominuar mendimi se për shumë dokumente të periudhës osmane qasja për ti shfrytëzuar ato, ka qenë dhe vazhdon të mbetet mjaftë e ulët ,dhe kjo për faktin e njohur tashmë, të mungesës së përkthyesve të kësaj gjuhe. Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se sa shumë dokumente e informacione për historinë tonë, "fshihen" nëpër rreshtat a fletët e shumta të arkivave të turqisë. Perandoria osmane ka qenë një superfuqi e asaj kohe dhe si e tillë ajo ka lënë edhe një sasi të madhe e të bollshme materialesh shkresore që lidhen me çdo krahinë të vendit tonë, të cilat nëse do të përkthehesin , do të hidhnin dritë mbi shumë të panjohura të historisë së popullit tonë. Shpeshherë, nëpërmjet medias së shkruar dhe asaj vizive është ngritur ky problem, por gjithnjë këto kërkesa, kanë rënë në vesh të shurdhër dhe janë shoqëruar me heshtje vrastare. Sa e sa herë jemi përballë me kërkesat permanente të opinionit dashamirës të historisë, për tu njohur më këtë kategori dokumentesh, të periudhës së Perandorisë osmane. Në këtë kuadër, libri i sapo botuar me autor Zyber Gjoni e Haki Përnezha mëton të plotësojë pikërisht boshllëkun për të cilin sapo folëm. Përpjekje të tilla në këtë fushë janë gjithnjë të mirëpritura. Çdo lloj dokumenti që vjen nga ajo periudhë, pavarësisht nga natyra e klasifikimi i tij, përbën vërtet një burim të rëndësishëm informacioni. Parë në këtë këndvështrim, edhe botimi i të dhënave të defterëve osmanë, është një arritje e madhe në fushën e letrave. Jemi plotësisht të ndërgjegjshëm për punën e madhe e të palodhur të bërë, nga autorët e librit, për sigurimin e materialeve arkivore, sistemimin e tyre e deri në botim. Dhe falë punës së tyre të palodhur e me përkushtim, kemi sot në dorë këtë libër, që për mendimin tonë do t'ju shërbejë një numri shumë të madh lexuesish. Jo vetëm ata që në njëfarë mënyre merren me historinë, por çdo njeri që dëshiron të dijë më shumë për fshatin e tij, për numrin e banorëve, për strukturën e popullsisë, për llojin e taksave të paguara, bimët e kultivuara për ushqim apo ato industriale në çdo fshat të Dibrës, etj, etj, duhet të shfletojë faqet e këtij libri. Që në kopertinë bie në sy thjeshtësia e korrektesa që të shoqëron deri në fund të tij. Autorët kanë zgjedhë momentin, 100 vjetorin e Pavarësisë, për t'ia paraqitur lexuesit dibranë këto materiale, deri më sot të panjohura. Është me të vërtetë për tu përgëzuar puna e bërë nga autorët dhe shpresojmë që në një të ardhme të shpejtë ata do t'ia arrijnë të sigurojnë e plotësojnë serinë e këtyre dokumenteva me defterët e mëvonshme siç është ai i vitit 1613, 1724 etj. Duke shfletuar librin "Dibra në defterët osmanë 1467,1513", çdo njeri merr informacion të plotë e të vyer për fshatin e tij të shekullit XV. Që në fletën e parë autorët na kanë sjellë dy filograma të cilat u përkasin dy sulltanëve të atyre viteve. Janë vulat (mihirët) që ata kanë mbajtë në gisht dhe kanë nënshkruar sa e sa dekrete e vendime ta asaj kohe. Ne sot i shohim me kërshëri këto forma "firmash" të gdhendura në unazat e mëdha të florinjta që sulltanët mbanin në gisht. Për çdo lexues është e lehtë të konstatohet përpjekja e autorëve për të vendosur pranë e pranë informacionet në të dy regjistrimet e kryera. Kjo punë patjetër që ka pasë në qendër të vëmendjes identifikimin e fshatrave të Dibrës. Ashtu siç përmendet edhe nga autorët e librit, V.Buharaja ka bërë një punë të lavdërueshme në këtë proces por sërish mbeten edhe shumë fshatra të tillë që mbeten pa u përcaktuar. Megjithë thirrjen e sinqertë që autorët bëjnë për të përfshirë sa më shumë në identifikimin e fshatrave që ende janë të paidentifikuar, mendojmë se kjo punë nuk mund t'i lihet spontanitetit. Për realizimin e saj, mendojmë se duhet një punë e organizuar mirë, nevojitet përfshirja e sa më shumë njerëzve të interesuar nga çdo fshat e krahinë dhe e gjitha kjo punë duhet të drejtohet nga Muzeu i Rrethit. Shpresojmë dhe urojmë që kjo punë të përfundohet me dëshirën e mirë që secili të kontribuojë nga pak në të mirë të njohjes së historisë së Dibrës. Ky është shërbimi që çdo intelektual dibranë duhet t'i bëjë në radhë të parë vendlindjes.

Tani le ti rikthehemi përsëri librit të sipër cituar "Dibra në Defterët Osmanë 1467,1583". Siç është shënuar edhe nga autorët, në këto dy regjistrime nuk kemi të shënuar taksën e "haraçit" apo ndryshe "xhizen". Shtrohet pyetja: A është mbledhë kjo taksë në Dibër?!. Ne mendojmë se kjo taksë edhe pse nuk është pasqyruar në defterët osmanë është vjelë në të gjithë fshatrat me popullsi të krishtere. Në fakt kjo vërtetohet në mënyrë indirekte edhe nga shënimi i bërë për fshatin e Muhurrit, ku thuhet se "banorët e fshatrave të Çidhnës, kanë kundërshtuar, qeveritarët turq (spahinjtë) për të paguar haraëin". Ndërsa në të dy regjistrimet e kryera (1467 dhe 1583) këto fshatra janë të regjistruar dhe i kanë paguar detyrimet tatimore si çdo fshat tjetër, por siç duket ata kanë kundërshtuar "haraçin", këtë taksë shkatërruese për familjet shqiptare. Mendojmë se ky ka qenë shkaku i nisjes së revoltave e kundërshtimit të armatosur në fillim vitet e shek XVI, në Dibër të Poshtme. Një punë e mirë nga ana e autorëve është bërë edhe në sqarimin dhe përcaktimin e strukturës së taksave të vjelura, subjekt i të cilave ishin familjet dibrane. Aty përmendet klasifikimi i familjeve myslimane në varësi të pronës që ato zotëronin, duke i emëruar ato në "familje myslimane çift; familje gjysmë çift dhe familje benak" dhe kjo vihet re vetëm në shënimet e bëra në defterin e vitit 1583, pasi në atë të vitit 1467, shënimet janë më të përgjithshme. Megjithë këtë duhet thënë se autorët duhej të kishin sqaruar më mirë se në çdo fshat, sipërfaqet bujqësore, u janë shpërndarë: a. familjeve myslimane, si pronë e dhënë në përdorim; b.familjeve kristiane si pronë e dhënë në përdorim; dhe c. sipërfaqe toke apo mullinj që u jepeshin si shpërblim zyrtarëve të vegjël të qeverisë osmane. Vini re se si këto prona të quajtura "çifligje" nuk paguanin asnjë taksë. Poseduesit e këtyre çifligjeve kryenin shërbime të ndryshme në favor të qeverisë osmane ndaj dhe ajo i "shpërblente" me copat më të mira të tokave bujqësore. Ashtu siç thuhet edhe nga autorët, ky libër mund të shërbejë edhe për të krijuar një ide me të plotë rreth kulturave bujqësore që kanë përdorë të parët tanë si dhe të bimëve industriale të asaj kohe. Duke pasur këto të dhëna mbi sasinë e prodhimeve të tatuara për çdo fshat ne mund të llogarisim përafërsisht prodhimin e drithërave të bukës si dhe të krijojmë ide rreth strukturës së të ushqyerit të paraardhësve tanë. Dhe është fare e lehtë të konstatohet se ushqimi bazë i dibranëve ka qenë gruri, i cili, sipas shënimeve të pasqyruara në librin në fjalë, është kultivuar në çdo fshat të Dibrës. Përveç grurit, në pothuajse të gjithë fshatrat e Dibrës është tatuar edhe lëngu i rrushit, mushti i rrushit, duke na bindur se në sofrat fshatare të kësaj treve lëngu i rrushit ishte pija kryesore. Në këtë libër nuk gjenden shënime që tregojnë se janë tatuar apo paguar taksa për bagëtitë, me përjashtim të ndonjë fshati nga Dibra e Epër, ndërsa nuk është lënë pa tatuar asnjë e ardhur për fshatarët qofshin këto edhe nga kullotat e malit. Nuk mund të lëmë pa përmendur edhe një fakt që në libër është përmendur shkarazi. Nga gjithë kjo sasi e madhe taksash që mblidheshin në banorët e asaj kohe, asnjë e ardhur (taksë e vjelur) nuk u kthehej banorëve në formë investimi, edhe pse nevojat për ura, kroje, kanale vaditëse etj, ishin shumë të mëdha.

Në asnjë regjistrim nuk është evidentuar ndonjë rast ku qeveria osmane të ketë shpenzuar ndonjë vlerë në shërbim të komunitetit. Në fakt sipas dokumenteve të paraqitura në libër, regjistruesit osmanë, vetëm në një rast kanë konstatuar rëndësinë e ndërtimit të një ure për zonën e Zerqanit, por edhe kjo ka mbetur në fazën e konstatimit. Si do që të jetë dhe pavarësisht të metave që vërehen në këtë libër, mendojmë se botimi dhe dalja në treg e tij na bën nder dhe mbush një boshllëk të madh që ka ekzistuar deri më sot në lidhje me dokumentet arkivore osmane. Edhe njëherë gjemë rastin që ti përgëzojmë nga zemra autorët për punën e madhe e këmbëngulëse që kanë bërë duke shpresuar që së shpejti do të kemi edhe volumin pasardhës të serisë së dokumenteve osmane.

ERALDA SKARRA
studente në gazetari



Email: **info@devadesign.net.** *Phone:* **612 203 5960.** **www.devadesign.net**

të reja





Autori nuk e kishte imagjinuar se edhe në Kanada ashtu si në Shqipërinë e pas viteve 90 do të gjente doktorët e shkencave duke punuar taksistë, projektuesit duke shitur mish, piktorët duke larë pjata, filozofët duke gjuajtur peshk.

Drejtësi apo xhungël

Shënime rreth vëllimit me të njëjtin titull të poetit shqiptaro-kanadez Elliott Moglica

Kohët e fundit poeti shqiptaro-kanadez Elliott Moglica ka botuar dhe vënë në qarkullim në Shqipëri dhe në Kanada vëllimin e tij në gjuhën angleze "Justice or jungle" (Drejtësi apo xhungël)

Ajo që të bie menjëherë në sy është fakti se autori megjithse i larguar nga Shqipëria prej vitesh ngre një shqetësim që mesa duket qenka i përbotshëm, shqetësim për triumfin e drejtësisë. Autori e hap librin me thënien e Ajshtajnit "Shpirtra të mëdhenj kanë inkurajuar gjithmonë ngritjen krye ndaj mendimit mediokër dhe mendjeve mediokre. Dhe për konçidencë apo çudi vendi ynë, bile tërë kombi shqiptar ka vuajtur prej dekadash nga liderit mediokër dhe mendimi mediokër. Më tej autori po në parathënie thotë se të humbësh nuk është asgjë, por të lejosh drejtësinë dhe gjyqtarët të luajnë me ligjet është një xhungël. Nuk është e nevojëshme të hartosh ligje, ndërkohë që luan me to.

Autori ka studiuar për drejtësi, mbrojtje, gjuhësi dhe kauza e tij nuk përputhet me xhunglën e drejtësisë ku është përfshirë bota sot dhe midis tyre edhe Shqipëria me ngjarje si ato të Gërdecit dhe 11 janarit që vazhdojnë të mos gjejnë drejtësi.

Napolon Bonopart, ky udhëheqës gjenial ushtarak thotë se arma më e fortë eshtë pena, ndaj dhe Elliott Moglica zgjodhi penën, poezinë, librin të protestojë ndaj këtyre padrejtësive pa fund të botës ku jetojmë.

Në poezinë e parë që hap vëllimin me titull "Nesër" autori shkruan: "Kush sot luan me të ardhmen time, nesër do të luajë me të ardhmen e tij". Është për të ardhur keq se emigrantët shqiptarë u larguan nga Shqipëria për të siguruar një jetë më të mirë, pasi atë nuk e gjenin në vendin e tyre. Këtë jetë nuk e gjetën as në vendin ku shkuan. Drejtësinë, mirëqenien dhe punën e ndershme e kërkuan në vendin e tyre dhe nuk e gjetën. Ato nuk i gjetën as në vendet ku shkuan. Mos më pyesni se çfarë kam parë/ Mos më pyesni se çfarë kam dëgjuar/Mos më pyesni se çfarë kam ëndërruar/Mos më pyesni përse nuk je i gëzuar/ shkruan autori.

Autori nuk e kishte imagjinuar se edhe në Kanada ashtu si në Shqipërinë e pas viteve 90 do të gjente doktorët e shkencave duke punuar taksistë, projektuesit duke shitur mish, piktorët duke larë pjata, filozofët duke gjuajtur peshk.

Në poezinë e 14-të autori proteston ndaj atyre që duan të vrasin të vërtetën, ta zhysin atë thellë në pellgun pa fund që askush të mos mundë ta nxjerrë. Por një fjalë popullore thotë:" E vërteta zhytet, por nuk mbytet, e vërteta vonon , por nuk harron." Askush nuk do ta gëzojë atë që nuk e meriton, atë që u ka grabitur të tjerëve. Harami del edhe pas disa brezave, por del dhe mjerë ata që këtë haram do tua trashëgojnë fëmijëve dhe nipave e mbesave. Nuk mund të vesh pasuri mbi lotët e nënave të viktimave të Gërdecit, nuk mund të ngrihesh në detyrë e të bësh karrierë politike dhe admnistrative mbi lotët e viktimave të 21 janarit sepse shpirti nuk do tu prehet kurrë në qetësi në këtë botë dhe në botën e përtejme.

Autori proteston edhe ndaj Qeverisë Konservatore Kanadeze për qëndrimin e saj diskriminues ndaj emigrantëve. Këta emigrantë janë ata që mbajnë mbi supe punët e rënda dhe prodhuese të këtij vendi ndaj respektimi i të drejtave të tyre është nder dhe detyrë për çdo qeveri.

Mbrojtja e të drejtave të njeriut kudo në botë është sot tema e ditës më e prekëshme, për vetë faktin e ngjalljes së rrezikut të neodiktaturave dhe neodiktatorëve të tipit Millosheviç, Husein, Gedaf, Murabak etj. Edhe fundi i turpshëm dhe i kobshëm i këtyre diktatorëve që qëndruan me dekada të tëra në pushtet në emër të demokracisë dhe të zgjedhjeve të lira nuk i ka bërë të reflektojnë politikanët dhe bankierët e botës së sotme që i kanë zhytur vendet e tyre në kriza ekonomike e financiare të papara që nga vitet 30 të shekullit 20.

Është koha për reflektim. Është koha për drejtësi. Ky është apeli i librit të poetit shqiptaro-kanadez Elliott Moglica.

SAKIP CAMI
Poet dhe publicist

Mbrojtja e të drejtave të njeriut kudo në botë është sot tema e ditës më e prekëshme, për vetë faktin e ngjalljes së rrezikut të neodiktaturave dhe neodiktatorëve të tipit Millosheviç, Husein, Gedaf, Murabak etj. Edhe fundi i turpshëm dhe i kobshëm i këtyre diktatorëve që qëndruan me dekada të tëra në pushtet në emër të demokracisë dhe të zgjedhjeve të lira nuk i ka bërë të reflektojnë politikanët dhe bankierët e botës së sotme që i kanë zhytur vendet e tyre në kriza ekonomike e financiare të papara që nga vitet 30 të shekullit 20.



Rruga e Arbërit nr. 69

arsim



"Se ky populli ka djem me huqe,
Këmishën e zezë ta bëjnë të kuqe".

Respekt i përjetshëm për mësuesin e popullit

Nga:
NIKOLL KOLA,
Avokat

Z. Selim Alliu lindi më 1914 në Strikçan të Nën prefekturës së Zerqanit në Dibër, në këtë fshat të bukur e të gjelbëruar me florën e luleve dhe të pemëve, me aromën mahnitëse shekullore të kësaj treve trimash e fisnikësh.

Ka mbaruar studimet në shkollën Normale Elbasan, pas mbarimit të shkollës ka ushtruar profesionin mësues në ushtrimoren e po kësaj shkolle. Pastaj përkatësisht ka punuar po mësues në Gjirokastër dhe në Zerqan të Dibrës.

Për punë të palodhur dhe shkencore në fushën e arsimit dhe kulturës është titulluar "Mësues i Popullit". Pas vitit 1945 Selimi ka punuar gjithnjë Shef i Seksionit të Arsimit dhe të Kulturës në rrethin e Dibrës deri në daljen e tij në pension.

Zotin Selim Alliu e kam njohur për herë të parë në shtator të vitit 1962, Shef i Seksionit të Arsimit dhe Kulturës të rrethit të Dibrës, kohë në të cilën kam qenë arsimtar.

Kolegët më kishin folur për të se ai është njeri e drejtues me kulturë të madhe, me horizont të gjerë, i shkathtët dhe operativ në punë, estetik, i dashur dhe i qeshur me shokët e punës e vartësit e tij dhe me masat e popullit.

Këto cilësi të larta të "Mësuesit të Popullit" unë më vonë i njoha me kontaktet dhe takimet e shpeshta që kam patur me të. Ai jetonte gjithnjë me punën dhe me vështirësitë e të gjithë arsimtarëve në të 182 fshatrat e rrethit të Dibrës si dhe punën që bënin mësuesit në të gjithë këto fshatra e qytete për edukimin e brezit të ri, ndihma e tij ka qenë gjithnjë e gjithanshme dhe gjurmëlënëse në të gjitha shkollat, duke filluar nga ato fillore, 8-vjeçare, të mesme, si në fshatra dhe qytete dhe ndihmonte shumë trupën mësimore, u zbërthente programet mësimore, i mësonte si bëhet ditari i përgatitjes së mësuesit, mënyra e të studiuarit, në mjaft raste zhvillonte vetë një orë mësimi shembullore model me nxënësit e mësuesit e klasave të ndryshme nga fillorja, 8-vjeçarja dhe në të mesmet.

Megjithëkëtë, ndihma që ai u jepte shkollave e sidomos mësuesve të bazës, kishte për qëllim kryesor që të edukonte e kualifikonte mësuesit tanë të të gjitha niveleve, që ato të rritnin nivelin dhe dijet e tyre shkencore, në edukimin e një armate të re, për t'i vënë në shërbim të popullit dhe të zhvillimit të Atdheut tonë të shtrenjtë e të dashur.

Zoti Selim gjithnjë ishte shumë njerëzor, ai tregonte dhe kishte respekt e konsideratë të lartë për kuadrin, por në veçanti, ai, pa masë, respektonte kuadrot e bazës, për sakrificat që ato bënin dhe për vështirësitë që kalonin në punën edukativo-mësimore.

Në një rast unë u nisa nga fshati Lajthizë, në të cilin unë shërbeja si mësues me katër klasë kolektive, në shkollën fillore "Gjin Kola", rrugëtova 8 orë në këmbë atë ditë dhe më në fund arrita në Peshkopi, megjithëse isha në moshë i ri, por e ndjeja veten të lodhur, megjithatë në orët e mbrëmjes pashë që në zyrën e tij kishte dritë. Pa vonesë u drejtova për tek ai, trokita në derën e zyrës dhe menjëherë dëgjova zërin e Selimit plot dashamirësi: "Hyr"! Ai u hodh e më përqafoi duke më thënë: "Mirëse na erdhe ore mësuesi i malësisë". Pasi më ftoi të ulem, më pyeti për shëndetin, për prindërit, për shkollën dhe nxënësit, për përparimin e tyre, për vështirësitë si zonë e thellë etj. Veçanërisht ai u interesua duke më qarë hallin e lodhjes pasi kisha rrugëtuar në këmbë 8 orë atë ditë. Pastaj tha se: "me të drejtë them, ju mësuesit e bazës jeni përçuesit e dijes dhe të zhvillimit e dritës tek të gjithë brezat që jetojnë atje në fshat – vazhdoi ai – juve duhet të mposhtni lodhjen e vështirësitë e të marshoni përpara në rrugën e "Mësuesit të Popullit" Ndrec Ndue Gjoka, se juve Nikoll shërbeni mësues në një nga shkollat që ngriti ai, dhe në këtë kontekst keni shumë detyrime për edukimin e brezit të ri të shoqërisë shqiptare.

Në vazhdim të bisedës ai më dëgjoi për hallet e problemet që kisha dh eme përparësi m'i zgjidhi ato në vend, këtu është fjala për disa mjete mësimore didaktike të shkollës ku unë shërbeja. Pritja e ngrohtë, sjellja, dëgjimi me kujdes që më bëri, zgjidhja e problemeve të shkollës, porositë shumë të vlefshme që më dha, përcjellja plot dashamirësi, më bënë mua të harroja lodhjen e rrugës së gjatë, më armatosi me kurajë, energji e forca të reja për të çarë përpara në rrugën e ndritur të mësuesit e të progresit.

Shkalla e njohjes sime me "Mësuesin e Popullit" Selim Alliu erdhi gjithnjë duke u thelluar. E njoha jo vetëm si drejtues i arsimit dhe kulturës në rreth, por edhe si një aktivist të shquar shoqëror. Ai, që nga Konferenca e 12-të e Frontit Demokratik të Rrethit të Dibrës, është zgjedhur anëtar i Këshillit, anëtar i Kryesisë dhe zv/kryetar i Frontit Demokratik të Rrethit, duke milituar në këto detyra deri në fund të jetës së tij. Për kryerjen e këtyre detyrave ai është karakterizuar gjithnjë nga një punë e ndërgjegjshme dhe ka dhënë një kontribut të çmuar në forcimin, gjallërimin e organizatës së Frontit Demokratik dhe në edukimin e masave të gjëra të popullit.

Pas mbarimit të studimeve të larta unë u emërova Sekretar funksionar i Këshillit të Frontit Demokratik të Rrethit Dibër, kurse z. Selim Alliu unë e gjeta aty, anëtar kryesie dhe zv/kryetar i Këshillit të Frontit Demokratik të Rrethit të Dibrës, si dhe Rifat Tola zv/Kryetar, ish kryetar i Gjykatës së Dibrës, ndërsa kryetar i Frontit Demokratik të Rrethit ishte Sinan Saraçi, dhe ndërkohë, në këto rrethana, njohja ime u thellua më shumë me këta burra të shquar dibranë, me mendje të kthjellët, të dijes dhe të punës, të guximit dhe trimërisë, produkte të dijes për shoqërinë, ishin për mua një profesor i vërtetë mbi ato profesorë që më kishin mësues dhe edukuar në auditorë të universitetit në atë kohë.

Ishte iniciativë kryesisht e z. Selim Alliu për vlerësimin e punës time si Sekretar për të më dekoruar, për këtë Kryesia e Frontit të Rrethit Dibër i propozoi Presidentit të Republikës për dekorim, dhe kjo u bë realitet, u miratua me Dekretin 5256/28.12.1974 të Presidentit të Republikës, më akordohet urdhri "Për shërbime të shquara shtetërore dhe shoqërore të klasit të III (Nikoll Gjon Kolës), për rezultate të mira në edukimin ideologjik të masave, për forcimin e organizatave të Frontit në realizimin e detyrave shtetërore dhe shoqërore".

Z. Selim Alliut, gjithnjë i rrihte zemra dhe mendja tek arsimi, shkollat, mësuesit dhe për ato figura të cilat kishin punuar e ndihmuar për shkollën. Ai i kujtonte dhe shprehte konsideratë të lartë për kuadrot që kanë punuar e drejtuar shkollën e kulturën në zonën e Lurës, Dardhës e Reçit, për drejtorët Kasem Hoti, Ali Koçeku, Sali Ajazi, Ndue Kola, për mësuesit Nikoll Rada, Hilmi Kolgjegja, Sadik Laçi, Ismail Hoti, Halit Doçi, Jashar Kaci, Hamit Leka, Hysen Vladi, Ramazan Përleka, Kol Kaçorri, Osman Vladi, Mexhit Prençi, Xheladin Tollja, Preng Frroku, Misim Tollja, Hysni Tollja, Musa Vladi, Bajram Përleka, Tom Lleshi, Preng Markola etj., këtij të fundit, Selimi i thurte këngën në çdo takim që bënim "hajde, hajde Preng Markola prej Mirdite, po shndrit si yll drite", këto në shenjë respekti.

... Për drejtuesin e dalluar e të palodhur të kulturës Halil Shoti..., për ish kryetarët e Lokaliteteve të kohës, Llesh Doçì, Lek Rajta, Llesh Marku, Ali Leka, Osman Musa, Selman Buci, Dine Kaca, Shaban Dervishi si dhe ish-kryetar kooperativash bujqësore Rrahman Deda, Met Sula, Nezir Buci, Sherif Peka, Ahmet Përleka, Shaqir Shira, Mersin Rasha etj.

... Për drejtuesit e Partisë Riza Hasani, Ndrec Çoku, Shuaip Methasani etj., të cilët kanë drejtuar dhe mbuluar me kompetencë e dinjitet problemet e arsimit dhe kulturës në këto zona, si dhe kanë ndihmuar në ngritjen, rinovimin, ndërtimin e objekteve shkollore me kontribute vullnetare, në vartësi të kompetencave territoriale dhe të fondeve të akorduara nga qendra (rrethi).

Duke qenë në marrëdhënie pune të përbashkët për shumë vite, respekt e konsideratë të veçantë Selimi shprehte për ish-sekretarin e Komitetit Ekzekutiv të Rrethit Dibër z. Haxhi Rama, që ky i fundit kishte mbuluar për një periudhë të gjatë kohore problemet e arsimit, kulturës dhe të shëndetësisë në shkallë rrethi.



Selim Alliu

Për vlerat burrërore të atij ai thoshte: "Burrë më të mirë se Haxhi Rama, nuk lind më nëna dibrane".

Ishte rast i veçantë që z. Selim Alliu nuk bënte pjesë në parti (shef i Arsimit dhe të Kulturës në Rrethin e Dibrës pa parti), në periudhën e shtetit totalitar, qe vetëm Selim Alliu "Mësues i popullit..." Vlen të theksohet qëndrimi i tij burrëror, korrekt, objektiv dhe pluralist për problemet e kuadrit arsimor, ai nuk bënte kurrë politikë partie për kuadrin arsimor si dhe drejtuesit e shkollave, por ai i trajtonte si specialistë mbi bazën e arsimit e kualifikimit arsimor, ai asnjë mësues e punonjës arsimi nuk nxori në rrugë për qëndrim klasor. Meqenëse unë e njihja si koleg z. Halil Shoti, me aftësi shumë të mira si mësues dhe punonjës i kulturës dhe që kishte dhënë kontribut të çmuar kudo që kishte punuar në rrethin e Dibrës, në një rast i thashë, ore Selim, pse nuk trajtohet si kuadër me vlera të veçanta Halil Shoti; ai m'u përgjigj, po deshe ti Nikoll të vijë në vendin tim si Shef i Sekcionit të Arsimit e Kulturës, me shumë dëshirë ja lëshoj karrigen time, por nuk na lejon partia për motive politike. Ai tha: për mua Halil Shoti është një nga figurat më të pastra të arsimit dhe kulturës dibrane, prandaj duhet trajtuar siç dëshironi edhe ju, por do të presim për më vonë "Kohë të mira vijnë pastaj", e mbylli këtë bisedë Z. Selim Alliu. Edhe mësuesit e varfër ai i ndihmoi, i kualifikoi dhe i bëri me shkollë e arsim, të aftë për të punuar në arsim e kulturë.

Në një takim tjetër, përsëri më vajti mendja tek kolegu im Halil Shoti. – Ore zoti Selim, të kam folur dhe një herë tjetër për këtë mikun tim... Selimi m'u përgjigj me dashamirësi dhe më tha: më shkele në "kallo" ore Nikoll, dhe në vazhdim të bisedës më tha: "Ju i vlerësoni shumë shokët dhe punën e tyre, po ata a të vlerësojnë ty?". Unë ju përgjigja: mendoj se po. Ai më tha – ju keni një zemër shumë të pastër dhe do të bëhet vetëm mirë për juve, bashkëshorten Dr. Liza si dhe për fëmijët tuaj në këtë botë.

Janë me qindra dhe mijëra nxënës, studentë të profesioneve e degëve të ndryshme, dokumentet e të cilëve më kanë kaluar nëpër dorë e janë miratuar nga ana ime tha Selimi dhe më bëhet zemra sa mali i "Korabit" kur shoh se tani kanë dalë në jetë, punojnë në profesionet e tyre dhe i sjellin lumturi e begati familjeve të tyre, Dibrës dhe tërë Shqipërisë e më gjerë.

Si të mos kujtosh e përmendësh punën që bëjnë pasardhësit e mi në fushën e arsimit dhe të kulturës e sektorë të tjerë të shkencës e teknikës në vend, siç janë: Shemsi Manjani, Kasem Hoti, Rexhep Rama, Adem Perhati, Hysen Lala, Rustem Deva, Beqir Shehu, Natasha Shehu, Destan Visha, Hysen Çera, Shaban Uklala, Hysen Dervishi, Mahmut Meqi, e mijëra të tjera në të gjithë trevën e Dibrës dhe jashtë saj, që puna e tyre rrezaton si drita e diellit.

Vlerësoi shumë lartë kontributin që kanë dhënë për kulturën dibrane kompozitorët e djepit të kulturës shkodrane Tonin Rrota, Tef Krroçi, Zef Çoba dhe Lorenc Radovani që kanë punuar e shërbyer me përkushtim për një kohë të gjatë në rrethin e Dibrës.

Janë thesare "të përjetshme" ansambli folklorik i këngëve dhe valleve popullore të Zall Dardhës me udhëheqës artistik Xhelal Çerpja, këngëtarët epik Qerim Sula, Shaban Xhajku, dhe Kol Kola ose ansambli i këngëve dhe valleve popullore të Gollobordës të cilët kanë bërë jehonë si brenda dhe jashtë vendit. Janë të paarritshëm Artisti i Popullit, këngëtar, rapsod, valltar e shkrimtar, Hazis Ndreu, Naim Plaku-letrar tekstesh, Zymbyle Zeneli, "Artistja e Meritуar" Lirie Rasha, "Mjeshtër i këngës popullore" Arif Vladi, kompozitori dhe "Mjeshtër i madh" Edmond Zhulali, këngëtarët Skënder Cala e Melita Shehu, kompozitorit muzikant Përparim Tomçini, të cilët janë bilbila të këngës popullore dibrane, ku veprimtaria dh ekëngët e tyre janë një "himn" i vërtetë dhe ringjallin e gëzojnë zemra njerëzish në të gjithë globin ku dëgjohen, njihet e flitet gjuha shqipe.

"Lum kush të rrojë, t'i dëgjojë e të gëzojë", theksonte Selimi.

Unë duke e njohur nga afër "Mësuesin e Popullit" z. Selim Alliu, vlerësoj me objektivitet dhe gjithëanësisht themelet që hodhi ai për arsimin e kulturën në rrethin e Dibrës, kontributin për zhvillimin e arsimit dhe kulturës nga qendra e deri në fshatrat më malore të trevës së Dibrës. Shkollat e të gjitha niveleve në këtë rreth i ngjanin auditorëve të universiteteve shqiptare. Unë këto që po shkruaj i mësova për faktin edhe si nxënës në shkollën e mesme bujqësore "Nazmi Rushiti" Peshkopi, ku jam diplomuar ekonomist i mesëm. Aty, gjatë katër viteve në këtë shkollë, njoha djalin e Selim Alliut, profesorin kompetent të Matematikës e Fizikës, Naim Alliun, një kuadër me shumë dije shkencore, vlerësonte punën e secilit nxënës, me sjelljen e tij ai u rriste moralin të gjithëve. Populli thotë "trimi i mirë me shokë shumë", "më thuaj kush të drejton e të them se kush jeni" etj. Aty, gjatë kohës, njoha mirë drejtorët Moisi Cami e Sabri Vraniçi, organizatorë e profesorë të zotë e të gjithanshëm, të cilët nuk ndaheshin nga mësimi, nga nxënësit dhe as nga shkolla për asnjë çast.

Lëvizja e qarkullimi i kuadrit në atë kohë nga një institucion në tjetrin, ose nga një forum në një tjetër, të zgjeronin shkallën e dijes dhe njohjes. Kur u emërova me punë në Komitetin Ekzekutiv të rrethit, Jurist, u njoha edhe me djalin tjetër të z. Selim, me ing. Arkitekt Mirdash Alliu, që punonte specialist në urbanistikë, ai ishte djalë i përsosur e me personalitet në të gjitha fushat e jetës, me kulturë të gjerë në profesion në të gjitha fushat e jetës, me kulturë të gjerë në profesion. Ndërsa kushëriri i MIrdashit, Ing. Arkitekt Tafil Alliu, ishte Shefi i Urbanistikës, i mirë dhe me humor, dashamirës me të gjithë shokët e shoqet në aparat. I harmonizonin punët ndërmjet tyre, dhe punët e këtij sektori ishin vënë në rrugë shkencore. Shef i Ndërtim-Komunikacionit, nga varej Urbanistika, ishte Idriz Kukeli, një kuadër i mirë që u linte kompetenca të lira e profesionale. Pra ky seksion vepronte në unitet dhe punët shkonin gjithnjë mirë. Me shokët sa më sipër punuam një dekadë, derisa unë në vitin 1984 u transferova në rrethin Mat me detyrë prokuror.

Shumë keq më vjen për vdekjen e papritur e t parakohshme të Selimit, të Naimit dhe të Mirdashit, që i mori vdekja e pamëshirshme në moshë të re. Homazh këtyre yjeve të pashuar dibranë.

Unë mendoj se për të shkruar për "Mësuesin e Popullit" Selim Alliu është shumë e vështirë, për

kujtesë





faktin se jeta dhe vepra e tij është shumë e madhe, por unë u mundova që me penën time të pasqyroj në këtë shkrim kujtimet e mia në aspekte të jetës dhe punës me Z. Selim Alliu, si arkitekt, drejtues i arsimit dhe kulturës për gati 50 vjet në rrethin e Dibrës e më gjerë. Veç sa më sipër, si aktivist shoqëror dhe kuadër drejtues i organizatës së Frontit të Rrethit Dibër, si prind shembullor që së bashku me bashkëshorten e tij, Nazmia, lindi, rriti, edukoi dhe shkolloi fëmijë me kulturë dhe horizont të gjerë për jetën, punën dhe shoqërinë, të ndjerin Naim dhe Mirdashin që vdiqën në kohën e rinisë.

Po përsëri "vatra e Alliut" gumëzhin, është i biri i Ilir Alliu me nusen e fëmijët, në profesionin Inxhinier e Pedagog në Universitetin e Tiranës, janë fëmijët dhe nuset e Naimit e Mirdashit, është e bija e Selimit Drita Nura (Alliu) për të cilën kam shumë respekt edhe për faktin se ajo pati punuar në Spitalin e Peshkopisë me bashkëshorten time Dr. Liza Kola. Kujtoj se Drita ishte jo vetëm specialiste e mirë, por edhe një "aktore e vërtet". Por, fatkeqësisht në moshë të re, i mori vdekja edhe bashkëshortin, shokun e saj të jetës Dr. Qeram Nura, një kuadër e burrë i dijes dhe shkencës, i mirë mbi të mirët, të cilin e ndau nga jeta, vdekja e padrejtë e ndau atë nga nëna Neta, nga motra Vera, nga miku dhe shoku i tij z. Mentor Muça, që ishte, është e do të jetë një burrë i dijes, i produkt për shoqërinë dhe kombin, për të cilin ruaj kujtimet më të mira për të dhe familjen e tij. E kam në Tiranë dhe do ta takoj e të çmallem me të.

Kam detyrimin shoqëror dhe moral që të shkruaj disa rreshta edhe për vëllain e Selimit, Dr. Ahmet Alliu, si një profesionist i shkëlqyer i radiologjisë, si njeri i shoqërisë, si koleg i bashkëshortes sime Dr. Liza Kola, e cila ruan shumë respekt për të si njeri dhe si specialist i shkencës së mjekësisë. Dr. Ahmet Alliu nuk ka patur asnjë koleg të tij e as mjek të profesioneve të tjera që t'i diskutonte diagnozat, epikrizat dhe eksperimentimet e tij në fushën e mjekësisë, si mjek e njeri universal.

Shpreh bindjen dhe besimin tim se për të gjithë ato që parashkrova më lart, nga familja e trungu familjar i "Mësuesit të Popullit Selim Alliut do të jetojnë e do të ecin nën shembullin e këtij gjiganti të dijes dhe shkencës, për faktin se trashëgojnë genet e tij dhe ky ushqim do t'u ndriçojë përjetësisht rrugën dhe jetën e kësaj familje të pavdekshme dibrane, si dhe breznive të tashme e të ardhme të kuadrove të arsimit dhe kulturës të rrethit Dibër e më gjerë.

Krahas punës së ngjeshur që bënte si drejtues i arsimit dhe kulturës së rrethit Dibër, ai studionte shumë literaturë shkencore, si të profesionit dhe jashtë tij, pra ai ishte një arkiv i vërtetë shkencoro-artistiko-kulturor.

Më kujtohet një takim shoqëror me Selim Alliun, Mentor Muça dhe Llesh Doçin, shokë e miq të mirë, të katër së bashku në një koktej. Mentori i njihte mirë edhe për mendimet në fushën e shkencës dhe të letërsisë. Ndërkohë ushtroi një pyetje për veprat e Fishtës. Që të dy, Lleshi dhe Selimi, u përgjigjën: Fishta dhe vepra e tij janë të ndaluara dh etë dënuara nga Partia... Mentori u përgjigj, ne jemi shokë dhe unë nuk po ju provokoj, por unë di shumë mirë që ju të dy e zotëroni Fishtën dhe veprat e tij janë hobi juaj, dhe për sa flasim këtu, i lëmë këtu, dhe nuk flasim me protokoll. Selimi tha fol ore Llesh se Fishta është katolik dhe filozof prift. U qeshëm të katërt me të madhe. Lleshi tha se në sistemin tonë tani nuk ka dallim feje, por megjithatë tha ai, unë po recitoj disa fjalë të Fishtës i cili shkruan:

"Kur po don me të ardh rreziku, do të vijë or lum miku, no prej hasmit, no prej vëllaut, veç me hy në brin të kaut".

Në këtë rast u bë shumë gaz dhe humor ndërmjet nesh. Në atë kohë Lleshi ishte Kryetar Lokaliteti në Sllovë, por ai ishte një personalitet i shquar i penës e i fjalës së lirë, i kuvendit të burrave dhe trim i pamposhtur. E njihnin mirë regjimin në të cilin jetonim e punonim. Por, edhe Mentori e Selimi, pavarësisht nga postet e punët që bënin, ishin me të njëjta pikëpamje liberalo-demokrate me Lleshin.

Por ky, duke zbërthyer vargjet e Fishtës, analizonte edhe trevën e Dibrës si vend i mirë, por edhe vend i vështirë për të punuar, dhe njerëzit që punonin në sigurimin e shtetit ai i cilësonte si "spiunë".

Lleshi thoshte se Dibra është një fushë e minuar dhe në këtë fushë të minuar në çdo m2 ka një minë me sahat. Pra duhet ta hedhësh fjalën dhe hapin me kujdes, se do kalosh në këtë fushë të minuar për 60 vjet deri sa të dalësh në pension dhe gjatë kësaj periudhe po të takoi këmba në ndonjë minë të tilla rrashta e kokës të shkon hava. Pra në atë kohë ishte e vështirë të merresh vesh se kush është miku dhe armiku, pra armiku mund të ishte hasmi ose vëllau, se kështu i gatoi njerëzit ai rend ekonomiko-shoqëror. Për rrjedhim unë mendoj se ky ishte komenti dhe zbërthimi që i bënte filozofit katolik Fishtës – Llesh Doçi. Por edhe Selimi e Mentori i miratonin mendimet e tij, pra ishin akord dhe dakort me të. Po të ishte Lleshi edhe çdo ditë në Peshkopi nuk kishte mundësi pa u takuar, kuvenduar e shkëmbyer mendime treshja.

Të kishte lezet më i takuar dhe në takimet me këta burra të mençur ishte një shkollë dhe fitoje kulturë e dija shkencore. Ruaj shumë kujtime dhe respekt të veçantë për këto burra, që me përkushtim e dije shkencore, i shërbyen popullit dhe kombit të tyre.

Kontributi i madh që dha për zhvillimin e arsimit dhe të kulturës, në përgatitjen e kuadrit e mësuesve në të gjithë trevën e Dibrës, në territorin e Mirditës, Kukësit dhe Matit, "Mësuesi i Popullit" Selim Alliu, aktiviteti i tij si militant shoqëror, do të mbeten gjithnjë një shembull i shkëlqyer që do të frymëzojnë armatën e madhe të njerëzve të arsimit dhe kulturës në rrethin e Dibrës e tërë Shqipërinë.

Për sa parashkrova ishin vetëm disa grimca të kujtimeve të mia për "Mësuesin e Popullit" Selim Alliu dhe të familjes së tij.

Unë çmoj dhe vlerësoj faktin se kuadrot e arsimit e kulturës së rrethit Dibër si dhe të rretheve fqinjë që përmenda më lart, duhet të bëjnë studime, hulumtime, për jetën dhe veprën e "Mësuesit të Popullit" Selim Alliu dhe të shkruhen volume për të si një thesar me vlera të mëdha për arsimin dhe kulturën dibrane.

Në 50 vite të shkuara asnjëri në trevën e Dibrës e më gjerë nuk punoi si ai, për ndërtimin e shkollave të të gjithë niveleve, hedhjen e themeleve, zhvillimin e arsimit dhe kulturës, shkencës dhe dijes. Të gjitha këto së bashku përbënin "filozofinë e tij" prej shkencëtari.

Vepra e "Mësuesit të Popullit" Selim Alliu do të mbetet e pavdekshme dhe do të rrezatojë përherë si një "yll i pashuar" në të 9 malet e Dibrës dhe në brigjet e Korabit të lartë.

Historik i shkurtër i zhvillimit të arsimit në Bulqizë

(Vijon nga faqja 11)

Fiqiri Myrtezai, Sabri Alliu, Myfit Dervishi, Sejfulla Shehu, Selman Alla, Miftar Lami, Zymbyle Zeneli, Bashkim Lami, Hamit Dervishi, Jonuz Muça, Zabit Lleshi, Neki Kuka, Bedrie Dani, Habibe Toska, Musa Vladi, Hasan Lami, Hysen Likdisha, Bilbil Bardulla, Flamur Gjymyshka, Agim e Nazmije Fejza, Veladin Tafai, Sejfulla Kata, Emin Gjapi, Bashkim Novaku, Myrteza Kadria, Sami Rama, Setkie Strazimiri, Fatbardha Cani, Sarie Manjani, Nafije Jella, Hamdie Beqiri, Vjollca Bici, Hajri Mandri, Nekie Shehu, Shazimete Cami, Bajame Elezi, Fitore Lami, Fitnete Beça, Mehdin e Naile Karaj, Muharrem Kola, Flori Koçi, Eftili Bogdani, Tahir Zeneli, Sadik Damzi,Ylber e Ylvie Cani, Xhemal Kamberri, Rruzhdi e Vjollca Sinani, Halil Begu, Veiz Allushi, Rasim Uka, Skënder Murrja, Gani Keta, Miranda Kurti, Hysnie Murra, Avni Toçi, Kujtim Kerkuti, Natasha Gjoka, Evelina Tuma, Qemal Sejdi, Edlira Griça, Afrim Biçi, Durak Kurti, etj.

Kanë mbetur në memorjen e arsimit në Bulqizë mësuesit që vinin nga Tirana e vise të tjera të gjithë Shqipërisë, si *Popovina Dobi, Zija Ndrukaj, Bedri Karapici, Fatmir Zeralliu, Arben Sinoimeri, Ilir Belegu, Andrea Simo, Plator Nesturi, Dhimitër e Tatjana Qurku, Bashkim Kazazi, Qani Kazazi, Kristaq Kondili, Apostol Proko, Dëfrim Peza, Mirjana Bekteshi, Simon Beka, Shefki Hysa, Alfred Mullaj, Hytbi Kabo, Martina Jaku, Fatime Çobani, Eleni Xeka, Lirie Leka, Shqipe Meçe, Athina Bulo, Lirie Naska, Shkurte Nuzi, Matilda Koni, Asllan Lila, Agim Tabaku, Ira Deveja, Edmond Shkurti, Suzana Deda, Ana Doçi, Anila Çela, Diana Kraja, Dritan Mara, Arjan Koçiu, etj.* që bashkë me vendasit plotësuan synimet në proçesin e mësimit dhe edukimit të brezave të rinj në këtë qytet.

Në vitin 1980 me shtimin e banorëve të qytetit u shtua numri i nxënësve, prandaj për normalizimin e mësimdhënies, u ndërtua shtesa e shkollës 8-vjeçare ku arriti në 34 klasa e 4 kabinete. Në vitin 1981 u hap gjimnazi i ditës ku u regjistruan vetëm vajza, me që djemtë plotësonin klasat në degët profesionale. Në vitin 1984 në Bulqizë u ndërtuan dy shkolla të reja tre katëshe në të dy anët e qytetit, njëra e arsimit të përgjithshëm e tjetra për arsim profesional, ku vazhdonin mësimin nxënës të qytetit dhe të fshatrave të Rajonit të Bulqizës. Në vitin 1989 u bë ndarja e shkollës së mesme në dy shkolla (gjimnaz dhe profesionale), që u vendosën në dy godinat shkollore të ndërtuara në dy anët e qytetit. Në vitin 1989 u ndërtua shkolla 8 vjeçare me 4 kate në "Lagjen e Re", me 27 klasa, 4 kabinete, me palestër sportive e dhoma çveshje. Në vitin 1991 u shtua dega e ndërtimit me 35 nxënës që pas një viti u kthye në degë elektrike, që vazhdoi deri në vitin 1998.

Në vitin 2004 gjimnazit të Bulqizës iu shtua dega pedagogjike me dy klasa që morën maturën në vitin 2008 dhe disa vazhduan arsimin e lartë e disa filluan punën e mësuesit, në shkollat e rrethit.

Për zhvillimin e arsimit në Bulqizë, është memorizuar drejtimi pedagogjik e profesional i drejtuesve të shkollave, si *Luan Xheneti, Ramiz Gjoka, Sabri Alliu, Myfit Dërvishi, Bedrie Dani, Rustem Murrja, Ylvije Çani, Naile Karaj, Osman Miha, Myrteza Kadria, Agim Fejza, Xhemal Kamberri, Bashkim Lami, Halil Begu, Rasim Uka, Afrim Biçi, Sadik Damzi, Ferit Lala, Zija Ndrukaj, Kujtim Kerkuti, Veiz Allushi, Miranda Kurti, Altin Keta, Ilda Alushaj, Skënder Murrja, Musa Vladi, Albana Balla, Selman Alla, Mehdin Karaj, Emin Gjapi, Vjollça Bici, Sarije Manjani, Bashkim Novaku, Lulëzime Zuna, Avdi Ferra, Ilir Disha, Fllanza Losha,etj.* të çilët kanë dhënë sejcili shëmbullin e tij në organizimin e punës edukative-mësimore, duke çuar drejt suksesesh edukimin e arsimimin e rinisë në këtë qytet të rëndësishëm industrial.

Drejtuesit e suksesshëm të shkollave të Bulqizës bashkë me mësuesit, arritën të krijojnë kushte të favorëshme për nxënësit, me "situatat pedagogjike", duke u dhënë atyre alternativa të kulturës e veprimit në përputhje me dëshirat e aftësitë e tyre, ku shkollat u bënë vatër e madhe e "demokraçisë së vogël", për të ecur pa ndalur drejt zhvillimit.

Sot krahas mësuesve me përvojë në shkollat e Bulqizës traditën po e çojnë përpara më të rinjtë, *Aishe Begu, Bibe Pata, Kozeta Disha, Rajmond Cani, Kamber Duka, Lumturie Gjura, Lulëzime Mazari, Irena Biba, Lindita Kaja, Edlira Keta, Arta Xhemali, Etleva Alla, Hanke Isaku, Valbona Cani, Gjelina Cara, Floranda Gurra, Albana Elmazi, Arta Sejdi, Donika Cara, Edlira Jashari, Mimoza Puci, Arta Zogu, Alma Shehu, Anita Imerri, Brikena Okshtuni, Urim Dani, Rudina Gjimi, Meribane Alla, Sajmir Tuci, Shqipe Lami, Pranvera Sulku, etj.*

Ndryshimi i madh në jetën e lirë demokratike të vendit, kërkonte nga shkolla dhe mësuesit një reflektim të gjithanshëm për të eçur me hapin e kohës në programe e metoda, që shkolla t'i ngjajë zhvillimit perëndimor, larg politizimit, tutelës e mediokritetit. Në vitin 1991 përgjegjës i seksionit të arsimit në Komitetin Ekzekutiv të Rrethit Bulqizës u emrua mësuesi *Jonuz Muça* deri në vitin 1992 kur u krijua Drejtoria Arsimore e Rrethit të ri të Bulqizës, që është drejtuar nga, *Hysen Likdisha, Halil Begu, Qemal Sejdi, Rudina Spahiu, Miranda Kurti, Agim Tuçi, Afrim Meta.*

Në DA kanë punuar mësuesit më me përvojë si inspektorë *Hamit Dërvishi, Emin Gjapi, Astrit Zogu, Ilmi Çanga, Bujar Shehu, Gëzim Xhidra, Medin Karaj, Rruzhdi Sinani, Tomorr Dani, Gani Keta, Rajmond Cani, Engjëllushe Kola, Veiz Allushi, Suri Zogu, Tefta Kica, Fllanza Losha, Agim Balla, Muharrem Zeneli, Avdi Ferra, etj.* të çilët kanë ndjekur eçuritë e problemeve të organizimit në shkolla dhe zbatimit të kurrikulave të reja që po zbatohen në reformimin e arsimit.

Mësuesit e drejtuesit e shkollave të Bulqizës ishin aktorë të vërtetë të reformave të thella, në përmbajtjen e shkollës, duke qëndruar afër interesave të nxënësve, në kushtet e lirisë së munguar. Është vlerësuar puna e palodhur e disa mësuesve të shkollave të Bulqizës, që janë dekoruar me Medaljen e lartë "Naim Frashëri", *Myfit Dërvishi, Shefqet Tançi, Skënder Sharku, Bashkim Lami, Sabri Alliu, Hysen Likdisha, Sami Rama, Fiqerete Strazimiri. Medalja "Mësues i dalluar" e MA, u është dhënë mësuesve: Eleni Kola, Habibe Toska, Setkie Strazimiri.* Këshilli Bashkisë Bulqizë në vitin 2004 në shenjë vlerësimi për punën pasionante me nxënësit dhe angazhimi në jetën shoqërore, ka vendosur emrin e mësuesit Shefqet Tançi për shkollën 9-vjeçare të Lagjes së Re të Bulqizës. Këshilli Bashkisë Bulqizë, ka vlerësuar arritjet në arsim dhe me rastin e festës së 7 marsit 2011 ka shpallur "Qytetar nderi i qytetit Bulqizë" mësuesit: *Sabri Alliu, Myfit Dërvishi, Habibe Toska, Musa Vladi, Faik Cami, Selman Alla, Fiqiri Duriçi, Eleni Kola.*

Në këtë 80-vjetor të shollës së Vajkalit dhe të qytetit të Bulqizës, ku morën rrugën e dijeve me mijëra nxënës, ruhen gjallë nga të gjithë në kujtimet e jetës tyre, puna e palodhur me plot dashuri, e qindra mësuesve, në disa breza. Shkollimi që nisi me disa abetare në duar, ecën sot vrullshëm e pa u ndalur, në rrugën e reformimit e demokratizimit, për të arritur shkallët e zhvillimit, si gjithë familja europiane.

BASHKIM LAMI

Mjekët që shkelin betimin e Hipokratit

Nga: **Rexhep TORTE**

Manteli i bardhë është sinonim i punonjësve në mjekësi, i njerëzve të sakrificës dhe humanitetit për të mjekuar njerëzit nga sëmundjet e ndryshme. Të gjithë ata që vendosin të merren me mjekësi në fund të studimeve bëjnë edhe betimin e Hipokratit, si akt përkushtimi, devotshmërie e sinqeriteti për profesionin që do ta ushtrojnë. Shumë prej tyre kryejnë edhe specializimet përkatëse në degë të caktuara, për avancim të dijes së tyre për këtë profesion të rëndësishëm.

Në tekstin e Hipokratit me të cilin betohen mjekët për profesionin e tyre, veç tjerash thuhet se, " betohem solemnisht se jetën time do ta vë në shërbim të njerëzimit. Detyrën time do ta ushtroj me përgjegjësi dhe dinjitet. Do ta ruaj fshehtësinë e atij që më beson në profesionin tim. Do ta ruaj nderin dhe traditën fisnike të profesionit. Këtë betim e bëj solemnisht dhe me vullnet të lirë, duke u mbështetur në nderin dhe ndërgjegjen time profesionale dhe njerëzore".

Përkundër përmbajtjes së ngrohtë e të fuqishme etike të këtij betimi, me përjashtim të atyre që i përmbahen dhe e respektojnë tërë jetës, kemi edhe asosh prej mantelave të bardha, të cilët me dashje ose pa dashje e shkelin këtë betim fisnik. Shkelja e këtij betimi për fat të keq ndodh pothuajse kudo, nëpër qytetet tona, por edhe në shtetet përreth.

Sipas informatave që kemi kjo shkelje më shumë del në shesh në vendbanimet më të vogla, ku njerëzit njihen mirë mes vedi dhe ku lajmi për mirë ose për keq depërton më shpejt.

Këtë shkelje të betimit të Hipokratit e bëjnë më së shumti motrat mjekësore, por ka edhe mjekë që shkelin mbi këtë betim. Spitali është vendi ku i sëmuri drejtohet për shqetësimet shëndetësore që ka, për të kërkuar mjekim ose këshillë. Mjeku qoftë vetë me pacientin ose në praninë e motrës mjekësore, e viziton me kujdes pacientin dhe ia jep medikamentet dhe rekomandimet e nevojshme, apo edhe udhëzimin mjekësor edhe për kontroll më të hollësishëm specialisti. Por kjo punë nuk mbaron me kaq, dhe këtu është motivuar edhe qëllimi i këtij shkrimi.

Jemi dëshmitarë kur pa dëshirën tonë në mjedise të ndryshme dëgjojmë të flitet se filan personi vuan nga kjo ose ajo sëmundje. Dhe këto informata nuk kanë nga të dalin, veçse nga mjeku ose motra mjekësore. Kjo ndodh nga motive të ndryshme. Nga dëshira e manteleve të bardha për tu eksponuar para tjerëve se ja po dinë diçka më shumë se tjerët, ose edhe nga impresioni dhe keqardhja për atë pacient që vuan nga ndonjë sëmundje e rëndë.

Dhe kështu informata mjekësore përhapet me të shpejtë mes atyre që e njohin, dhe pacienti bëhet objekt bisede pa dëshirën dhe dijen e tij. Si rezultat i kësaj sjellje të pa matur, shpesh ndodh që pacienti ende vetë nuk e ka të qartë se prej çfarë sëmundje të rëndë është prekur, ndërsa tjerët në vendbanimin e tij e përfolin për diagnozën e sëmundjes.

Këto janë rastet kur nuk respektohet privacia e pacientit dhe kur shkelet edhe betimi i Hipokratit.

Nuk do të kishte gjë të keqe po qe se mantelet e bardhë bisedojnë për sëmundjet dhe pacientët me qëllim edukativ, por pa përmendur emra konkretë, pa e lënduar privacinë e pacientit, i cili u është drejtuar me sinqeritet dhe besim të plotë për ta mjekuar, e jo për ta përfolur.

Ka raste kur edhe specialistë në disa reparte specialistike qendrore, nuk ngurojnë fare që në ordinancat e tyre gjatë vizitave të pranojnë brenda nga dy, tre e më shumë pacientë, dhe në praninë e të gjithëve kryejnë kontrollin dhe flasin për diagnozën me pacientët. Edhe këto raste nuk duhet të ndodhin fare, sepse nuk është e pëlqyeshme që pacientët të dëgjojnë për diagnozën dhe sëmundjen e njëri tjetrit. Do të ishte më mirë sikur këta specialistë gjatë vizitës mjekësore t'i pranonin pacientët veç e veç, e kurrsesi sëbashku.

Fundja lindjen dhe vdekjen e jep dhe e merr vetëm Allahu dhe çdo gjë është në dorën e tij. Mantelet e bardhë duhet të jenë koshientë dhe të përgjegjshëm për punën e tyre edhe në respektim të privacisë dhe të etikës mjekësore.

Nga ditari i gazetarit në Dibër të Madhe

Adem Demaçi për president të Kosovës

Kohëve të fundit është vënë në spikamë të mediave dhe opinionit kosovar posti i Presidentit të Kosovës. Janë duke u përmendur shumë emra dhe është momenti kur nuk duhet gabuar dhe për president të zgjidhet më meritori.

Perëndia ia fali Kosovës Adem Demaçin kaqë vital. e mendjehollë, shkrimtar, patriot e aktivist i shquar, sypatrembur, i palodhshëm, i sinqertë dhe i pakursyer me rrezatim mbarëshqiptar. Për fat të keq ne nuk jemi duke e çmuar dhe respektuar sa e meriton dhe nuk po i japim mundësinë e plotë që të kontribuojë sa duhet për Kosovën e shqiptarinë.

Adem Demaçin për herë të parë e takova në dhjetor të vitit 2006 në Dibër të Madhe, ku kishte ardhur në Hotelin e Banjës së Banishtit për të përfunduar një roman të tij. E takova në momentet e nisjes për në Kosovë, por kjo nuk e pengoi fare të ulemi e ta bëjmë një intervistë për gazetat "Fakti" të Shkupit dhe "Rruga e Arbërit" të Tiranës.

Herën e dytë Bacën Adem e takova në Banjën e Kosovrastit po në Dibër të Madhe , në gusht të vitit 2008, me ç'rast e bëmë edhe intervistën e dytë, sërish për gazetat "Fakti" dhe "Rruga e Arbërit".

Për herë të tretë Adem Demaçin e takova në Dibër të Madhe, në qershor të vitit 2011 me rastin e promovimit të librit Studime 4 të Prof.Dr. Mahmud Hysa. Pas promovimit të librit, nuk nguroi fare ta bëjmë edhe intervistën e tretë, në praninë edhe të gazetarëve tjerë, e cila u botua, dha mesazhin e duhur nga Dibra e Madhe, duke zgjuar interesim të madh si edhe intervistat e mëparshme.

Mbresa profesionale që më la Adem Demaçi është pozicionimi i tij i menjëhershëm si bashkëbisedues, përgjigjet e rufeshme, të sakta, përmbajtësore e të qëlluara ndaj pyetjeve të lidhura gjithnjë me çështjen kosovare e mbarëshqiptare në kontekst të aktualitetit të brendshëm e të jashtëm, të atyre që ia duan dhe nuk ia duan të mirën Kosovës. Për Bacën Adem nuk nevojitet parapërgatitje për intervistë, siç ndodh me të tjerët, ai është i gatshëm maksimalisht dhe pa asfarë hezitimi tu përgjigjet në çdo moment pyetjeve të gazetarit.



Adem Demaçi

Nuk ka gjë më të lumtur e më të lëhtë për gazetarin, kur ka për bashkëbisedues Adem Demaçin, njohësin e shkëlqyer të gjendjes politike, shtetërore, diplomatike dhe ndërkombëtare të çështjes kosovare e mbarëshqiptare.

Të njejtën frymë të shprehjes së mendimeve, koncepteve, sugjerimeve, e zgjidhjeve, kemi patur rastin ta shohin e dëgjojmë nga Adem Demaçi edhe në intervistat e tij televizive në Prishtinë, Tiranë, Shkup e gjetiu. Intervistat dhe bisedat me Adem Demaçin janë gjithnjë interesante e tërheqëse, kanë siguri dhe udhërëfim për lexuesin, dëgjuesin dhe mbarë opinionin.

Të gjithë ata që kanë patur rastin ta dëgjojnë Adem Demaçin, besoj se ndajnë mendimin me ne, se në rafshin kosovar e mbarëshqiptar nuk ka njohës më të mirë të historisë e situatës kosovare dhe mbarëshqiptare, nuk ka prezentues që me aqë lehtësi, urtësi e saktësi t'i paraqet problemet tona që na ngulfatin me shekuj dhe opsionet më konstruktive e fatlume për zgjidhjen e tyre.

Adem Demaçi është protagonisti dhe përjetuesi i të gjitha fazave më shumë se gjysëmshekullore të shqiptarëve në Ballkan. Ne rafshin kosovar e mbarëshqiptar ne nuk gjejmë personalitet më komplet, më të sinqertë, më të gatshëm e realist për të dalë nga kjo mori problemesh që kemi.

Na gjeni një shqiptar të ngjashëm si Adem Demaçi që në rini të ketë shkruar romanin "Gjarpinjtë e Gjakut", që 28 vite të jetës t'i ketë kaluar në burgjet më famëkeqe të ish Jugosllavisë, duke mos u shkëputur kurrë nga kauza kosovare e mbarëshqiptare. Ai e ka vënë shumë herë jetën në rrezik, sidomos në takimet dhe përfaqësimin e denjë të luftës së UÇK – së, duke mos u larguar nga Prishtina edhe në pikun e ekzodit më të madh kosovar, vetëm e vetëm për t'i ndihmuar Kosovës dhe popullit kosovar. Na gjeni një tjetër si Adem Demaçi, që si dje dhe sot për Kosovën dhe kosovarët të sakrifikojë aqë shumë.

Duke parë këtë intelektualitet, energji, gatishmëri e mundësi për ta ndihmuar Kosovën, shtrojmë pyetjen përse Adem Demaçit nuk i mundësohet ta udhëheqë Kosovën ?!

Baca Adem i ka të gjitha nishanet për të qenë në krye të Kosovës. Ai është intelektual i përsosur, personalitet që e don lirinë e paqen për të gjithë. Ai ka vizion të qartë, aftësi organizative dhe njohuri mahnitëse për ta çuar Kosovën para. Egzistojnë shumë mënyra për ta vënë Adem Demaçin në krye të Kosovës. Po qe se është problem Kushtetuta, ajo nuk është Kur'an dhe mund të ndryshohet. Po qe se mbahet edhe referendum, populli me siguri do të dëshmojë se e don dhe e çmon Adem Demaçin.

Si do që të jetë Baca Adem duhet vendosur në postin e presidentit që e meriton sa është vital dhe i gatshëm të kontribuojë për Kosovën, kosovarët e tërë shqiptarët. Sa është koha e sa nuk është bërë vonë, sepse Perëndia si na e dha Adem Demaçin, ashtu edhe mund ta merr nesër. T'i japim mundësinë që Adem Demaçi të bëhet president sa është gjallë e i kuvetshëm për të mirën tonë të përgjithshme.

Rexhep TORTE

Oferta dhe çmime çdo muaj

Blloku "Gintash", Laprakë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

portrete



Nderim për Xhafer Seitin

Lum kush lë gjurmë

Lum kush lë gjurmë, lum kush le fjalën dhe shembullin e mirë! Kështu urojnë dibranët prej shekujsh. Fjala dhe shembulli i mirë rrezatojnë, dëshmojnë, flasin dhe kurrë nuk vyshken, nuk shuhen, nuk harrohen. Është në genin shembullor të dibranëve që mirësinë ta gdhendin në bronx si i thonë fjalës. Kështu ka ndodhur dhe me ish prefektin e Qarkut të Dibrës, birin e Tepelenës Xhafer Seiti. Mbi gjashtë vite përkushtim, punë, përpjekje, veprimtari dhe shpirt demokratik tregoi Xhafer Seiti në Qarkun e Dibrës. Si njeri, si intelektual fisnik, si demokrat dhe si prefekt. Pra detyrën e konsideroi sakrificë. Sigurisht që Xhafer Seiti kishte dëgjuar për thënjet në popull si "Universitet i Dibrës", për traditat, bujarinë dhe besën e dibranit, për nderimin dhe respektin që kanë dibranët për kuadrot jabanxhi. Xhaferi sapo shkeli në Dibër tregoi shpirtin e mençurisë intelektuale, taktin prej drejtuesi human e njeriu me vlera të rralla. Me të drejtë ia vlen të citojmë poetin e madh gjerman Gëte i cili thoshte: "Ju që keni poste,tituj e grada lini vepra që të mos ju venë nofka..." E padyshim që Xhafer Seiti la veprën më të çmuar në Qarkun e Dibrës, la mundin, djersën dhe dijen e tij prej njeriu erudit. Ishte i pranishëm në çdo aktivitet që organizonin dibranët qoftë në Peshkopi por dhe në Tiranë, ishte i lidhur shumë me artin dhe kulturën e kërkonte të dinte mjaft për Dibrën. Skënder Cala tregon:

-Sa herë vinte në Tiranë në fund jave do të vinte në librarinë time. Interesohej për botimet e reja. Blinte shumë libra por ajo që më ka bërë më shumë përshtypje tek ky njeri, ishte se blinte çdo libër që botohej për Dibrën dhe dibranët, blinte dhe të gjithë botimet e autorëve dibranë qofshin ato në porzë, poezi apo dhe studime. Kurse mësuesi Sabri Pira do të shprehet ndryshe për Xhafer Seitin: "Ishte njeri i thjeshtë e tepër i komunikueshëm me të gjithë. Intelektual i kompletuar e me vlera të mëdha. Ai mori shumë nga Dibra por dhe solli në Dibër kulturën dhe vlerat e labërisë. Syri kurrë nuk e shikon veten. Pra është populli i Dibrës, Bulqizës dhe Matit ato që flasin sot me respekt e mirënjohje për Xhafer Seitin". Në gëzime e hidhërime kudo ku ndodhnin Xhaferi kërkonte të ishte i pranishëm

Dhe kur për arsye pune nuk kishte mundësi telefoni i tij mbushej plot me mesazhe urimi qofshim apo dhe ngushëllimi që nga kalaja e Dodës e deri në Ulëz. . Krahas punëve që kishte në prefekturë Xhaferi u lidh ngushtë edhe me mediat e Dibrës dhe matit duke u bërë kështu një bashkëpuntor i rregullt i tyre. Në vitin 2006 do të shkruante në gazetën ;"Rruga e Arbërit" "E di se rruga e Arbërit do të ndërtohet pork am dëshirë ta ndërtojë qeveria që përfaqësoj" Dhe vërtet Xhaferi e dinte mirë se nga kalonte traserja e Rrugës së Arbërit, i kishte mbështetur mjaft nismëtarët e këtij projekti ambicioz e bashkë me to e kishte shkelur dhe në këmbë këtë gjurmë që tashmë ka filluar të zgjatet traseja e re. Janë dëshmi e vlerave inteletkuale botimet e tij në organe të ndryshme të vendit por në veçanti tek gazeta "Dibra" dhe "Rruga e Arbërit" si shkrimet:'Përshkallëzimi i dhunës si mjet për largimin nga perëndimi",'Rajonalizimi i teritorit të Shqipërisë domosdoshmëri","Dua që emri im të mbahet mend për mirë nëpërmjet punës, në shërbim të komuniteteve", "A kemi bërë sa duhet për të nderuar studentët e dhjetorit" e plot shkrime me vlera të botuara prej tij. Xhafer Seiti ishte dhe mbeti intelektuali model dhe vizionar, njeri i palodhur dhe sakrificave. Në gjashtë vite e ca si prefekt e ku nuk shkeli këmba e tij: Në Lurë e Kala të Dodës, në Selishtë e Gollobordë, në Zerqan e Shupenzë, në Klos e Ulëz. Edhe pse ndodhej me pushime ai sapo të merrte vesh nga lajmet në media se rrugët e Qarkut të Dibrës janë të bllokuara nga bora do nisej vetë për atje, do merrte masa për zhbllokim rrugësh që komunitetet të mos vuanin për furnizimin e domosdoshëm. Ai sot është larguar nga Dibra por do të kalojnë vite e do kujtohet përsëri me respekt si intelektual i kompletuar, kudro vizionar.

MEVLUD BUCI

Dibrani që bëri emër në Rusinë e largët

SHAQIR SKARRA

Si sot 88 vjet ma parë, më 5 janar të vitit 1924 në një familje patriotike e atdhetare nga Dibra e Madhe lindi Ramadan Çilku, nip i patriotit Said Najdeni. Që në moshë të re është aktivizuar në luftë për çlirimin e Atdheut si dhe për bashkimin kombëtar. Me mjaft devotshmëri ka kryer një sërë aksionesh në ato vite kundër analfabetizmit dhe përhapjes së kulturës shqiptare në Maqedoni. Në vitin 1946 diplomohet në fakultetin e Jeroslavës.U largua herët nga vendlindja e dashur ashtu si shumë dibranë të tjerë dhe këmbët e çuan përfundimisht në Sant-Peterburg të Rusisë ku ende jeton atje së bashku me familjen e tij. Sot aktualisht është në pension por nga shpirti ende ndjehet i ri dhe i papërtuar për të dhënë kontributin e tij në promovimin e vlerave kulturore e artistike të Dibrës dhe dibranëve edhe në Rusinë e largët. Ramadani si atdhetar dhe patriot i flaktë është marrë herët me kultivimin e kulturës shqiptare tek shqiptarët e Ukrainës. Mban lidhje të të shpeshta e të rregullta me këtë komunitet dhe ndihmon klubin artistik "Rilindja" në Karakurt.Jo vetëm kaq por ndihmon dhe ndërmjetëson në botimin e mjaft librave shqip në këtë komunitet. Kështu ka ndihmuar autorët e botimit të librit: "Shqiptarët e Ukrainës" si dhe "Antologjia e letërsisë shqipe" në rusisht dhe në pregaditjen e gazetës në gjuhën shqipe me titull: "Shqiptarët në Ukrainë". Ramadan Çilku edhe pas daljes në pension vepron e punon në fusha të ndryshme dhe për gjallërimin e jetës kulturore e artistike të shqiptarëve të Ukrainës. Ramadani është dhe piktor ku ka hapur dhe disa ekspozite pikture në San Petërburg. Dibrani i mirë Ramadan Çilku edhe pse punoi e jetoj një jetë të tërë jashtë atdheut, asnjëherë nuk e braktisi atë por me mendje e zemër gjithmonë ka qenë dhe mbetet në Dibrën e tij të dashur. Ramadani qysh herët është marrë



Ramadan Çilku

duke mbledhur folklorin aq të pasur të Dibrës ku tani po merret me grumbullimin e anekdodave dhe aforizmave dibrane ku së shpejti do të shikojë dritën e botimit me titull: "Kash e lash" Është ndër shqiptarët e vetëm ndoshta në të gjithë Ukrainën që ka bërë një punë kolosoale për të evidentuar dhe zbuluar të gjithë fshatrat të banuara nga shqiptarë në Odesë dhe rrethinat e saj ku këmba e tij i ka shkelur të gjitha ato vise në Rusinë e largët që jetojnë e punojnë shqiptarët. Ka krijuar vetë ansamblin e femrave shqiptare "Lulet" si dhe korin e veteranëve. Ramadani asnjëherë nuk i ka shkëputur lidhjet me Dibrën dhe dibranët dhe këtë ndjenjë të lartë atdhedashurie e ka përçuar dhe tek bashkëshortja, fëmijët, nipërit e mbesat e tij.



Ramadan Çilku në ekspozitën personale

Njoftim për bashkëpunëtorët

Të nderuar bashkëpunëtorë

Prej muajsh, redaksia ruan në arkivin për botim disa materiale, të cilat po të botohen zënë një hapësirë prej 2 ose më shumë faqesh.

Për këtë arsye, redaksia e gazetës "Rruga e Arbërit" njofton gjithë bashkëpunëtorë e saj, se shkrimet që sillen për t'u botuar, duhet të jenë jo më shumë se 5 faqe të daktilografuara (përafërsisht 10000 mijë karaktere, pa përfshirë hapësirat). Materialet që vijnë me email ose në çdo lloj forme elektronike, duhet të jenë në **Word**, me fontin **Times New Roman**, të madhësisë **12pt** dhe me hapësirë **1.5**. Gjithashtu, kujtojmë se materialet e pranuara në formë elektronike duhet të kenë patjetër germat **"ë"** dhe **"ç"**.

Çdo material i gjatë do ti nënshkrohet redaktimit dhe shkurtimit për tu botuar në versionin e shtypur të gazetës. Versioni i pa shkurtuar do të botohet çdo muaj në internet në adresën: www.rrugaearberit.com. Autorët mund ti shkurtojnë vetë shkrimet dhe të na i përcjellin në redaksi me dy versione botimi: **për gazetë** dhe **për internet**.

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, ju përcjellim konsideratat më të mira të redaksisë për bashkëpunimin e deritanishëm..

Për sqarime më të hollësishme mund të na kontaktoni me email në adresën <rrugaearberit@gmail.com>

REDAKSIA.

Prezantohet libri "Një jetë në 36 shkronja", të autores Hatixhe Erebara



Më datën 21 janar, në orën 11:00, në sallën "Aleks Buda" të Akademisë së Shkencave u bë promovimi i librit: "Një jetë në 36 shkronja", të autores dibrane Hatixhe Erebara. Mbledhur kujtimet që në moshë të re, pikërisht në atë moshë që i ishin vrarë të gjitha ëndrrat e luftonte me të vetmen shpresë për të mbi jetuar, për të rritur dhe edukuar fëmijët e saj se siç shprehet dhe vetë autorja në faqet e para të këtij libri: "dridhem tek më zgjohet kujtesa e moteve të fëmijërisë së trishtuar që më shfaqen si në ekran televiziv…", më së fundi autorja ia doli mbanë të dilte para lexuesve , miqve të saj, fëmijëve e bashkëshortit me një libër disi të veçantë për nga lloji. Ky libër nuk është as ditar, as tregime, as novelë siç tha një nga salla por një gjini krejt e veçantë në letërsinë tonë. Është e gjithë jeta e bukur, e vështirë e plot zik-zake e vetë autores dhe familjes së saj. Por jo vetëm kaq, autorja na jep pamjen e trishtë të atyre viteve të qytetit të Peshkopisë ku diktatura e sapo instaluar në vendin tonë

mërrte dhe jetë njerëzish të pafajshëm. Salla ishte mbushur plot dhe jo vetëm dibranë por dhe miq e të njohur nga Lushnja e Tirana. Shkrimtar e studiues, gazetar e ish kolegë të autores, miq e të njohur të kahershëm.Si gjithmonë në aktivitete të dibranëve, moderatori Defrim Methasani do të bënte për të pranishmit një prezantim të shkurtër të autores dhe të shumicës së pranishmëve në sallë. Kryetari i shoqatës "Bashkësia dibrane" zoti Faruk Borova duke përshëndetur në emër të kësaj shoqate foli shkurt për familjen e njohur atdhetare Erebara dhe falënderoi të pranishmit në këtë aktivitet të cilin ishte pikërisht kjo shoqatë që e kishte organizuar. I pari që e mori fjalën dhe foli më shumë rreth librit ishte shkrimtari Lutfi Hanku, njëkohësisht dhe redaktori i këtij libri, i cili i bëri një analizë të plotë librit të Hatixhe Erebarës duke e klasifikuar si një libër mjaft të arrirë që na jepej ne lexuesve në duar si dhuratë në këtë fund muaji. Studiuesi dhe shkrimtari Hajri Mandrri në fjalën tij u ndal më së shumti në veçoritë e librit, i cili ndryshe nga të gjitha botimet e deri tanishme ka dhe të veçantën e tij, një jetë e shkruar bukur, plot ndjenjë dhe romantizëm. Foli dhe ish mësuesi i shkollës pedagogjike në Peshkopi Osman Olia.



Foli dhe miku dhe dashamirësi i dibranëve por dhe vetë me orgjinë nga Dibra studiuesi dhe shkrimtari Faik Xhani, foli dhe Meliha Strazimiri dhe në fund përshëndetën në emër të shoqatës "Tirana" ku mes fjalës përshëndetëse lartësuan vlerat e Dibrës dhe dibranëve jo vetëm në vitet pas nëntëdhjet, por qysh herët kur u bënë pjesë e banorëve tiranas.

Në fund të këtij aktiviteti autorja shpërndau librin e saj falas për të gjithë të pranishmit në sallë me autograf. Nga një gotë verë, nga një gotë raki, dhe një urim i përbashkët nga të pranishmit: Urime Hatixhe! Vonë por më së fundi fole. E vrave frikën!

ERALDA SKARRA
Studente në gazetari

Libra që mundësojnë njohjen e vendlindjes

Nga **ESMERALDA BICA**

Kanë dalë në qarkullim librat: "**Gryka e madhe**, **vatra e dijes**"dhe "**Yje që ndriçojnë Bulqizën**"të autorit Destan Rama. Janë dy libra me vlera historiko-didaktike dhe që kanë një objektiv të përbashkët; zhvillimin historik dhe arsimor të trevave Zerqan dhe Bulqizë në rrethin e Bulqizës.

Autori me këta libra ka ngritur një lapidar të përjetshëm për tempujt e dijes që ndriçojnë këto treva.

Librat në fjalë janë me shtrirje të gjerë kohore dhe gjeografike.

Duke i lexuar këto libra dhe duke i bërë ata pronë të tij, lexuesi do të njihet me historikun e hershëm të vendbanimit të këtyre trevave (SHEK. XI – IX PARA KRISHTIT) të dëshmuara me objektet dhe materialet e gjetura, do të njihet me luftërat heroike që janë zhvilluar në mbrojtje të tyre, si: Beteja e Torviollit, Lufta e Vajkalit, Beteja e Xixullit, Lufta e Drinit te Zi, si edhe luftërat kundër serbeve, austro - hungarezëve, bullgarëve, italianëve, gjermanëve, etj...

Të dhënat e gërmimeve arkeologjike në disa vende të këtyre trevave dëshmojnë për një kulturë të pasur dhe të lashtë ilire. Si të tilla përmendim; gjetjet arkeologjike në fshatin Krajkë tek Ura e Qytetit, në Fushë - Gurrë (Strikçan) në Qafen e Sofraçanit në Kokërdhok (fshati Koçaj Bulqize). Te Lugu i Qipave, rreze majës së Lepurit (fshati Vajkal Bulqizë) etj..

Mjaft interes paraqet për lexuesin fakti që në malin e Duriçit (Bulqizë) në lindje të zones D , tek livadhi i Ballit ka qenë ndërtuar një punishte katrani, që prodhohej nga rrëshira e pishës në kohën e Skënderbeut dhe që ai e përdorte për qëllime lufte.





Me kureshtje lexohet në libra etimologjia dhe toponimia e emërtimeve në trevat ne fjale, si: Bulqizë,Qafa e Buallit, Vajkal, Zerqan, Peladhi, Godvi, Dragu etj.

Njohja me traditat dhe virtytet e shkëlqyera të këtyre trevave, si: mikpritja, bujaria, trimëria, zakonet, festat,veshjet etj., përbëjnë një fakt me mjaft interes për lexuesin.

Janë për t'u admiruar librat, pasi autori ka përshkruar historikun e zhvillimit të çdo fshati veç e veç për të arritur në një përfundim mjaft domethënës që na njeh me përpjekjet titanike që u bënë nga patriotët, intelektualët, deri te njerëzit e thjeshtë të cilët çelen shtëpitë e tyre e i shndërruan në shkolla, dhanë ndihmesën e tyre në ndërtimin e shkollave me kontribut vullnetar, si edhe strehuan mësuesit jabanxhinj vetëm e vetëm për të marrë dritë e dituri.

I një rëndësie të veçante është fakti se lexuesi do të njhet me mineralin e kromit (ç'është ai për ne), do të njihet me historikun e fillimit të punimeve në minierën e Bulqizës, me prodhimin e mineralit të kromit në vite, me vlerën ekonomike të tij si edhe lakmitë e të huajve për këtë minierë etj.. .

Autori duke qenë dhe vetë mësues ka ditur të evidentoje, të vlerësojë dhe të nxjerrë në pah përvojën pozitive të mësuesve të parë në shkollën e parë shqipe të çelur këtu, si dhe atë në vitet në vazhdim e deri në ditët e sotme. Kjo përvojë mbetet aktuale gjatë gjithë viteve të shkollës shqipe, bile besoj se nuk e teproj po të them edhe sot. Po kështu gjatë leximit do të njihemi edhe me punën dhe përvojën e mësuesve në vite , me mësues model e shkolla të suksesshme.

Le të kujtojmë disa sentenca pune nga mësuesit e parë. Mësuesi Thanas Baçova (Fier): Meqë mjetet mësimore nuk kishim, i përgatisja vetë ata për konkretizimin dhe ngulitjen e mësimit. Një ditë qëllova me një pëllëmbë të lehtë një nxënës. Mirëpo ai mori frikë. M'u desh që këtë nxënës ta mbaja afër, ta trajtoja mirë për gati tre muaj sa për t'ia hequr mendimin e frikës. Ky nxënës arriti që në fund të vitit të dilte i pari i klasës. Mësuesi Munir Shehu: Në vitin 1943 ra borë e madhe në Zerqan. Rrugët u bllokuan. Ditën e parë ndenjëm në dhomë duke u rëne veglave muzikore. Fshatarët hynin e dilnin në shkollë. Të nesërmen ata hapën rrugët dhe i sollën fëmijët në shkolle...

Këta përvoja pune si dhe të tjera si këta do të na njohin me punë të ndershme, të palodhur e me cilësi të mësuesve si misionar të dijes.

Së fundi, mendoj se librat në fjalë duhet të jenë pronë e çdo shkolle, e çdo institucioni si edhe e çdo familjeje grykamadhëse dhe bulqizaku e më gjerë. Bazuar në liritë programore të programeve u mundësohet nxënësve më së miri dhe bashkë me ta të gjithë lexuesve të mësojnë mbi historikun e zhvillimit të arsimit në trevat e vendit të tyre.

NJOFTIM

Shkrimtari Ymer Keta ka në proces librin "Fytyrat e zverdhura të Kromit". Pjesë e këtij libri do të jenë të gjithë ato persona që janë aksidentuar në minierën e kromit Bulqizë e që kanë humbur jetën. Ndaj jeni të mirëpritur të gjithë të afërmit e tyre që të na siguroni një foto dhe të dhëna të shkurtra për personat që kanë humbur jetën në këtë minierë.

Jeni të mirëpritur të kontaktoni nëpërmjet nr. **cel: 068 32 85 598**

Faleminderit për mirëkuptimin
Ymer Keta

kritikë

Kumtet identifikuese etnike të një libri

Nga: **NAIM ZOTO**

Shaban Sinani: "Tradita gojore si etnotekst- studime për etnofolkloristikë krahasimtare", botimet "Naimi"

Dukuritë e krahasueshme të traditës gojore janë ato që u takojnë epokave më të hershme të mendimit njerëzor: prej lirikës rituale, mitologjisë, eposit, traditës etnojuridike deri tek epika historike. Për këtë arsye do të ishte më e arsyeshme të flitej për një lëndë të karakterit etno-folkloristik, sepse këto përbërëse të traditës gojore (kulte, mite, rite, magji) të tillë e kanë shkallën e sinkretizmit.



Vepra e re e prof. dr. Shaban Sinanit me titullin "Tradita gojore si etnotekst- studime për etno-folkloristikë krahasimtare", botimet "Naimi", të befason për thellësinë e analizës së asaj lënde artistike, historike që ka nisur të krijohet mijëra vjet më parë; nga ngjizja e popullit shqiptar, paraardhësve të tij iliro-arbërorë, dhe deri vonë kur u formësua kombi shqiptar me identitetin e tij në aspektin etnik, kulturor. Autori e shpjegon kështu lindjen e këtij libri: "Disa vite më parë, kur studiuesja e letërsisë Dhurata Shehri, drejtore e departamentit të letërsisë shqipe në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, më bëri ftesën për të mbajtur një kurs leksionesh për folkloristikë të krahasuar në shkollën e masterit, m'u desh t'i bëja vetes shumë pyetje. Si do të ishte më e vlerësueshme? Një syllabus për bazat teorike, rëndësinë, qëllimin, metodat dhe funksionet e folkloristikës krahasimtare? Apo një lëndë që u mundëson studentëve e lexuesve njohjen e traditës gojore shqiptare përmes krahasimeve me tradita të tjera? Krahasimet përgjithësisht provokojnë, cenojnë, përafrojnë e po aq mosbarazojnë. Por krahasimeve dhe metodës krahasuese, megjithëse moda mund t'u ketë shkuar, mundësitë nuk u kanë shteruar. Në filozofinë e botës së sotme është "të shohësh veten tek tjetri". Kjo filozofi është themeli i eurokulturës dhe eurocentrizmit. Duket si një shpikje e botës së sotme dhe si një parim i krijuar për të përligjur dukuritë e mondializimit të shijeve të njerëzimit të shekullit të 20-të, por dukuria është zanafillëse, po aq zanafillëse sa dhe antagonizmi me tjetrin. Grekët e lashtësisë antike përdornin opozicionin "ne dhe barbarët", në kuptimin "ne dhe ata që nuk flasin si ne"; por në të njëjtën kohë dhe opozicionin tjetër: ne dhe simpatia / empatia ndaj tjetrit".

Folkloristika krahasimtare nuk është një shpikje didaktike për të plotësuar vetëm nevojat e formimit në shkolla, parauniversitare, universitare e pasuniversitare. Janë të panumërueshme burimet e krahasueshmërisë midis traditave gojore të popujve. Kur vëllezërit Jacob e Ëilhelm Grimm koleksionuan e botuan "Children's and Household Tales" - "Kinder - und Hausmärchen" ("Përralla për fëmijë dhe të rritur"), duke përcaktuar se shumica e motiveve të prozës popullore të popujve mund të referohej në një arketip, kryesisht lindor, metoda krahasimtare nuk kishte lindur ende. Gati një shekull më vonë, kur Vladimir Propp, një prej dijetarëve më të shenjuar të historisë së antropologjisë në shekullin e 20-të, krahas me Claude Lévi-Strauss, botoi studimin e mirënjohur "Morfologjia e përrallës", duke i përafruar përrallat e popujve të botës, pavarësisht prej racës, etnisë, gjuhës, kulturës, qytetërimit, gjendjes së zhvillimit, në tipologji e funksione, ende një disiplinë e folkloristikës së krahasuar nuk ekzistonte, në kuptimin ekdotik. Por ekzistonte objekti i kësaj dije, ekzistonte mundësia e vërtetë e krahasueshmërisë, si një mënyrë për të identifikuar një traditë gojore përmes afërive, ngjashmërive, dallimeve, bashkëpërkimeve me të tjera tradita si ajo.

Dukuritë e krahasueshme të traditës gojore janë ato që u takojnë epokave më të hershme të mendimit njerëzor: prej lirikës rituale, mitologjisë, eposit, traditës etnojuridike deri tek epika historike. Për këtë arsye do të ishte më e arsyeshme të flitej për një lëndë të karakterit etno-folkloristik, sepse këto përbërëse të traditës gojore (kulte, mite, rite, magji) të tillë e kanë shkallën e sinkretizmit.

Autori, duke iu referuar ngjashmërive, i klasifikon kështu:

ngjashmëri për shkak të karakterit universal (mitet uranike, kronike dhe ktonike; mitet zoomorfe - totemitë; raportet me hyjtë, kulti i vertikalitetit);

për shkak të burimit gjenetik (shtresa indoeuropiane: heronjtë mitologjikë kulturorë me fuqi të mbinatyrshme, heronjtë me pikë të dobët, kulti i numrave simpatikë dhe antipatikë);

për shkak të tipologjisë së llojit (eposi, ligjet e shfaqjes dhe mbylljes së epopesë, vargu misionar);

për shkak të lidhjeve të kryehershme historike (kulturat e antikitetit: mitologjia greke, romaniteti);

për shkak të nënshtrateve kulturorë (gjurmë të miteve të popujve paraindoeuropianë si pellazgët);

për shkak të përgjithësimit të dukurive prej kulturave imperiale dhe liturgjike (Shkrimet e Shenjta, ligjërimi biblik e ungjillor);

për shkak të prekjes në historinë europiane e ballkanike në rrjedhë të mijëvjeçarëve (shtresat anzhuine, normande, hispanike, napoletane, bizantine, osmane);

për shkak të arealizimit të kulturave (bashkëpërkimet ballkanike);

për shkak të fqinjësisë së dikurshme a të vonë.

Kjo ndarje nuk bëhet për arsye lehtësie apo teknike, por për pikërisht për të dalë tek vlera kryesore e librit: të rinjihet pasuria e brendshme e traditës gojore vendëse (pra, shqiptare), duke mundësuar vlerësimin e saj si etnotekst. Pikërisht kjo është arsyeja që titulli i këtij libri është "Tradita gojore si etnotekst", sepse më shumë se krahasueshmëria zor se mund të ketë mënyrë tjetër për ta përveçuar atë, qoftë në pikëpamjen etnofoklorike, qoftë në atë etnolinguistike, si kumt identifikues etnik.

këtu mund të ishte njoftimi juaj

...NJË REKLAMË E VOGËL - NJË KONTRIBUT I MADH...

për më shumë informacion shkruaj në adresën e emailit:

<rrugaearberit@gmail.com>

Rruga e Arbërit nr. 69

Mendime rreth librit monografik “Dinjitet përball intrigës” të autorëve Faik Xhani e Ilmi Dervishi, kushtuar Shaban Dervishit

monografi

Dëshmi e dinjitetit njerëzor

Nga: **MEVLUD BUCI**

Libri monografik: “ Dinjitet përball intrigës” i autorëve të nderuar Faik Xhani e Ilmi Dervishi kushtuar birit të Dibrës Shaban Dervishi, përbën një vlerë të çmuar për historinë, brezat, jetën, një vlerë të rrallë për publicistikën e mbi të gjitha përbën dëshmitë e përpjekjeve, të djersës, përpjekjet përball akuzave e vuajtjeve që të shkaktojnë intrigat.

Pa mëdyshje, pa aspak eliozhe apo hiperbolizim, por për realitet historik e demokratik ky libër i çmuar mund të quhet edhe “Provat e qendresës, ndaj pabesisë”. Pasi lexon këtë monografi të vijnë ndërmend thëniet filozofike të At Gjergj Fishtës, i cili thoshte: “ Kush e mëson se është i pabesë qit nagandën, e bjeri kresë”. Historia nuk ta fal nëse nuk e godet ligësinë, shpifjen, intrigat, pabesinë.

Qysh në hyrje, në argumentet e qarta të redaktores së mirënjohur Fatime Kulli e në çdo shkrim të këtij libri mëson qartë për vlerat, për gjurmët, për qëndresën e përballjen me intrigat. Mëson dëshmitë sesi rritet diniteti njerëzor.

Libri i autorëve Faik Xhani e Ilmi Dervishi me titull: “Dinjitet përball intrigës”-shkruan redaktorja Kulli është një monografi ku veç materialeve gojore si mbresat, kujtimet e përfundimet vishen bukur e ndërthuren me materiale dekumentare nga Arkivi i Shtetit, të cilët i japin frymëmarrje më të madhe librit, besueshmëri, seriozitet e vlerë.(f.6).

Qysh tek shkrimet “Dardha-qytet”, “Lugjejt”, “ Nga Dogj Boçi në Dervish”, “Llan Ali Dervishi”, “Elez Llan Dervishi” na jepen gjurmë e fakte historike, pasqyrohet tradita, geni atdhetar e kulturor, lëvizjet e fisit, lufta e Gjon Boçës që më 1464 ndryshoi vendbanimin, ku nga Mjeda kaloi në Mirditë, në Lurë, në Qafë të Dardhës, në shpatin lindor të Majës së Madhe.

Pushtuesit osmanë ushtruan presion të madh për kthimin e tyre nga të krishterë në myslyman, zaptuan ujin e pijshëm dhe rritën taksat. Kjo solli luftën. Nga lufta i biri i Gjonit, Dogja, u detyrua të kalojë matanë Drinit, në Lugje. Bashkë me vendbanimin e ri ndërroi edhe fenë, duke i vënë djalit të tij të vetëm emrin Dervishi. (f.11).

Kjo monografi e shkruar thjeshtë e me korrektësi në argumenta përmban edhe kujtimet e Nazifes-vjazës të Suf Dervishit, fëmijët e Elezit, Nanën e Madhe (Shkurte Poleshi), Dervishi, e cila u tha miqëve nga Tirana kur e pyetën se a merr pension? Ajo mençurisht, me filozofi popullore u tha: “ marr tre pensione”, se kishte tre djem. Libri na jep portretizimin e dajave si Riza Poleshi nga Sarica e Zall-Dardhës, emra të nderuar si: Isuf Poleshi, Xhelil e Osman Ferra etj.

Autorët nëpërmjet fakteve dhe përshkrimeve realiste, tërheqëse e argumentuese pasqyrojnë në plotësi sesi rritet diniiteti njerëzor, sesi u ndëshkua e qëndroi i patundur Shaban Dervishi, modeli i intelektualit të punës e të mençurisë, por që u godit nga rrufetë e intrigave të kohës moniste e qëndroi i pamposhtur siç thonë autorët Faik Xhani e Ilmi Dervishi “Midis dy zjarresh”: “Me karakterin e fortë si mali i Korabit dhe me përvojën e më shumë se tri dekadave si menaxher e administrator i vlerave materiale e monetare nuk u përkul, nuk u asimilua e nuk ra pre... Ky qëndrim kristal i Shaban Dervishit nuk po shihej me sy të mirë. Elementi keqëbërës e korruptiv i hodhi falangat e tij tej e mbanë. Cfarë nuk sajoi e nuk hodhi mbi magazinierin Zemërshkëmb, autoritar e të zot Shaban Dervishin...”(f.23).

Përballë hetuesit, përballë traumës psikologjike duke u përballur me pabesinë, me intrigat, me të xhindosurin që gërthet si bishë e egërsuar përpara Shabanit që ky të firmoste padrejtësinë që ia kishin kurdisur.

Është kuptimplote e mjaftë domethënëse ajo që shkruajn autorët e librit: Xhani e Dervishi: “ Edhe pse midis dy zjarresh Shaban Dervishi shpëtoi për mrekulli, pa u djegur e përcëlluar. Shpëtoi se qe i pastër e i pathyer si mali i Gramës e i Korabit, si uji e si ajri i atyre bjeshkëve”. (f.27).

Kur lexon librin: “Dinjitet përball intrigës” të bie ndërmend vargu i këngës epike mirditore që thotë se nuk kalb toka mineral, mëson mjaft të vërteta, mjaft enigma e kundërvënie, ku njeriut të thjeshtë, të përkushtuar e me dinjitet i vret shpirtin e djersën intriga, shpifja, kurthi, troç, pabesia. “Buka e dhënë e familjes Dervishi,-shkruhet në libër, dinjiteti, vendosmëria e përkushtimi i Shaban Dervishit ndaj direktivave të partisë e ligjeve të shtetit shqiptar si dhe dora e ngrohtë e mendja e mprehtë e Haxhi Lleshit bënë të mundur zbardhjen e së vërtetës dhe riabilitimin e figurës së Shaban Dervishit”. (f. 30).



Shaban Dervishi si vet fisi bujar e atdhetar, si vetë Lugjejt e Dardha, si vetë Dibra e çdo njeri i nderuar anembanë trojeve amtare e ka rrit dhe po e rrit dinjitetin, sepse nëpërmjet drejtësisë, qëndresës, mirënjohjes ka lartësuar e lartëson dinjitetin, virtyt ky i njerëzve të shquar, demokratëve të vërtetë pa ngjyra e intriga.

Me vërtetësi e frymëzim janë shkruar edhe shkrimet: “Pengu i Besnikut”, “Kujtesë dhe mirënjohje”, kapitulli “Rinia e Shabanit”, “Denjësisht në politikë” etj. Ku jepet edhe faksimilja e të madhit e të paharruarit, artistit të merituar Hazis Ndreu që i jep rekomandim për në parti, më 21.11.1961, rekomandimi i Mehmet Sulës etj. Shumë interesant janë edhe shkrimet: “Sfidë Diktaturës”, “nëntori 1967”,”prilli 1975" etj.

Argumentet mjaft interesante arkivore të faqes 71, na mësojnë një dëshmi të madhe, sesi intriga kërkon të përbalt dinjitetin, kjo është e duhet të jetë mësim i madh edhe tani në jetën tonë të ashtuquajtur demokratike, ku gjithkushi të shpif a bënë intrigë e nuk i futet ferra në këmbë, shkruan apo jep lajm të gënjeshtërt për të cënuar dinjitetin e të tjerëve edhe drejtësia bën sehirë. Në argumentet e faqes 71 mësojmë sesi vetë ish-udhëheqësi, vet partia shtet i godiste më të zotët, më të mirët, më dinjitozët, siç ishte edhe Shaban Dervishi i Dibrës. Pra, nëpërmjet vetmohimit dhe qëndresës, nëpërmjet drejtësisë e djersës, nëpërmjet fisnikërisë dhe mirënjohjes njerëzore e rriti dinjitetin Shaban Dervishi.

Pasqyrimi mjeshtëror në kapitullin e tretë i shkrimeve të Faik Xhanit, Halil Robit, Miftar Ramadan Fanës, Velo Cfarkut, Mevlud Bucit, Enver Hasës, Shuaip Methasanit, Rustem Devës, Halim Laçit, Mal Dragjoshit e Dogjasn Dervishit e plotësojnë më së miri portretin e personazhit kryesor e të nderuar të monografisë, njeriut të përkushtimit e të qëndresës, njeriut të fisnikësrisë Shaban Elez Dervishit.

Rapsodi i talentuar dibran e kombëtar Halim Laçi në vargjet mjeshtërore pas shkrimit të tij, na jep forcën e madhështinë e njeriut të mirë e të zot, na pasqyron sesi përfundojnë thashethemet pa vlerë, ndaj midis të tjerave shkruan “ Ishte djalë krenar/ me zemër të bardhë/ ishte kryetar/ dikurë në Zall-Dardhë.../ dikush me zë e nën zë/ në fund cfarë doli/ Nuk doli asgjë/ aty dilte fjala/ dhe sillej vërdallë/ dilte nga Zall-Dardha/ vinte në Zall-Dardhë/ Postieri dërgo letra/ Çdo ditë e përherë/ thashetheme të tjera/ të gjitha pa vlerë/ Koha në skenë ty të grishi/ faleminderit Shaban Dervishi/ “

Këto vargje hymn janë sintezë e luftës përballë intrigës, janë dëshmi e urtësisë si rritet dinjiteti.

Në këtë libër monografik autorët e nderuar Faik Xhani e Ilmi Dervishi kanë dhënë një publicistikë mjeshtërore me qartësi të argumentuar. Këtu gjen këndin e vet gjuhëtari, publicisti, politikani, historiani, diplomati dhe çdo njeri i thjeshtë. Gjen këndin e vet cilido që kërkon të ngjis shkallët e karrierës së tij duke përbaltur të tjerët, që bënë revansh pas ngjyrave e që vetë shpallet demokrat.

Ky libër të mëson se cili është demokrati i vërtetë, sesi rrezaton e nuk mund të përbaltet dinjiteti përball intrigës. Është vërtetë një libër modest me shumë vlera edukative bashkëkohore historike e demokratike, ku njeriu të ecë përpara e të qëndrojë sikurse i nderuari e qëndrestari Shaban Dervishi. Jeta, veprimtaria dhe shembulli i tij e meriton të mos mbetet në hije, por të vlerësohet. Ai emeriton plotësisht të jetë “Nderi i Komunës” Zall-Dardhë, e pse jo edhe “Nderi i Bashkisë Peshkopi”.

Suksese dhe ju lumtë mendja dhe penda autorëve të përkushtuar, Faik Xhani e Ilmi Dervishi!

Ka ndodhur nje ngjarje? Keni ndonje shqetesim

per te ndare me komunitetin?

Keni ndonje propozim per zhvillimin e zones suaj?

Doni te informoni komunitetin rreth jush per dicka qe ju intereson atyre?

SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!

< rrugaearberit@gmail.com >

Modeli ligjërimor dhe stilistik i Naim Berishës te romani "Gurkështjella"

Nga: **HAJRI MANDRI**



Romani është i shkruar në vargje dhe me stilin e rrëfimit fabulesk që nëkupton nëntëkstin dhe alegorinë. Në këtë ese do të merremi me modelet ligjerimorë që na ofron autori në këtë vepër. Ky roman parabolik rreh të pasqyrojë përmes modelesh ligjërimorë etnografik, liturgjik, letrar, me një arsenal shembëlltyrash që ndërthurin të kaluarën me të sotmen me një gjuhë semiotike.

Në produktin krijues të N.Berishës pas romanit që lexuam së fundmi "Bjeshkët e dashurisë", kemi në dorë një tjetër roman me temë aktuale "Gurkështjella"

Romani është i shkruar në vargje dhe me stilin e rrëfimit fabulesk që nëkupton nëntëkstin dhe alegorinë. Në këtë ese do të merremi me modelet ligjerimorë që na ofron autori në këtë vepër. Ky roman parabolik rreh të pasqyrojë përmes modelesh ligjërimorë etnografik, liturgjik, letrar, me një arsenal shembëlltyrash që ndërthurin të kaluarën me të sotmen me një gjuhë semiotike.

Ka një sinkretizëm në roman, një shkrirje dhe një fuzionim të formave të pasqyrimit. Raporti i individit me shoqërinë zë vendin kryesor. Përshtatja apo mospërshtatja me veset e shoqërisë, pohimet dhe mohimet filozofike të autorit i gjejmë të zbërthyera në një gjuhë alegorike herë në një stil të ligjërimit etnografik si rrëfim lirik i thjeshtë fabulesk, herë si ligjërim folklorik mbështetur totalisht në modele të këngëve dhe rapsodive folklorike, herë si modele ligjërimorë liturgjikë me frymë ungjillore dhe kuranore, kur operon në transmetim poetik përmes ritualit të vajtimit ose ritualit të betimit. Modeli ligjërimor më përgjithësues është ligjërimi parabolik ose e thënë shqip ligjërimi me shembëlltyra letrare. Ky model në sinkretizmin e tij na kujton modele të letërsisë antike, të traditës së letërsisë së vjetër shqipe, dhe modele nga letërsia jonë moderne nga Pashku deri tek Kadare, ku gjejmë transfertë totale të lëdës, të dhënë përmes alegorisë, shembëlltyrës, parabolës dhe paravolisë. Autori ndodh shumë herë që operon edhe me kode etnojuridike duke dhënë porosi morale të drejtpërdrejta që përngjasonjë me kode poetike lindore, modele të huazuara nga letërsia perse që në letërsinë tonë u sollën më së shumti nga Naim Frashëri dhe Dritëroi. Të gjita sa thamë më sipër vlejnë për konkludimin se autori po tenton tregje strukturore dhe kjo e bën veprën sinkretike. Mesazhi themelor i romanit është që " njerëzit e mençur të mos i lënë të padituri që të dalin në krye. Pengesat që krijojnë të pa aftët për ecur të aftët është një luftë e moçme dhe e vazhdueshme. Në kapitullin e dytë " dhelpra dhe shkrimtari' jepet raporti i shkrimtarit me audiencën duke prekur probleme të estetikës dhe lirisë krijuese. Autori portretizon veten duke e vënë atë përballë veseve të shoqërisë:

" U Linda, u rrita , unë s'di të flas tinëz
I kam zët njerëzit, që flasin pas shpinës" (f.27)

Koncepti më interesant dhe qendror i veprës është koncepti i lirisë, i përmasave të saj në jetë dhe krijimtari, i lirisë si koncept filozofik, i mënyrës së të menduarit dhe të jetuarit, dhunimi e skllavërimi që sjell mungesa e saj. Autori ngre një shqetësim që përbën leitmotivin e veprës; si ka mundësi që njeriu të përshtasë shpirtin, ndjenjat dhe psikikën e tij me të padobishmen kombëtare dhe të bëhet realitet virtual e keqja. Autori godet me humor komunizmin si ideologji dhe si sistem propogande që deformon njeriun në psikikë. Në raportin e individit me strukturën shoqërore qëndron ideja dhe mesazhi i autorit që për nga përmbajtja dhe mesazhi është një konceptim origjinal.

Koncepti më interesant dhe qendror i veprës është koncepti i lirisë, i përmasave të saj në jetë dhe krijimtari, i lirisë si koncept filozofik, i mënyrës së të menduarit dhe të jetuarit, dhunimi e skllavërimi që sjell mungesa e saj. Autori ngre një shqetësim që përbën leitmotivin e veprës; si ka mundësi që njeriu të përshtasë shpirtin, ndjenjat dhe psikikën e tij me të padobishmen kombëtare dhe të bëhet realitet virtual e keqja. Autori godet me humor komunizmin si ideologji dhe si sistem propogande që deformon njeriun në psikikë. Në raportin e individit me strukturën shoqërore qëndron ideja dhe mesazhi i autorit që për nga përmbajtja dhe mesazhi është një konceptim origjinal.

Duhen kuptuar e vlerësuar faktorët gjuhësorë, me kombinimet e tyre sintaksore e leksikore, se ato janë majaja e lëndës që përdoren gjatë të folurit alegorik. E folura me nëntekst në romanin "Gurkështjella" përbën një dukuri e shprehje etnolinguistike, me shtrirje gjeografike shqiptare. Romani është mbështetur edhe në traditën etnolinguistike të trevës ku është lindur dhe formuar. Vetë gjuha alegorike është sistemi linguistik, ku realizohet e folura fabuleske. Edhe materiali, me të cilin autori gatuan këtë të folur, nuk përmban fjalë të huaja dhe mbështetet në të folurin nëndialektor, në njësi të vogla, pikërisht tipike për atë zonë apo krahinë. Rrëfimi në ka në themel tregime të shkurtra në vargje të ndara në kapituj, ngjarje dhe inskenime fabuleske të përpunuara artistikisht. Në mjaft episode kemi shembëlltyra të cilat gjatë përdorimit e kanë humbur strukturën por autori përdor shprehjet frazeologjike që burojnë prej tyre:

"Ka jeta plot, punë të mëdha e të vogla,
Lum kush nuk shkon kot si dushku për gogla" (po aty.f.27)

Me epitete e krahasime që vijnë nga njohja që autori ka në nëndialektin lokal " Unë jam derë e parë, unë jam soj shilosh" (f.31) Me efekte stilistike janë rrëfimet si konstrukt etnofolklorik, me një ligjërim popullor plot kolorit lokal:

" Se bota , moj zonjë, të tregon me gisht
Bën thashetheme, të vë edhe bisht." (po aty,f.34), ose lakonizmi i më poshtëm që karakterizon personazhet:

" Jeta e Ferrak Beut dhe e së shoqes
E ka ngrënë tagjinë, po i kthehet torbës"

Në embrion shembëlltyrat lindin si tregime të shkurtra por më vonë, duke kaluar gojë më gojë e brez pas brezi ato rivitalizoheshin në figuracionin letrar në format e shprehjes dhe në strukturën dhe kompozimin artistik.

Pasazhet në roman krahas mençurisë dhe zhbirimit të hollë në dukuri apo fenomenin shoqëror, politik apo social ata janë vlera të humorit të këndëshëm, satirës së mprehtë dhe pasurimit të ideve estetike.

Në vepër gjejmë elementë stilistikorë me burime nga ligjërimi liturgjik. Pasazhet e vajtimit. Paravolia e bisedës me dhelprën:

"Për krye të fëmijëve e gjithsa kam,
S'të gënjen dhelpra një fjalë. (f.38)

Apo " Qafsha ty moj skile, nuk thash asnjë fjalë."

Në karakterizimin e personazheve, dhelpra del si dinakja e la Fontenit, derri në mënyrë ironike si më shejtani, më i zgjuari, apo çakalli që " jep me dorë dhe kërkon me këmbë" (f.44)

Eliptizmi, i cili ka të bëjë me shumëkuptimsinë e figurës poetike, në sajë të asociacioneve që sillen nga tekste hipotetike, nga fusha të tjera si: historia, folklori, etnografia, arkeologjia dhe janë të kapshme nga pjesëtarë të së njëjtës kulturë nuk e ka dëmtuar veprën për t'u kuptuar nga lexuesi. Në vepër nuk mungojnë figura poetike përshkruese si nokturne romantike:

Natë e bukur shumë, natë vere me hënë
Delet bënin gjumë, nën heshtjen e rëndë.(f.40)

Nganjëherë mesazhet na vijnë si porosi morale e drejtpërdrejtë;

" Njerëzit hedhin gurin dhe fshihen e struken
Njerëzit, or bir, nuk janë sikur duken".

Një fragment i bukur poetik është dialogu me Bekën.

"Më ka këput malli për me t'pa
Kur t'kujtoja veç kam qa
Nuk qajnë burrat, thua ti
Qajnë, moj, qajnë për sytë e zi!", (f.50)

janë të rralla pasqyrime të tilla realiste të sentimentit njerëzor, të dhënë me kaq ndjenjë dhe natyrshmëri si shkrepje metaforike moderne. Në marrdhëniet e Bekës me Ermalin ka një frymë melankolie dhe romantizante që përgjithësisht është tejkaluar në letërsi por nuk di përse poeti si frymëzim, i referohet këtij modeli si përshkrime poetike me origjinë bari-tore dhe përmbajtje të lehtë temash dashurore në të cilat komplimentohet e dashura me vyrtyte të zmadhuara.

Një përdorim të dendur kemi stilemat të cilat janë paravënie jo e zakonshme fjalësh që përmban veç kuptimit të parë semantik, edhe një kuptim të dytë, figurativ me ngjyrim emocional.

Po kështu një rol të rëndësishem në vepër luan edhe grotesku, i cili është një dukuri, ku ndërthuret komikja ose qesharakja. Shpesh grotesku përmban edhe të shëmtuarën dhe të stërzmadhuarën, të llahtarshmen dhe të përbindshmen, në ato kapituj ku flitet për luftën e klasave. Baza krahasuese e romanit është analogjia e cila realizon ngjashmërinë, përngjasimin, që zbulohet duke krahasuar dukuri dhe sjellje politiko-shoqërore, të cilat kanë cilësi të përbashkëta. Përngjasimi mund të jetë për një ose për disa tipare, mund të jetë i pjesshëm ose i shumanshëm. Analogjia si mënyrë arsyetimi, në këtë rast është edhe përftesë letrare. Autori e ka shfrytëzuar me sukses këtë mundësi. Momente komike si " dhelpra bën kërkesë për të hyrë në parti" ku pranimi i saj analizohet si e papërshtatshme se:

" Thur lajka si pupla pule
Çdo gjë ta bën verë me lule"
Po ta fusim atë n'parti
Na përlan me mace e mi" (f.60)

Në horizontin e pritjes autori realizon dy gjëra: funksionin simbolik, kur tregojmë gjëra rreth botës, dhe funksion emotiv, kur i përdorim fjalët për të kri-juar ndjenja subjektive apo sjellje. Personazhet kafshë janë figura letrare, nuk janë gjuhë referenciale, shpesh shmangin krijimin e ndjenjave.

Dëshirat tona konfliktojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe në mënyrë të paevitueshme, përderisa jemi njëkohësisht qenie sociale dhe individë. Kështu ne duhet të përfillim dëshirat e të tjerëve ashtu sikurse dhe tonat, të pajtojmë impulset tona konfliktuale me njëri-tjetrin, në mënyrë që t'i hapim rrugë kënaqësisë kolektive në shkallën më të madhe të mundshme. Ashtu si narratori dhe rrëfimndjekësi, është një nga elementet e situatës narrative dhe futet në të njejtin nivel diegjetik, eshtë i lidhur virtualisht me narratorin. Ky është një nga sukseset profesionale të autorit pasi përmes situatës parabolike, krijon një terren nëntekësti. Por të shumta janë rastet ku anatema vjen me stilema plot humor:

"Më fal o Pashë- thirri kasnec i tellallit
Ai që foli është vrima e fundit e kavallit".

Duke i dhënë romanit hijeshi dhe finesë në ligjërimin letrar.

U ndala në disa aspekte të formave ligjërimore për të mos përsëritur vlera të parashtruara edhe nga të tjerët.

Rruga e Arbërit nr. 69

poezi

Poezi nga Xhelal Luca

ARBËRISHT DASMORË

Ma humbët lotin
O bijtë e mijë
Më jeni derdhur
si zogjt e korbit
A thu se për këte dhe
Nuk ka Përëndi
Malli per ju
Sa dhimbja e mortit .
Dalldis si murra Mirdite
Përplasem idhtas në kep
Por dhimbjen se njoh
Për djem dhe vasha
Si rreze drite
Lulkuqe këmishat tu qep
Arbërisht dasmorë tju shoh.
Vetëm atëherë bijtë e mi
jKur kuq e zi ju shoh
Lopata e dheut që më hidhet përmbi
Përjetësisht më ngroh.

DASMORË NË KOSOVË

Ju luta një vashe në Kosovë
Me shpirt në dorë,
Dua të jem dasmor

Shqipe kam me ardhë
Me kësulë të bardhë
Krejt serbes
Me dy naganta në brez

I kam fsheh
Një ballë fishek
Për ti djeg'
Ta ndigjojë Kosova krejt
Se qiellit ja shkoqa retë

Jam djalë Shqipërie
Bukur më ka hije
Dollibash rakie
Dollibash krushqie
Në karvane dasmërie

Si I shkalamendur
Në dehje
Përqafohem me lisat
Të puthem me plisat
Në palcë të tokës
Të përcillet kushtrimi
Sot do derdhi lot gëzimi

Oooo Kosovë
Sa më dhëmbin plagët e tua
I kam në shpirt
I kam në kock
I kam në thua
Sa herë me shkja
Je vra
E s'ke qa
Në palë të flamurit
Djemtë të kanë ra'

Ta mora mandilen Argjiro
Të bukuroj kreun e Bajrakut
E çova tek Jasharët hero
Aty ku u derdh
Dallga e gjakut.

Dasëm vëllezer!
Sa më shumë dasma
Se vetëm duvakët
Kuq e zi bajrakët
Na I shërojnë plagët

Të bien tupanët
Në të katër anët
Në shkrum kësaj here
Kanë mbirë zambak vere

Hëna derdh argjend mbi dasmorë
Ne ngremë dolli deri në agim
Nusja dritëson si meteorë
Me mendafsh kuq e zi mbi shpinë

Fehmi* vëlla !
Halil* baba !
Kjo është dasëm jo shaka
Treqind krushq me këmisha të kuqe
Sot Luanën* e marrin nuse

Të bien tupanët
Në të katër anët
Të skuqen telat e sharkisë
Në gëzim të zotit t'shtëpisë

Në përlotje
Puthi nusen në të fundit herë
"Bijë rrugë të mbarë "
Dasma jote
Më e bukura pranëverë
Për bashkimin kombëtarë

Le të bien tupanët
Të derdhen karvanët
Shkup e Prishtinë
Prevezë e Ulqin
Maleve të ndizen zjarrmorë
Gjith Shqipëria dasmorë
Luana shkon
Nuse në Vlore.

Eh të kallen grykat
E atdheut tim
Në kuq e zi.
Një komb
Një flamur
Një kushtrim
Me opingë do ngremë dollinë

Të tërmetojmë
Në etje flakë e zjarre
Yjësinë e Evropës mbarë
Jam krenar
Jam shqiptar.

DIELLI NGA TI ME VJEN

Njëqind vjet
Të prita Amerikë
Njëqind vjet
Të pata ëndërr,
shpresë,
dritë.

Kombi im
Historikisht në kryqëzim
Nuk më lanë kurrë
Në fatin tim.
Njëra pas tjetre
Më shkelën perandoritë
E s'më lanë me pa ditë.
Sa herë

''Kurvëritë'' e Evropës
E çuan popullin tim
Në buzë të gropës

Jemi gjenezë e ngjashme
Sy ndër sy
Dhëmbë për dhëmbë
Flakë për flake
Duke të patur larg
U lava me gjak.
Dua besën tënde Amerikë,
Ti gjoksin me yje , dritësojnë
Unë plot plagë që kullojnë.

I desha bijtë e tu ,
Si dritën e syve,
Ndaj me shpirt
Jam pjesëz e gjashtëdhjetë e katër yjeve.
I ngrita shtatore Klintonit
Në tef të ballkonit
Të urtësohen çakejntë e Ballkanit
Do ti ngre legjendë
Ta mbaj në gji
Shekull mbas shekulli
Do ta mbjelli në fëmijë
Do tu them:
Ky na njohi si Shqiptari!

Dje më rrejtën ,
Më trembën
S' më lanë me të pa drejt
Oooo u shofshin krejt.

Sot do të fali djalin
Bijnë
Veç mos ma lënë
Copa Shqipërinë.

Ndaj mirëserdhe ,Amerikë,
Të kam shpresë
Të kam dritë
Do ta dua besën...
Ma dhe
Sot e njëqind vjet.
Do ta dua mot e jetë.

Sazan Goliku

Këngë për atdhetarin
Said Najden Dibrani
(Hoxhë Voka)

Ndërsa zemra i regëtinte,
zemra mbushur dashuri,
goja mjaltë i pëshpëriste:
Shqipëri... Shqipëri...
Ndërsa gjaku po i ngrinte.
gjak i kuq e gjak i ri,
amanetin po u linte
miqve, shokëve përreth tij:

"Gjersa turku të bëjë hije,
gur mbi varr të mos më vini.
Ditë e bardhë kur të vijë
përmbi krye gur më ngrini,
edhe gdhendni këto fjalë
me të ëmblën gjuhën shqipe:
"Që nga lindja, gjer në varr
për Atdhe shërbëtor ishte."

Dhe i mbylli sytë e zez,
porse zemra iu ngrit flur
si shqiponja dykrenore
që kaliti në flamur.
Dora penën e lëshoi...
po e morën qindra mijë
edhe shkruan, edhe shkruajnë:
Shqipëri... Shqipëri...

Skicë nga SELMAN MZIU

Përballoi turkun e serbin por jo...

I ngjante një kurrizi kali të majmë. Ngjyra e këtijë kurrizi fillonte në Rrahanaje mbi trojet e Kuke dhe zbriste duke puthur Drinin me bishtin e sajë. Nga fundi i kalonte rruga që të çonte te Ferra e Pashës. Në perëndim e priste rruga, tanimë e asfaltuar që të shpiente në fshatin Brane.

Emri vinte nga bokërima e shekujve. Ostushi kishte histori të shumta. Po ta zbërthejme për brinjësh këtë fjalë,mund të shprehemi. ''Ose,, të vini me neve ore ''Tush,, ose të vrasim. Shumë ushtar turq me padishahun e tyre kishin kaluar këtyre anëve, pesëqind e dhjetë vjetë më parë. Atëhere lisat ishin me trup të trashë sa nuk i gërthenin dy burra. Pylli ishte hijerëndë e dashamirës me miqë e armiq.

Koha kaloi si një stuhi me vetëtime e shira të shumta e borëra edhe dy metra trashësi. Edhe me njëmijë e nëntëqind e njëzetën gjenerali me shajak u jepte urdhër ushtrisë per ti rënë serbit nga këto pyje të shëndetshme lisi. Por popullsia u shtua. Dhe dimrat ishin të ftohte. Oxhaku duhej ndezur per tu ngrohur. Pjekja kafesë bëhej me dollapin e sajë, ku majën ia ngulnin në tungun që veç digjej e prushi nxente kokrrat brënda që rrotulloheshin vazhdimisht. Aroma ishte e këndshme e tërheqëse. Per të nxehur çerepin e saçin për të pjekun bukën e norë duhesh edhe prushi i marrë me kacaje për ta vumun mbi saçin. Buka vinte me koren si ngjyra e gështenjës së pjekme. Çfarë kënaqësie ndjeje!

Lisat dalë ngadale u zhdukën. Por edhe ato si çdo qënje e gjallë luftonin për mbijetesë. Kështuqë buisnin llastarët ku rriteshin e trungu merrte forcë e gjallnesë. Gjithmonë Ostushi kishte gjallni, bulsonte jeta, e Drini i freskonte bishtin. Para tridhjetë vjetësh, hyne njërëzia me kazma, sopata e lopata e shkulën trungjet e gjalla të dushkajave. U hapën qindra kilometra brezare. Siç kishin bërë Etruskët mijëra vjete më parë. U mbollën kumbulla Tropojane, ato Shurke, qershite Burlet, Napolitane e të Luznisë ngjyrë zeza. U rritën dhe filluan të prodhojnë. E kurrizi i Ostushit, prodhonte këto fruta edhe për Tiranën e Gjirokastrën, Vjenen, e Lyonin, Shtutgardin etj.

Edhe çfarë ndodhi! Filluan ti presim, të mos kujdesohemi më, si dhe të futim dhitë e dele t'i kullotnin. Veprime qe kryheshin si në mallin pa të zot. Nuk kaloi shume vite dhe kodrës i doli ngjyra e kuqe e dheut, i dolën eshtrat. Me një fjalë u shpërfytyrua. U shëmtua së tepërmi. Por s'mbaroi me kaq! Tragjedia makabre vazhdoi. Disa pemë të rreshkura e të shpërfytyruara nga vuajtjet, përpiqeshin të rrezistonin. Por deri kur? Gushti erdhi i nxehtë, hardheçka digjej në diell, e Drini u paksua sa s'mbahej mend. Ostushi një dite me diell qe të piqte, e perpinë flaket e tymi nxiu hapsirën perrreth.

Disa drurë frutor mbetën si skeletë. Të tjera ashtu të kuqëluar nga gjuhët e pamëshirshme të flakëve mbetën si kurora të kuqe. Toka mori njollat e zeza mbi vete, ku dukeshin gjithashtu rriskat e bardha ndërsa rrëketë sa kishin filluar të kafshonin tokën. Iku Ostushi, nuk e ndaluan as banorët e këtyre anëve, as ligjet e shtetit. Sigurisht as organet e mbrotjes së mjedisit. Fatkeqësia është plagëshumtë e me dhimbje ndoshta të përjetshme.Duhen qindra vjetë që të ringjallet, dhe kushedi se a mundet. Çfar përdhunim i natyrës i vetëvetes ka ngjamun! Popullata e këtushme do të lëngojë nga dhimbja e tmerrshme, vazhdimisht do të mallkojë përgjegjësit e krimit.

shëndeti

Ç'farë duhet të bëjmë që të jetojmë 100 vjet?



Nga: **HAJREDIN TOCA***

Dëshira për një jetë sa më të gjatë ka shoqëruar njerëzimin në shekuj. Njerëzit duke qenë të ndryshëm kanë dhe jetëgjatësi të ndryshme. Në vendin tonë mosha mesatare ka ardhë në rritje. Në vitin 1995 ishte 71. 4 vjet dhe në 2005 ajo u rrit në 75. 4 vjet (Burimi: INSTAT). Mosha e çdo njeriu thuhet se është në genet e tij. Sot shkenca ka ecur shumë në përcaktimin e geneve përgjegjëse për një sërë procesesh jetësore të cilat përcaktojnë dhe jetëgjatësinë e njeriut. Por genet nuk janë të vetmet që përcaktojnë jetëgjatësinë sepse sot është argumentuar se mënyra se si jetoni e përcakton atë. Pra për moshën nuk janë vetëm genet por sa mirë jetoni ose si jetoni. Nuk jeni të bindur për këtë?Një studim i publikuar në British Medical Journal në vitin 2009 i bërë me 20 000 persona tregoi se mund të shmanget rreziku i shkurtimit të jetës duke bërë këto gjëra: 30 minuta vrap në ditë, të hani pesë vakte në ditë me fruta dhe perime dhe të shmangeni pirjen e duhanit dhe të alkoolit.

Për të arritur të jetojmë 100 vjet duhet të aplikojmë në jetë 11 mënyra për të jetuar.

1. NË PENSION POR JO PENSIONIST.



Faktet tregojnë se njerëzit që dalin në pension dhe bëjnë një jetë pensionisti (pra ndërpresin punën menjëherë) fillojnë të shtojnë në peshë dhe shoqërohen me sëmundje kronike. Drejtori i Studimit për Jetëgjatësinë dhe plakjen në Baltimore (USA) zoti Luigi Ferrucci pas një studimi në zonën e Chiantit në Itali ku ka shumë njëqindvjeçar nënvizon se: "Personat që dalin në pension në këtë krahinë nuk e ndërpresin punën por merren me kultivimin e pemëve dhe të perimeve". Kur dikush thotë se unë nuk mund të merrem me bujqësi atëherë ai bën punë të tjera në komunitet që ju japin lëvizje si: aktivizimi për kërkesat që kanë banorët për jetesën, për punët e përditshme, etj.

2. PASTRIMI I DHËMBËVE ÇDO DITË



Kjo mund të ndihmojë për të mbajtur arteriet tuaja të pastra. Një studim në New York University në vitin 2008 tregoi se është e rëndësishme të eliminojmë mbajtjen për një kohë të gjatë të çamçakëzëve në gojë të cilat sjellin baktere që futen në gjak dhe shkaktojnë inflamacion në arteriet, që është një rrezik i madh për sëmundjet e zemrës. Hulumtimet kanë treguar se ata që kanë shumë baktere në gojë kanë dhe rrezikun që të kenë arteriet më të trasha, një rrezik ky për sëmundjet e zemrës. "Unë mendoj se njerëzit duhet ti pastrojnë dhëmbët dy herë në ditë për të marrë përfitime më të mëdha për të shtuar jetëgjatësinë" thotë Thomas Perls në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Bostonit.

3. USHTRIME DHE ECJE

"Ushtrimet janë i vetmi burim që të mbajnë të ri" thotë Jay Olchansky profesor i mjekësisë dhe studiues i plakjes në Universitetin e Illinoisit në Çikago. Është si nafta dhe vaj për makinën tuaj, kur ja jep ato gjithmonë ajo punon më mirë. Studim pas studimi është argumentuar për përfitimet e ushtrimeve për të përmirësuar gjendjen shpirtërore,pasurinë mendore,balancimin në masën e muskujve dhe të eshtrave. Mos u shqetësoni nëse nuk keni palestër mjafton të ecni cdo ditë nga 30 minuta nëpër lagje dhe në ndonjë aktivitet dhe menjëherë do të ndjeheni si i ri.

4. HANI DRITHËRA ÇDO MËNGJES.

Ngrënia e drithërave, sidomos çdo mëngjes, ndihmon të moshuarit që të ruajnë nivelin e sheqerit në gjak gjatë gjithë ditës,-sipas një studimi të bërë nga Ferruci dhe kolegët e tij. Ata që konsumojnë drithërat shmangin diabetin i cili tashmë dihet që afron shpejt plakjen.

5. BËJ TË PAKTËN 6 ORË GJUMË ÇDO NATË.



Në vend të kursimit të gjumit për të zgjatur ditën e jetës tuaj bëni gjumë që të zgjasni jetën tuaj. "Gjumi është një nga funksionet më të rëndësishme që trupi ynë përdor për të rregulluar dhe shëruar qelizat" thotë profesor Ferrucci. "Ne kemi llogaritur se një i moshuar ka nevojë për 6 orë gjumë në ditë" Ata që duan të arrijnë një shekull jetë duhet ta bëjnë gjumin një përparësi kryesore.

6. KONSUMONI USHQIME TË PLOTA DHE JO PILULA

Përmbajtja e lartë në gjak e disa ushqyesve si: selen, beta-karotinë,vitaminë C dhe E, jep jetëgjatësi dhe ruan memorien. Për fat të keq nuk ka dëshmi se duke i marrë këto elementë nëpërmjet pilulave stimulojnë antiplakjes. Krejt e kundërta ndodh kur konsumoni ushqime të plota dhe natyrale. "Ka më shumë se 200 karotinoide të ndryshme dhe 200 flavonoide të ndryshme në një domate të vetme", vë në dukje Ferrucci. Dhe këto të marra nga ushqimi natyral mund të kenë ndërveprime komplekse për një shëndet të mirë ndryshe nga marrja e tyre nëpërmjet kokrrave (pilulave). Eliminoni bukën e bardhë dhe pëlqeni fruta dhe perime me ngjyrë të errët dhe sidomos drithërat se kanë një mori ushqyesish të fshehur që nuk mund të sigurohen në asnjë formë tjetër.

7. TË JENI SA MË PAK NEVRIK

Në punë gjithkush ka probleme që shoqërohen me stres. Pak veta e zgjidhin problemin me humor. Pak janë dhe ata që punojnë me një shef humorist. Përpiquni të mos nevrikoseni, të paktën pas çdo ngacmimi merrni frymë thellë. Të gjithë njëqindvjeçarët shikojnë punën e tyre dhe nuk kanë tendencën për të përvetësuar gjërat. Kur bëheni nevrik mos kalo për të parë televizor dhe të filloni të hani patate të skuqura. Merruni më mirë me lëvizje të lehta.

8. VLERËSOJENI JETËN

Kjo bëhet duke vlerësuar trupin tënd që do të thotë mos i jep atij alkool dhe duhan si dhe mos e tepro me ëmbëlsirat. Jepi trupit tënd fruta, perime, fasule dhe arra. Merru më shumë me ushtrime fizike. Qëndroni të lidhur me familjen dhe përkushtojuni asaj. Aktivizohuni në komunitetin e lagjes tuaj. Të gjithë ata që kanë zbatuar këto parime kanë një jetëgjatësi 10 vjet mbi mesataren.

9. KTHENI NË ZAKON VEPRIMET TUAJA

Njëqindvjeçarët kanë tendencë të jetojnë sipas një rutine të rreptë, thotë Olshansky, aplikojnë të njëjtën lloje diete (po ta quanim kështu ushqimin e përditshëm),si dhe bëjnë të njëjtat aktivitete gjatë gjithë jetës së tyre. Shkojnë në shtrat dhe zgjohen në të njëjtën orë, veprim ky që mban trupin në një ekuilibër të qëndrueshëm. Por zakoni prandaj quhet zakon e nuk duhet shkelur sepse "Fiziologjia juaj trupore bëhet lehtësisht e thyeshme kur ju i prishni këto rregulla, ta zëmë ndryshoni orarin e gjumit apo pini alkool. Ky veprim ndikon direkt në uljen e imunitetit të organizmit tuaj ndaj viruseve të gripit dhe infeksioneve të tjera bakteriale.

10. MBAJ LIDHJE DHE SHOQËROHU ME MIQTË DHE ME SHOKËT

Duke mbajtur lidhje dhe kontakte me miqtë dhe me shokët është çelësi për të shmangur depresionin i cili mund të çoj në vdekje të parakohshme. Disa psikolog mendojnë se një nga përfitimet më të mëdha për të moshuarit është bashkëveprimi i fortë shoqëror duke u shoqëruar me miq ose duke bërë aktivitete sëbashku. Kjo marrëdhënie sjell këshilla për njëri-tjetrin dhe në një shoqëri bëhen vërejte për çdo gjë edhe për shëndetin.

11. JINI TË NDËRGJEGJSHËM PËR ÇFARË BËNI

Parashikuesi më i mirë që të kapni 100 vjet jetë është të jeni të vetëdijshëm për atë që bëni, duke qenë të matur, këmbëngulës dhe të organizuar mirë. Në një libër të bashkëautorëve Howard Friedman dhe Lesli Martin përshkruhet një studim me 1 500 fëmijë për tetë dekada të tëra, ku u mblodhën të dhëna për historitë e tyre personale, shëndetin, aktivitetet, besimet, qëndrimet dhe familjet. Fëmijët që ishin të matur dhe të organizuar mirë kishin jetuar më gjatë. Friedman thotë se: ka gjasa se të ndërgjegjshmit janë më të prirur për të ndjekur urdhrat e mjekëve, të marrin ilaçet e duhura dhe në dozë të drejtë si dhe i nënshtrohen kontrolleve rutinë. Ata janë gjithashtu më të predispozuar të krijojnë lidhje martesore të lumtura, bëjnë një jetë të kënaqshme, i përkushtohen punës ndryshe nga kolegët e tyre më pak të ndërgjegjshëm.

Këto këshilla i lexon e i pëlqen kushdo por ai që bën përpjekje ti zbatojë jeton 100 vjet.



** Hajredin Toca është Master në shkencat e mbrojtjes së bimëve dhe studion për Doktoraturë për këto shkenca në UBT. Ai jep mësim në Universitetin e Tiranës, Fakultetin e Infermierisë në lëndën "Biologji Molekulare".*

Ai do të botojë herë pas here artikuj që kanë të bëjnë me të ushqyerit, me atë çfarë duhet të hamë, por dhe me çfarë ushqehemi në fakt. Mbetjet e lëndëve të papërshtatshme në ushqime, çfarë parashikojnë ligjet dhe rregullat, etj. Të gjitha këto do në funksion të rritjes së vlerave të ushqimeve që prodhon zona nga kalon Rruga e Arbërit.

Biblioteka e autorëve dibranë*





Blij një libër të një autori dibran, merr një kalendar "Dibra 2012" FALAS!

Adresa: Rruga "Zenel Baboci", Pall. Ferar, Tiranë (Pranë Selvisë)
Tel. 00355 4 22 33 283.
Cel. 069 20 68 603
e-mail: mbbotime@gmail.com

cyan magenta yellow black